Literatura shtesë:	<p>1. English Unlimited – Pre-Intermediate, Coursebook, Cambridge University Press 2011, UK;</p> <p>2. English Unlimited – Pre-Intermediate, Self-study Pack, Cambridge University Press 2011, UK;</p> <p>3. OXENDEN, Clive-Latham Koenig Christian, New English File Intermediate, Oxford University Press, 2005</p> <p>4. BURT, Angela, The A-Z of Correct English, How to Books Publishing, Oxford, 2002</p>

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Përshkrimi i lëndës/literaturës Diskutime mbi planin e veprimit për zhvillimin e gjuhës angleze të studentëve Teknikat e të mësuarit të vokabularit Diskutimi rreth prezantimeve
Java 2:	Koha e tashme dhe e vazhdueshme Miming - (active and state verbs) Këtu dhe Tani Përshkrimi i ngjarjeve jetësore Fjalorthi javor
Java 3:	Koha e shkuar (Past simple, Past cont.) Shprehja <i>used to</i> (shprehi) dhe <i>would</i> (nostalgji) Kujtimi dhe harresa Heronjtë Lidhëzat: <i>por, pra, sepse, pastaj</i> Fjalorthi javor
Java 4:	Format krahasore dhe sipërore Frazat e krahasimit ENERGJIA – (Burning calories; extreme weather; It isn't as cold as) 10 vende për të vizituar para se të vdesim Fjalorthi javor
Java 5:	Koha e pakryer Kombet dhe kulturat

	<p>Eksperienca ndërkulturore  Culture shock situations-discuss  Shkrimi i CV-së  Fjalorthi javor</p>
Java 6:	<p>Format e kohës së ardhme  Klauzolat me <i>if</i> dhe <i>when</i>  First conditional  Consumer review  Fjalorthi javor</p>
Java 7:	<p>Mbiemrat -ed/-ing  Role-play  Lajmet e javës  Shkruaj një lajm  Fjalorthi javor</p>
Java 8:	<p>Testi I</p>
Java 9:	<p>Kërkesat e sjellshme  Zakonet shoqërore në...  Outdoor Project-Pjesëmarrja në garën <i>Po-e-zë</i>  Kompleto poezinë  Fjalorthi javor</p>
Java 10:	<p>Klauzolat relative definuese  Quantifiers-shprehje sasiore  Gjërat pa të cilat nuk mund të jetoni  Post of the day  Fjalorthi javor</p>
Java 11:	<p>Shprehja e parashikimeve  Mundësitë hipotetike  Baba Vanga dhe parashikimet e saj për 20...  Urban world in 2050  Gara e fjalorthit</p>
Java 12:	<p>Renditja e mbiemrave  Emrat e përbërë  Sinonimet dhe antonimet  Role-play  Cheapskates - përfitimi dhe pasojat  Fjalorthi javor</p>
Java 13:	<p>Post of the day  Gabimet më të shpeshta në gjuhën angleze</p>

	Idiomet TED talks (watch/listen, discuss, oppose/agree) Fjalorthi javor
Java 14:	Profesionet më interesante Homonimet Përsëritja e fjalorit javor Përgatitja për test
Java 15:	Testi II

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studenti është i obliguar t'i ndjek 80% të ligjeratave dhe ushtrimeve. Celularët / telefonat e mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPods) duhet të jenë të fikur (ose në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë ligjëratave përveç nëse nuk kërkohet për aktivitetin e caktuar në klasë. Aktivitetet e tjera, të tilla si kontrollimi i emailit personal ose shfletimi i faqeve të internetit, janë të ndaluara.

Studentët duhet të sjellin me vete gjithmonë materiale për mbajtjen e shënimeve dhe të jenë të përgatitur për ligjërata dhe për çdo aktivitet; Ardhja me kohë është thelbësore, si dhe studentët duhen të jenë aktiv gjatë ligjëratave përndryshe vetëm prania fizike do të vlerësohet si mungesë. Nga studentët pritet që të jenë të përgatitur dhe të gatshëm në çdo kohë që të kontribuojnë në aktivitetet në klasë.

## Titulli i lëndës: Gjuhë e huaj 2

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Ballkanistikë
Titulli i lëndës:	Gjuhë e huaj 2
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I   Semestri II
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Mësimdhënia dhe mësimnxënia do të bazohen në ndërveprim dhe do të mbështeten kryesisht në pjesëmarrjen e secilit student në dhënien e mendimit të tyre personal dhe ndarjen e përvojave të tyre. Lënda synon zhvillimin e barabartë të aftësive produktive të të folurit, të shkrimit dhe ato receptive të dëgjimit dhe të leximit sipas kërkesave të CEFR për Gjuhë.</p> <p>Përfshirja e veprave të ndryshme letrare dhe analizimi i të njëjtave do të kontribuojnë në pasurimin e fjalorit të tyre dhe do t'i afron ata me letërsinë dhe kulturën angleze. Duke punuar me nivelin B1-intermediate, gramatika e gjuhës angleze do të ligjërohet përmes një përzierje të qasjeve induktive (nga poshtë lart) dhe deduktive varësisht nga tema, duke përfshirë në mënyrë efektive metodën komunikuese e cila bazohet në idenë se të mësuarit e suksesshëm të gjuhës vjen përmes komunikimit të kuptimit real dhe përdorimin e saktë të gramatikës.</p> <p>Lënda vë në theks komunikimin real, i cili do t'i lejojë studentët të përdorin rregullat e mësuara të gramatikës dhe të përdorin fjalorin, si dhe i inkurajon ata që të shprehin mendimin e tyre në gjuhën angleze mbi temat e ndryshme.</p> <p>Aktivitetet në klasë të udhëhequra nga qasja komunikuese karakterizohen duke u përpjekur të prodhojnë komunikim kuptimplotë dhe real. Si rezultat i kësaj, do të ketë një theks të veçantë në komunikim, mësimet janë më të përqendruara tek</p>

	<p>studenti duke përdorur materiale autentike. Shkathësitë e shkrimit do të fuqizohen përmes ushtrimit të shkrimit në lidhje me ngjarjet reale apo imagjinare, shkrimit të biografisë, peticionit, ankesës zyrtare, shkrimit të tregimit të shkurtër, shqyrtimi i problemeve dhe dhënia e këshillave, diskutimi i projektligjit/ligjit, etj.</p> <p>Për të rritur interesimin dhe angazhimin, studentët gjithashtu do të ftohen dhe inkurajohen të marrin pjesë në kërkimin, përzgjedhjen, si dhe krijimin e materialeve që do të përdoren në klasë.</p>
<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<p>Objektivat e kësaj lënde janë përcaktuar sipas kërkesave të CEFR-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të ndihmojnë zhvillimin e gjuhës akademike të studentëve</li> <li>• të përmirësojnë aftësitë perceptuese të studentëve (dëgjimi dhe leximi)</li> <li>• të përmirësojnë aftësitë gjuhësore produktive të studentëve (të folurit dhe të shkruarit)</li> <li>• të aftësojë studentët të tregojnë në mënyrë të rrjedhshme një ide, mendim ose përshkrim në sekuencë lineare.</li> <li>• GAMA E FJALORIT- të ketë një fjalor të mjaftueshëm për ta shprehur veten në disa mënyra mbi shumicën e temave që lidhen me jetën e tij të përditshme, ngjarjet e paparapara, të shpjegoj zhvillimin e një vepre letrare dhe ngjarjet aktuale.</li> </ul>

<p>Rezultatet e pritshme të nxënies:</p>	<p>Studentët që ndjekin këtë kurs dhe i respektojnë rregullat akademike duhet të jenë në gjendje që ta shfrytëzojnë gjuhën angleze për nevojat e tyre personale dhe profesionale. Prandaj, studentët që mbarojnë me sukses këtë kurs duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstrojnë njohuri të nivelit <i>intermediate</i> të gjuhës angleze.</li> <li>• bashkëbisedojnë me një shkallë të rrjedhshmërisë dhe spontanitetit që e bën të mundur bashkëveprimin e rregullt me folësit amtarë.</li> <li>• shprehin të menduarit kritik në mënyrë të rrjedhshme.</li> </ul>
--	---

- paraqesin përshkrime të qarta me tema të ndryshme që lidhen me fushën e interesit.
- kuptojnë fjalimet e gjata dhe komplekse.
- shkëmbejnë, kontrollojnë dhe konfirmojnë informacione, të merren me situata më pak rutinore dhe të shpjegojnë mangësitë (problemet) e një situatë.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjërata	2 (45 min)	15	22.5
Ushtrime	2 (45 min)	15	22.5
Përgatitje për test intermediar	2	8	16
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	10	2.5
Testi, punimi i seminarit	2	3	6
Detyrë shtëpie	2	10	20
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	9	18
Përgatitja për provimin final	5	2	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	3	3
Projektet, prezantimet, etj.	3	1	3
<b>Totali</b>			123.5 orë 123.5:25=4.94 5 ECTS

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Forma e rregullt e ligjëratave përbëhet nga 2 orë ligjërata dhe 2 orë ushtrime në javë. Metoda e ligjërimit të lëndës do të jetë me studentët në qendër dhe interaktive. Varësisht nga aktiviteti punët individuale dhe grupore do të jenë të shpeshta dhe në përputhje me materialin që duhet mbuluar.</p> <p>Studentët do të jenë të detyruar të përgatisin një prezantim në klasë. Gjatë</p>
------------------------------	--

	<p>orëve do të aplikohen aktivitete siç janë: gara e të folurit, lloja e historisë, bllogu i ditës, krijimi i tregimit të shkurtër, raporte statistikore, aktiviteti jashtë objektit të fakultetit (vizita e Këndit Amerikan), loja -debat në kongres (kalimi i projektligjit), diskutimi dhe analiza e veprave letrare (novela, poezi), shkruarja e poezisë etj. të gjitha të dizajnuara për të zhvilluar kureshtjen, të menduarit kritik dhe shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve të studentëve.</p> <p>Kështu inkurajon të mësuarit e gjuhës përmes diskutimit të çështjeve të ndryshme sociale si dhe nëpërmjet përfshirjes së veprave letrare.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë;  Vijueshmëria-10%  Pjesëmarrja ne diskutime-10%  Prezantimi- 10 %  Testi I -10 %  Testi II – 10%  Provimi përfundimtar – 50 %</p>
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. CUNNINGHAM, Sarah – MOOR, Peter, New Edition <i>Cutting Edge-Intermediate</i> Student Book, Pearson Longman, Harlow, United Kingdom, 2014</li> <li>2. CUNNINGHAM, Sarah – MOOR, Peter, New Edition <i>Cutting Edge- Intermediate</i> Workbook, Pearson Longman, Harlow, United Kingdom, 2014</li> <li>3. CUNNINGHAM, Sarah – MOOR, Peter, New Edition <i>Cutting Edge-Intermediate</i>, Teacher’s resource book, Pearson Longman, Harlow, United Kingdom, 2014</li> </ol>
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. OXENDEN, Clive-Latham Koenig Christian, <i>New English File Intermediate</i>, Oxford University Press, 2005</li> <li>2. BURT, Angela, <i>The A-Z of Correct English</i>, How to Books Publishing, Oxford, 2002</li> <li>3. CUNNINGHAM, Sarah – MOOR, Peter, BYGRAVE, Jonathan, New Edition <i>Cutting Edge-Intermediate</i> Teacher’s resource book, Pearson Longman, Harlow, United Kingdom, 2014</li> </ol>

**Hartimi i planit  
mësimor**

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Përshkrimi i lëndës/literaturës Njoftimi mbi objektivat, rezultatet e pritura të nxënies, metodat e mësimdhënies, metodat e vlerësimit, dhe rregullat akademike Pyetjet dhe rekomandimet e studentëve Diskutimi rreth prezantimeve
Java 2:	Përsëritja e formave të foljeve Përdorimi i foljeve ndihmëse Bota përmes të kaluarës, tashmes dhe të ardhmes BBC radio game- <i>Just a minute</i> (speaking without deviation, hesitation, repetition) Fjalorthi javor
Java 3:	Formimi i emrave dhe <i>gerund</i> Formimi i mbiemrave Shkrimi i peticionit-problemi dhe qasja Posting of the day Fjalorthi javor
Java 4:	Format e foljeve në tregim Tregimi nga dy pikëpamje të ndryshme History game-Find my Doppelganger in history Fjalorthi javor
Java 5:	Second conditional – struktura, përdorimi Fjalët e ngatërruara në gjuhën angleze Fituesit e çmimit Nobel dhe veprat e tyre Importance of education and training-discuss Fjalorthi javor
Java 6:	Foljet modale Obligimet dhe lejet në kohën e tashme/e shkuar Problemet dhe këshillat Good Communication – Keeping in touch; It’s good to talk; Online friendships Fjalorthi javor
Java 7:	Mbiemrat ekstreme-kombinimet me ndajfolje jo-graduese Kombinimet emër-folje Bëhu cicëron turistik – Promovo vendin tënd TED talks - (watch/listen, discuss, oppose/agree) Fjalorthi javor
Java 8:	Testi I
Java 9:	Përdorimi i nyjave Building a short story Outdoor Project-Vizita e Këndit amerikan- Gjenerali i librit të preferuar

	Fjalorthi javor
Java 10:	Mësimi i gjuhës përmes letërsisë (poezi, ekstrakte nga romane, tregime të shkurtra) Book review dhe analiza e sekuencave të caktuara Who is your muse Fjalorthi javor
Java 11:	Diatezë pësore Zbulimet më interesante Historia e Mbretërisë së Bashkuar- Monarkia dhe vendet historike-The Tudors Fjalorthi javor
Java 12:	Kolokacionet Shprehje idiomatike Shkrimi i ankesës zyrtare Analiza e proverbave-krijo situatën/bisedën Pass a bill of law in Congress (preparation, justification, discussion) Fjalorthi javor
Java 13:	Koha <i>Past perfect</i> Tradicionalja dhe bashkëkohorja Mediat sociale – përdorimi, keqpërdorimi, qëllimi Use vague expressions when you can't remember a word Fjalorthi javor
Java 14:	Reported speech-Ligjeratë e zhdrejtë Jeta dhe vepra e William Shakespeare Soneti 55: Not marble nor the gilded monuments-leximi, analiza, diskutimi Shkruaj një poezi Fjalorthi javor
Java 15:	Testi II

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studenti është i obliguar t'i ndjek 80% të ligjeratave dhe ushtrimeve. Celularët / telefonat e mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPods) duhet të jenë të fikur (ose në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë ligjeratave përveç nëse nuk kërkohet për aktivitetin e caktuar në klasë. Aktivitetet e tjera, të tilla si kontrollimi i emailit personal ose shfletimi i faqeve të internetit, janë të ndaluara.

Studentët duhet të sjellin me vete gjithmonë materiale për mbajtjen e shënimeve dhe të jenë të përgatitur për ligjërata dhe për çdo aktivitet; Ardhja me kohë është thelbësore, si dhe studentët duhen të jenë aktiv gjatë ligjeratave përndryshe vetëm prania fizike do të vlerësohet si mungesë. Nga studentët pritet që të jenë të përgatitur dhe të gatshëm në çdo kohë që të kontribuojnë në aktivitetet në klasë.

## Titulli i lëndës: Gjuhë e huaj 3

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Gjuhë e huaj 3
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti II   Semestri III
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Salla
Mësimdhënësi:	
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Mësimdhënia dhe mësim nxënia nuk do të ndahen në mënyrë të mprehtë, prandaj do të jenë vazhdimisht të ndërlidhura dhe interaktive, duke lejuar secilin student që të marrë pjesë në proces dhe të japë kontributin personal në prodhimin e vazhdueshëm të njohurive.</p> <p>Duke synuar zotërimin e katër shtyllave kryesore të gjuhës, të dëgjuarit, shkruarit, të folurit dhe të lexuarit në nivelin e paraparë me CEFR për Gjuhë, në këtë lëndë do të inkuadrohen aktivitete të ndryshme duke përdorur mediat audio-vizuale.</p> <p>Brenda kësaj lënde, studentët do të mësojnë dhe praktikojnë gramatikën B2 upper-intermediate të gjuhës angleze me një metodë induktive (nga poshtë-lart) dhe deduktive varësisht nga tema, duke përfshirë në mënyrë efektive metodën komunikuese e cila bazohet në idenë se të mësuarit e suksesshëm të gjuhës vjen përmes komunikimit të kuptimit real dhe përdorimin e saktë të gramatikës.</p> <p>Lënda thekson komunikimin real që do t'u mundësojë studentëve të përdorin rregullat e mësuara të gramatikës dhe të praktikojnë fjalorin, si dhe i inkurajon ata që të shprehin mendimin e tyre në gjuhën angleze për tema të ndryshme.</p> <p>Aktivitetet në klasë të udhëhequra nga qasja</p>

	<p>komunikuese karakterizohen duke u përpjekur të prodhojnë komunikim kuptimplotë dhe real. Si rezultat, ka më shumë theks në komunikim, mësimet janë më të përqendruara në studentin dhe në përdorimin e materialeve autentike.</p> <p>Shkathësitë e shkrimit do të forcohen përmes ushtrimit të: strukturës narrative, sintaksës së shkrimit biznesor, përshkrimeve të detajuara në një gamë të gjërë të temave me fakte mbështetëse, një përmbledhje të një filmi ose të një libri.</p> <p>Kjo lëndë gjithashtu do të nxis të mësuarit e gjuhës përmes letërsisë, si dhe familjarizimin me historinë britanike / amerikane.</p> <p>Për të rritur interesin dhe angazhimin, studentët gjithashtu do të ftohen dhe do të inkurajohen të marrin pjesë në kërkimin, përzgjedhjen, si dhe krijimin e materialeve që do të përdoren në klasë.</p>
<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<p>Qëllimet e lëndës janë caktuar sipas kërkesave të CEFR dhe janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të mundësojë studentëve të komunikojnë në gjuhën e synuar në këtë nivel të caktuar</li> <li>• të mundësojë studentëve që të marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutime në kontekste të njohura, duke llogaritur dhe mbështetur pikëpamjet.</li> <li>• të rrisë besimin dhe aftësinë e studentëve për të komunikuar me folës amtarë dhe jo-amtarë të anglishtes, si në të folur ashtu edhe në shkrim</li> <li>• të nxisë studentët që në mënyrë individuale të përdorin përvojën e tyre e të mësuarit</li> <li>• të inkurajojë studentët që në mënyrë individuale të marrin përgjegjësinë për progresin e tyre e të nxënit, duke u përpjekur kështu ta rrisin atë</li> <li>• GAMA E FJALORIT- t'u mësojë një gamë të mirë të fjalorit për çështje që lidhen me fushën e tyre dhe temat më të përgjithshme ku studentët mund të ndryshojnë formulimet për të shmangur përsëritjen e shpeshtë dhe të kenë pak zbrazëtira leksikore të cilat mund të shkaktojnë hezitim dhe ndërprerje në bisedë.</li> </ul>
<p>Rezultatet e pritshme të nxënies:</p>	<p>Studentët që ndjekin këtë kurs dhe i respektojnë rregullat akademike duhet të jenë në gjendje që ta shfrytëzojnë gjuhën angleze për nevojat e tyre</p>

personale dhe profesionale. Prandaj, studentët që mbarojnë me sukses këtë kurs duhet të jenë në gjendje të:

- të kuptojnë fjalimet e gjata dhe ligjëratat dhe të ndjekin edhe argumentet komplekse nga tema të njohura dhe më të përgjithshme.
- të bashkëbisedojnë me një shkallë të rrjedhshme dhe në mënyrë spontane që e bën të mundur ndërveprimin e rregullt me folësit amtarë.
- të marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutime në kontekste të njohura, duke mbështetur pikëpamjet e tyre.
- të paraqesin përshkrime të qarta dhe të detajuara në një gamë të gjerë temash që lidhen me fushën e interesit dhe më gjerë.
- të shkruajnë letra që theksojnë rëndësinë personale të ngjarjeve dhe përvojave
- Të debatojnë, flasin për tema të ndryshme

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	22.5
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	1,5	14	21
Konsultime me mësimdhënësin	15min	10	2.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	2	10	20
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja për provimin final	2	10	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj.	2	3	6

Totali		150.5:25=5.94 6 ECTS
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Forma e rregullt e ligjëratave përbëhet nga 2 orë ligjëratë dhe 2 orë ushtrime në javë. Metoda e ligjërimit do të jetë me studentët në qendër dhe interaktive. Punët individuale dhe grupore do të jenë të shpeshta dhe në përputhje me materialin që duhet mbuluar.</p> <p>Përveç prezantimeve të studentëve, do të bëhen aktivitete si: video e heshtur, diskutime në justifikimin e pikëpamjeve, mock-trial (simulimi i gjykatës, akuzat/mbrojtjet), ankandi i fjalive, projekte jashtë objektit të fakultetit-poezia e trotuarit, hulumtime mbi tema të ndryshme (psh. Dëmet e turizmit), domino për çështje gramatikore, përdorimi i videot nga TED talks me tema të ndryshme të gjitha të dizajnuara për të zhvilluar kureshtjen, të menduarit kritik dhe shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve të studentëve.</p>	
Metodat e vlerësimit:	<p>Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë;</p> <p>Vijueshmëria-10%</p> <p>Pjesëmarrja ne diskutime-10%</p> <p>Prezantimi- 10 %</p> <p>Testi I -10 %</p> <p>Testi II – 10%</p> <p>Provimi përfundimtarë – 50 %</p>	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. CUNNINGHAM, Sarah – MOOR, Peter, New Edition <i>Cutting Edge-Upper-Intermediate</i> Student Book, Pearson Longman, Harlow, United Kingdom, 2014</li> <li>2. CUNNINGHAM, Sarah – MOOR, Peter, New Edition <i>Cutting Edge-Upper-Intermediate</i> Workbook, Pearson Longman, Harlow, United Kingdom, 2014</li> <li>3. DOOF, Adrian-GOLDSTEIN Ben, <i>English Unlimited Upper-Intermediate</i> Coursebook, Cambridge University Press, 2011</li> </ol>	
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. OXENDEN, Clive-Latham Koenig Christian, New English File Upper-Intermediate, Oxford University Press, 2005</li> <li>2. BURT, Angela, The A-Z of Correct English, How to Books Publishing, Oxford, 2002</li> </ol>	

3. CUNNINGHAM, Sarah – MOOR, Peter, BYGRAVE, Jonathan,  
New Edition *Cutting Edge*-Advanced Teacher's resource book,  
Pearson Longman, Harlow, United Kingdom, 2014

## Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Përshkrimi i lëndës/literaturës Njoftimi mbi objektivat, rezultatet e pritura të nxënies, metodat e mësimdhënies, metodat e vlerësimit, dhe rregullat akademike Diskutime mbi planin e veprimit për zhvillimin e gjuhës angleze të studentëve Diskutimi rreth prezantimeve
Java 2:	Kohët e tashme (Present simple, Present cont.) Video e heshtur-Silent video Koha e lirë dhe stili i jetesës në Britani dhe Amerikë Fjalorthi javor
Java 3:	Kohët e shkuara (Past simple, Past cont.) Shprehjet idiomatike Kolokacionet Crime and justice-justify your viewpoint Mock trial – përgatitja e çështjes kontestimore, mbrojtja
Java 4:	Kohët e kryera (Present perfect, Past perfect, etc) Diskutimi i gramatikës me përdorimin e gazetave Ankandi i fjalive-Aktiviteti për përsëritjen e gramatikës Fjalorthi javor
Java 5:	Format e kohës së ardhme Future continues dhe Future perfect Struktura narrative Post of the day Fjalorthi javor
Java 6:	Klauzolat relative (definuese, jo-definuese) Outdoor Project-Poezi e trotuarit-Të mësuarit e gjuhës përmes letërsisë (diskutimi, analiza) Fjalorthi javor
Java 7:	Gerund dhe Infinitivi Foljet e përcjella nga gerund/infinitivi Monarkia britanike-Mbretëresha Viktoria

	Fjalorthi javor
Java 8:	Testi I
Java 9:	Third Conditional Kolokacionet Fjalët me përdorim të gabuar Fjalët e përdorura si emër dhe folje The changing face of tourism Famous landmarks in a country Fjalorthi javor
Java 10:	Shkronjat pa zë Rregullat e të shkruarit Analizimi i fjalëve të këngës/poezisë Pjesëmarrja në garën <i>Po-e-zë</i> Fjalorthi javor
Java 11:	Diateza pësore Format pësore me have/get (foljet shkaktuese) Domino me diatezë pësore Rreziqet moderne Projekti-TED talks (watch/listen, discuss, oppose/agree) Fjalorthi javor
Java 12:	Foljet modale dhe foljet e ngjashme Format modale e të shkruarës Bisedë (Great ideas; Hopes, dreams and ambitions; Your abilities) Business writing Fjalorthi javor
Java 13:	Situata hipotetike në kohën e tashme Situata hipotetike në kohën e shkuar Kombinimet folje+folje Shkrimi i shqyrtimit të filmit /Movie review Fjalorthi javor
Java 14:	Fjalitë e raportuara Gabimet e shpeshta Sistemi arsimor-përshkrimi, krahasimi-TED talk Përsëritja e fjalorthit javor
Java 15:	Testi II

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Celularët / telefonat e mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPods) duhet të jenë të fikur (ose në

vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë ligjëratave përveç nëse nuk kërkohet për aktivitetin e caktuar në klasë. Aktivitetet e tjera, të tilla si kontrollimi i emailit personal ose shfletimi i faqeve të internetit, janë të ndaluara.

Studentët duhet të sjellin me vete gjithmonë materiale për mbajtjen e shënimeve dhe të jenë të përgatitur për ligjëratat dhe për çdo aktivitet; Ardhja me kohë është thelbësore, si dhe studentët duhen të jenë aktiv gjatë ligjëratave përndryshe vetëm prania fizike do të vlerësohet si mungesë. Nga studentët pritet që të jenë të përgatitur dhe të gatshëm në çdo kohë që të kontribuojnë në aktivitetet në klasë.

## Titulli i lëndës: Gjuhë angleze IV

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Ballkanistikë
Titulli i lëndës:	Gjuhë angleze IV
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti II   Semestri IV
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.Asoc.Dr. Seniha Krasniqi
Të dhënat kontaktuese:	e-mail: seniha.krasniqi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Mësimdhënia dhe mësim nxënia nuk do të ndahen në mënyrë mprehtë, prandaj do të jenë vazhdimisht të ndërlidhura dhe interaktive, duke lejuar secilin student që të marrë pjesë në proces dhe të japë kontributin personal në prodhimin e vazhdueshëm të njohurive.</p> <p>Duke synuar zotërimin e katër shtyllave kryesore të gjuhës, të dëgjuarit, shkruarit, të folurit dhe të lexuarit, në këtë lëndë do të inkuadrohen aktivitete të ndryshme duke përdorur mediat audio-vizuale.</p> <p>Brenda kësaj lënde, studentët do të mësojnë dhe praktikojnë gramatikën e avancuar të gjuhës angleze me një metodë induktive (nga poshtë-lart), duke përfshirë në mënyrë efektive metodën komunikuese e cila bazohet në idenë se të mësuarit e suksesshëm të gjuhës vjen përmes komunikimit real dhe me gramatikë.</p> <p>Lënda thekson komunikimin real që do t'u mundësojë studentëve të përdorin rregullat e mësuara të gramatikës dhe të praktikojnë fjalorin, si dhe i inkurajon ata që të shprehin mendimin e tyre në gjuhën angleze për tema të ndryshme.</p> <p>Aktivitetet në klasë të udhëhequra nga qasja komunikuese karakterizohen duke u përpjekur të prodhojnë komunikim kuptimplotë dhe real. Si rezultat, ka më shumë theks në komunikim, mësimet</p>

	<p>janë më të përqendruara në studentin dhe në përdorimin e materialeve autentike.</p> <p>Shkathtësitë e shkrimit do të forcohen përmes ndërtimit të tregimeve të shkurtra, shkrimit të raportit statistikor, shkrimit rreth çështjeve globale, etj.</p> <p>Kjo lëndë gjithashtu do të nxis të mësuarit e gjuhës përmes letërsisë, si dhe familjarizimin me historinë britanike / amerikane.</p> <p>Për të rritur interesin dhe angazhimin, studentët gjithashtu do të ftohen dhe do të inkurajohen të marrin pjesë në kërkimin, përzgjedhjen, si dhe krijimin e materialeve që do të përdoren në klasë.</p>
<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<p>Qëllimet e lëndës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• t'u mundësoj studentëve të komunikojnë në gjuhën e synuar në këtë nivel të caktuar</li> <li>• t'u mundësoj studentëve që të marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutime në kontekste të njohura, duke llogaritur dhe mbështetur pikëpamjet.</li> <li>• të rris besimin dhe aftësinë e studentëve për të komunikuar me folës amtarë dhe jo-amtarë të anglishtes, si në të folur ashtu edhe në shkrim</li> <li>• të nxis studentët që në mënyrë individuale të përdorin përvojën e tyre e të mësuarit</li> <li>• t'i inkurajoj studentët që në mënyrë individuale të marrin përgjegjësinë për progresin e tyre e të nxënit, duke u përpjekur kështu ta rrisin atë</li> </ul>
<p>Rezultatet e pritshme të nxënies:</p>	<p>Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojnë tekstet e gjata dhe komplekse faktike dhe letrare,</li> <li>- të kuptojnë tekstet e specializuara dhe udhëzimet më të gjata teknike, edhe kur ato nuk kanë të bëjnë me fushën e tyre.</li> <li>- të shprehën në mënyrë të rrjedhshme dhe spontane pa shumë kërkime të dukshme për shprehje/fjalë.</li> <li>- të përdorin gjuhën në mënyrë eksplicite dhe efektive për qëllime sociale dhe profesionale</li> <li>- të formulojnë idetë dhe mendimet me saktësi</li> </ul>

- të shprehen në një tekst të qartë dhe të strukturuar, duke shprehur pikëpamjen e tyre.

- të shkruajnë rreth temave komplekse në një letër, një ese ose një raport, që përmbanë çështje relevante.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	2	14	28
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	8	2
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	3	2	6
Detyrë shtëpie	1	14	14
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	12	24
Përgatitja për provimin final	1	13	13
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj.	2	5	10
<b>Totali</b>			<b>125.5x25 5 ECTS</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Forma e rregullt e ligjëratave përbëhet nga 2 orë në javë. Metoda e ligjërimit do të jetë me studentët në qendër dhe interaktive. Punët individuale dhe grupore do të jenë të shpeshta dhe në përputhje me materialin që duhet mbuluar.</p> <p>Studentët duhet të ndjekin rregullisht ligjëratat. Studentët do të jenë të detyruar të përgatisin një prezantim në klasë. Pjesëmarrja aktive e studentëve inkurajohet në mënyrë që ata të zhvillojnë aftësitë e tyre komunikuese. Përdorimi i materialit autentik nga burime të ndryshme lehtëson mësimin. Studentët do të angazhohen në aktivitete jashtë kurrikulare që synojnë rritjen e njohurive të tyre mbi sfondin e gjuhës dhe</p>
-------------------------------------	--

	<p>kulturës angleze.</p> <p>Studentët gjithashtu mund të marrin pjesë në konsultime individuale të mësimdhënies, ku mësimdhënësi jep udhëzime dhe informata kthyesë mbi procesin e tyre të të mësuarit.</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë;</p> <p>Vijueshmëria-5%</p> <p>Pjesëmarrja ne diskutime-10%</p> <p>Prezantimi- 15 %</p> <p>Testi I -10 %</p> <p>Testi II – 10%</p> <p>Provimi përfundimtar – 50 %</p>
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. CUNNINGHAM, Sarah – MOOR, Peter, BYGRAVE, Jonathan, New Edition <i>Cutting Edge</i>-Advanced Student Book, Pearson Longman, Harlow, United Kingdom, 2014</li> <li>2. CUNNINGHAM, Sarah – MOOR, Peter, BYGRAVE, Jonathan, New Edition <i>Cutting Edge</i>-Advanced Workbook, Pearson Longman, Harlow, United Kingdom, 2014</li> <li>1. DOOF, Adrian-GOLDSTEIN Ben, <i>English Unlimited</i> Advanced Coursebook, Cambridge University Press, 2011</li> </ol>
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. XENDEN, Clive-Latham Koenig Christian, New English File Advanced, Oxford University Press, 2005</li> <li>2. BURT, Angela, The A-Z of Correct English, How to Books Publishing, Oxford, 2002</li> <li>3. CUNNINGHAM, Sarah – MOOR, Peter, BYGRAVE, Jonathan, New Edition <i>Cutting Edge</i>-Advanced Teacher's resource book, Pearson Longman, Harlow, United Kingdom, 2014</li> </ol>

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	<p>Hyrje në lëndën gjuhë angleze 4</p> <p>Diskutime mbi planin e veprimit për përmbushjen e nevojave të studentëve</p>
Java 2:	<p>Format e foljeve në kohët e vazhdueshme (përdorimi i veçantë i formave <i>continuous</i>)</p> <p>Foljet me ndryshim të kuptimit në formën <i>continuous</i> dhe të thjeshtë</p> <p>Variacionet e gjuhës angleze</p> <p>Anglishtja Britanike kundrejt Anglishtes Amerikane</p>

Java 3:	Format e kryera të foljeve Fjalitë e ndara (Cleft sentences) Ndërtimi i tregimeve të shkurtra – shprehja e emocioneve të përziera Shprehjet idiomatike
Java 4:	Foljet modale dhe foljet e ngjashme Modele me emra abstrakte dhe klauzola relative Shprehja e sjelljes së mirë kundrejt sjelljes së pahijshme – Sjellja e përsosur në botën e papërsosur
Java 5:	Mbiemrat dhe Ndajfoljet – renditja Mbiemrat e përbërë Mbiemrat e shkallëzuar dhe jo-shkallëzuar Ndajfoljet e shkallës Modelet në formën krahasore dhe sipërore
Java 6:	Infinitivi Aktiv dhe Pasiv Përdorimi dhe mos-përdorimi i formave pësore Diateza pësore pa foljen “jam” Foljet + parafjalët/pjesëzat
Java 7:	Koha dhe kohët gramatikore Inversioni me format negative ndajfoljore Shprehjet e avancuara sasiore Të shkruarit e raportit statistikor
Java 8:	Test 1
Java 9:	Infinitivi me/pa <i>to</i> dhe <i>-ing</i> Frazat e përbëra Çështjet globale- Anët pozitive të migrimit dhe shoqëritë multi-kulturore
Java 10:	Ndajfoljet (e mënyrës, e shkallës, ndajf. të cilat ndryshojnë pozitë në fjali) Ndajfoljet e komentit dhe pikëpamjes Theksimi me foljet ndihmëse
Java 11:	Format e të ardhmes Ndryshimi i turizmit Kolokacionet me termet kompjuterike Gjuhë kritike
Java 12:	Frazat emërore Ellipset dhe zëvendësimet Shprehja e befasisë dhe mosbesimit Çështjet shoqërore në botë - Rasti i lindjes dhe preferencave të fëmijëve në Kinë (kundrejt Kosovës)

Java 13:	Fjalët e ngatërruara Gabimet e shpeshta Renditja e fjalëve në klauzolat me fjalët <i>WH</i> Mësimi i gjuhës përmes letërsisë – Fjalimi i Hamletit “të rrosh apo të mos rrosh”
Java 14:	Analizat e Proverbave Shprehje idiomatike Baballarët themelues së Amerikës -Benjamin Franklin Përsëritja e fjalorthit javor
Java 15:	Testi II

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Gjatë tërë kohëzgjatjes së kësaj lënde, studentët në mënyrë aktive marrin pjesë në zgjerimin e njohurive të tyre në këtë fushë. Pas ligjëratave, studentët zhvillohen përmes punës jashtë kurrikulare, si në bibliotekë, detyrat e shtëpisë dhe seminarët. Mësimet dhe aktivitetet jashtë kurrikulare (pjesëmarrja / të mësuarit) i ndihmojnë ata që të zhvillohen në këtë fushë.

Celularët / telefonat e mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPods) duhet të jenë të fikur (ose në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë ligjëratave përveç nëse nuk kërkohet për aktivitetin e caktuar në klasë. Aktivitetet e tjera, të tilla si kontrollimi i emailit personal ose shfletimi i faqeve të internetit, janë të ndaluara.

Studentët duhet të sjellin me vete gjithmonë materiale për mbajtjen e shënimeve dhe të jenë të përgatitur për ligjëratat dhe për çdo aktivitet; Ardhja me kohë është thelbësore, si dhe studentët duhen të jenë aktiv gjatë ligjëratave përndryshe vetëm prania fizike do të vlerësohet si mungesë. Nga studentët pritet që të jenë të përgatitur dhe të gatshëm në çdo kohë që të kontribuojnë në aktivitetet në klasë.

## Titulli i lëndës: GJUHË E SOTME AMTARE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Gjuhë e sotme amtare
Niveli:	BA (Baçelor)
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I   Semestri II
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	7 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa   Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Bahri Koskoviku
Të dhënat kontaktuese:	bahri.koskoviku@gmail.com
Përshkrimi i lëndës:	Në kursin <i>Gjuhë e sotme amtare</i> studenti pajiset me njohuri të përgjithshme për gjuhën, e konceptuar si gjuhë amtare, me zhvillimin historik të gjuhës shqipe; me strukturën e fjalës (koncepti i rrënjës dhe formantët), fjalëformimin, si dhe me klasat e fjalëve. Pastaj duke vazhduar me strukturën sintaksore të shqipes: tipat e fjalisë sipas kuptimit dhe strukturës; përbërësit bazë të fjalisë, me disa veçori specifike të ndërtimit të fjalisë për shqipen . Më pas ofrohen njohuritë bazike për sistemin e prododik të shqipes; jepet një pasqyrë e përgjithshme e rregullave drejtshkrimore të shqipes dhe për sistemin e pikësimit. Pjesa përfundimtare merret me problemet aktuale të shqipes sot dhe me problemet me të cilat ballafaqohen shqipfolësit sot në kontekstin e zhvillimeve bashkëkohore intelektuale e kulturore.
Qëllimet e lëndës:	Kjo lëndë synon që t'i ndërgjegjësojë studentët për rëndësinë e njohjes së gjuhës amtare, e cila përdoret në çdo fushë profesionale të jetës bashkëkohore. Synohet që performanca gjuhësore e studentit në gjuhën amtare të arrijë nivel solid, në mënyrë që ai të jetë në gjendje t'i shprehë mendimet e tij në formën folur dhe të shkruar duke u pajisur me informacionet bashkëkohore gjuhësore, letrare dhe kulturore.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• definojnë gjuhën, vendin dhe kuptimin e gjuhës amtare në jetën e një populli;</li> <li>• demonstrojnë vendin e gjuhës amtare në kuadrin e gjuhëve botërore;</li> <li>• bëjnë dallimin midis gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar;</li> <li>• definojnë fjalën, klauzën, fjalinë;</li> <li>• përdorin gjymtyrët e fjalisë dhe grupet e fjalëve;</li> <li>• aplikojnë rregullat e drejtshkrimit në tekste të shkruara;</li> <li>• identifikojnë dhe analizojnë çrregullimet kuptimore dhe të shprehurisë në tekste të folura dhe të shkruara;</li> <li>• zgjidhin probleme gjuhësore konkrete të caktuara nga</li> </ul>

	mësimdhënësi;		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• diskuton dhe rekomandon zgjidhje për problemet më të përgjithshme të gjuhës së sotme shqipe.</li> </ul>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)</b>			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjërata	2 (45 min)	15	22.5
Ushtrime	2 (45 min)	15	22.5
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	15	3.45
Përgatitje për test intermediar	10	2	20
Testi, punimi i seminarit	2	15	30
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	10	3	30
Përgatitja për provimin final	2	2	4
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	2	2	4
<b>Totali</b>			170.45 orë 170.45:25=6.81 7 ECTS
<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	<p>Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrimeve që ofrojnë bazën praktike në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi.</p> <p>Mësimdhënia gjatë ligjëratave do të jetë e organizuar nëpërmjet një diskutimi interaktiv për tema të caktuara. Gjatë ushtrimeve mësimdhënia është e orientuar nga studentët, ndërsa mësimdhënësi e kontrollon rrjedhën e orës dhe të shpjegimit të koncepteve të diskutueshme e të paqarta.</p> <p>Studentët kanë punime seminari e punime të tjera me shkrim të kryera në mënyrë të pavarur e individuale, por bëjnë edhe punë në çifte e në grupe, si edhe hulumtime. Përmes projekteve e prezantimeve nxiten debate e diskutime midis tyre. Ndiqen edhe emisione në radio e TV, filma e shfaqje teatrale etj. dhe diskutohet për to.</p>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 51%.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vijueshmëria 5%</li> <li>• Pjesëmarrja aktive 5%</li> <li>• Detyrat individuale 10%</li> <li>• Prezantimi 10%;</li> <li>• Seminari 10%;</li> <li>• Kolokuiumi I 30%</li> <li>• Kolokuiumi II 30%</li> </ul> <p>Gjithsej 100%: 51-60% (nota 6), 61-70 (7), 71-80 (8), 81-90 (9), 91-100 (10).</p>		
<b>Literatura primare:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. John Lyons, Hyrje në gjuhësinë teorike. Tiranë: Dituria, 2001.</li> <li>2. Gramatika e gjuhës shqipe 1 (Morfologjia), Tiranë: ASHSH, 2002.</li> <li>3. Gramatika e gjuhës shqipe (sintaksa) 2, Tiranë: ASHSH, 2002.</li> <li>4. Anastas Dodi, Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe. Tiranë, 2004.</li> <li>5. Shaban Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj. Tiranë: Onufri, 2013.</li> <li>6. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH, 1973.</li> <li>7. Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe. Tiranë: ASHSH, 2002.</li> </ol>		
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bardh Rugova, Leksikon i termave të fonetikës dhe të fonologjisë. Prishtinë: ASHAK,</li> <li>2. Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë: ASHSH, 2006. Në: <a href="http://www.fjalorthi.com">www.fjalorthi.com</a></li> <li>3. Gjovalin Shkurtaç, Kultura e gjuhës. Tiranë, 2006.</li> </ol>		

4. Isa Bajçnica, Shqipja standarde dhe probleme rreth saj. Prishtinë, 2016.
5. Mehmet Çeliku, Sintaksë e gjuhës shqipe. Tiranë, 2012.
6. Qemal Murati, Gjuha shqipe në komunikimet publike. Prishtinë, 2013.
7. Rami Memushaj, Shqipja standarde – Si ta flasim dhe ta shkruajmë. Tiranë, 2004.

## Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Njohuri të përgjithshme për gjuhën. Përkufizimet për gjuhën. Teoritë për lindjen e gjuhëve.
Java 2:	Gjuha shqipe dhe historia e saj. Shkrimet e para të shqipes; veprat e para të shqipes së dokumentuar dhe autorët kryesorë të periudhës së dokumentuar të shqipes
Java 3:	Shtirja gjeografike, dialektet e shqipes dhe dallimet ndërdialektore
Java 4:	Sistemi prozodik i shqipes së sotme: theksi; intonacion, ritmi. Fonologjia.
Java 5:	Gjuha letrare shqipe, baza e saj dialektore; Projekti i rregullave të drejtshkrimit; fenomeni i paskajores.
Java 6:	Morfologji. Struktura e fjalës: analiza morfemore dhe analiza fjalëformuese. Mënyrat e fjalëformimit
Java 7:	Klasat e fjalëve: sistemi emëror i shqipes dhe sistemi foljor i shqipes. Klasat e pandryshueshme. Test 1
Java 8:	Sintaksë: Përkufizimi i fjalisë; tipat e fjalisë sipas kuptimit dhe strukturës; përbërësit e fjalisë së thjeshtë, konceptet: grup i fjalëve (sintagmë), strukturë hierarkike e fjalisë, strukturë argumentore e foljes; gramatikaliteti dhe jogramatikaliteti.
Java 9:	Përbërësit sintaksorë të fjalisë së thjeshtë: grupi emëror (GE) dhe grupi foljor (GF); funksionet semantike dhe gramatikore.
Java 10:	Fjalja e përbërë: tipat e marrëdhënieve sintaksore: bashkërenditja, nënrenditja dhe fjalitë jolidhëzore
Java 11:	Rregullat e drejtshkrimit: Drejtshkrimi i zanoreve. Grupe zanoresh dhe diftongje. Takimi i dy zanoreve të njëjta. Grupe dhe takime bashkëtingëlloresh. Trajtat e shkurtra të përemrave vetorë, gabimet në vetë dhe në numër.
Java 12:	Rregullat e drejtshkrimit: Shkrimi i nyjës së përparme. Shkrimi i disa pjesëzave dhe i disa parafjalëve. Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes. Përdorimi i shkronjës së mëdha. Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit. Shkrimi i datave.
Java 13:	Rregullat e pikësimit
Java 14:	Problemet e gjuhës së sotme shqipe I. Problemi i vetëdijesimit për gjuhën amtare. Problemi i pakujdesit ndaj ndikimit të gjuhëve të huaja mbi gjuhën amtare. Problemi i prirjes për të marrë një edukim në gjuhë të huaj në vend se të merret një edukim cilësor për gjuhën e huaj.
Java 15:	Problemet e gjuhës së sotme shqipe II. Problemi: shqipja dhe gjuha shkencore. Moskujdesi ndaj përdorimit të gjuhës shqipe në mjetet të komunikimit masiv siç janë televizioni, interneti etj. Problemi i gjuhës së përbashkët komunikimi me botën shqiptare. Rekomandimet për zgjidhjen e këtyre problemeve.
	Testi 2

## **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët janë të obliguar t'i vijnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.

## Lënda: Gjuhë e sotme ballkanike I (KURS I GJUHËS - NIVELI A2)

Informata bazë për lëndën	
Njësia akademike:	Ballkanistikë
Titulli i lëndës:	Gjuhë e sotme ballkanike I (kurs i gjuhës - niveli A2)
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve	Viti I   Semestri I
Fondi i orëve në javë:	2+4
Kredi ECTS:	7
Koha/Vendi:	
Ligjërues/e i/e lëndës:	
Informata kontakti:	
Përshkrimi i lëndës:	Gjuhë e sotme ballkanike I (GJSB) (kursi i gjuhës - niveli A2) është një kurs i gjuhës së dytë në nivelin A2 sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës për Gjuhët (CEFR), që është një standard ndërkombëtar për përshkrimin e shkathtësive gjuhësore. Në këtë lëndë studentët do të mësojnë sipas udhëzimeve të dhëna nga CEFR dhe do të përvetësojnë aftësi gjuhësore të: të dëgjuarit dhe të kuptuarit e njërës prej gjuhëve ballkanike; komunikimin në të folur dhe prodhimin e të folurit; të lexuarit dhe të shkruarit. Në këtë nivel të njohurive gjuhësore, studentët duhet të fitojnë aftësi për të folur për gjëra të zakonshme duke përdorur një fjalor të kufizuar: ata mund ta prezantojnë veten, të shpjegojnë rutinën e tyre të përditshme, dëshirat dhe nevojat, si dhe ata mund të kërkojnë informata në mënyrë të thjeshtë. Ata udhëzohen se si t'i kuptojnë shprehjet dhe fjalët që përdoren shpesh e që kanë të bëjnë me çështje themelore personale dhe të përditshme; të jenë në gjendje të bëjnë bashkëbisedime sociale shumë të shkurtra; të jenë në gjendje të kuptojnë dhe lexojnë në mënyrë të pavarur tekste të thjeshta; të gjejnë informatat në tekste më të gjata; të shkruajnë në mënyrë të pavarur tekste të shkurtra e të thjeshta.

### Qëllimet e lëndës:

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që t'u ndihmojë studentëve të përvetësojnë shkathtësi gjuhësore të një folësi të nivelit të ndërmjetëm në mënyrë që ata të mund të vijojnë kursin e gjuhës B1 në semestrin e radhës. Kjo do të thotë që studentët duhet t'u ligjërohen të gjitha fushat e shkathtësive gjuhësore sipas CEFR (të dëgjuarit dhe të kuptuarit e Gjuhës BSKM; bashkëbisedimi dhe prodhimi i të folurit; lexim dhe shkrim) me një rezultat të kënaqshëm për këtë nivel fillestar të para-ndërmjetëm. Vëmendje e posaçme do t'i kushtohet komunikimit në të folur.

### Rezultatet e pritura të të nxënit:

Me rastin e përfundimit të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të kuptojnë shprehjet dhe fjalët që përdoren shpesh e që kanë të bëjnë me çështjet themelore personale dhe të përditshme;

- Të kenë biseda shumë të shkurta;

- Të kuptojnë dhe lexojnë në mënyrë të pavarur tekste të shkurta e të thjeshta;

- Të përvetësojnë një vokabular themelor që u mundëson atyre të merren me situata të përditshme me përmbajtje të parashikueshme;

- Të përdorin kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme të foljeve bazike;

- Të shkruajnë në mënyrë të pavarur tekste të shkurta e të thjeshta.

### Ngarkesa e punës së studentëve (e cila duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2 (90 min)	15	22.5
Punë praktike	4 (180min)	15	45
Përgatitje për teste	1,5 (90min)	15	22.5
Konsultime me ligjëruesin e lëndës	10 min	15	2.5
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Studim vetanak (bibliotekë/shtëpi)	2	13	26
Përgatitja e provimit përfundimtar	5	6	30
Koha e vlerësimit (testi, kuiz, provim përfundimtar)	1	3	3

Projekte, prezantime	2	2	4
Gjithsej			175,5 hours 175,5:25 = 7,02 7 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata teorike; ushtrime gjatë orës së mësimit duke përdorur materiale të ndryshme; ligjërata praktike me asistentin e lëndës - ushtrime të ndryshme interaktive; detyra individuale të shtëpisë (përkthime të thjeshta nga gjuha amtare e studentëve në BSKM dhe anasjelltas; ushtrime në fletore pune; ese të shkurtra, ushtrime gramatikore dhe ushtrime të ndërtimit të vokabularit etj.); dëgjimi i gjuhës së folur BSKM në programe të zgjedhura televizive/Internet (filma, muzikë, programe televizive edukative) ose ushtrime bashkëbisedimi/dëgjimi me folës të cilët BSKM e kanë gjuhë amtare jashtë fakultetit si punë në terren; studim vetanak.		
Metodat e vlerësimit:	Pragu për kalimin e lëndës 60%;  Vijimi i ligjëratave nga studenti 30%; Detyrat individuale të përfunduara në klasë 10%; Detyrat individuale të përfunduara në shtëpi 10%; Vlerësimi nga testet 40%; Provimi përfundimtar 10%; Gjithsej 100%.		
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bjelaković, I., Vojnović, J. (2013). <i>Naučimo srpski 1</i> [Le të mësojmë gjuhën serbe]. Novi Sad: Universiteti në Novi Sad</li> </ul>		
Literaturë ndihmëse:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ribnikar, V., Norris, D. (2003). <i>Teach yourself Serbian</i> [Mësoje vetë gjuhën serbe]. US: Libra bashkëkohorë.</li> <li>- Ajdžanović, M., Çerpija, A., Kananaj, A., Štrbac, G. (2017). Mali rečnik / Fjalor i vogël: srpsko-albanski / albansko-srpski rečnik. Stručna revizija: Anila Kananaj. Hagë: Komisionari i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare</li> <li>- Alexander, R., Elias Bursać, E. (2006). <i>Bosnian, Croatian, Serbian, a textbook with excercises and basic grammar</i> [Gjuha boshnjake, kroate, serbe, libër me ushtrime dhe gramatikë bazike]. The University of Wisconsin Press</li> <li>- Hawkesworth, C., Čalić, J. (2006). <i>Colloquial Serbian</i> [Gjuha e folur serbe]. London: Routledge</li> <li>- Pešikan, M., Jerković, J., Pižurica, M. (2011). <i>Pravopis srpskog jezika</i> [Drejtshkrimi i gjuhës serbe]. Novi Sad: Matica srpska</li> <li>- Piper, P., Klajn, I. (2013). <i>Normativna gramatika srpskog jezika</i> [Gramatika normative e gjuhës serbe]. Novi Sad: Matica srpska</li> <li>- Stanojčić, Ž., Popović, Lj. (1992). <i>Gramatika srpskoga jezika</i>.</li> </ul>		

*Udžbenik za I, II, III i IV razred srednje škole* [Gramatika e gjuhës serbe. Libër shkollor për klasat I, II, III dhe IV të shkollës së mesme]. Beograd: Zavod za udžbenike i nastavna sredstva [Enti i librit shkollor dhe mjeteve didaktike].

- Tuna, E. et al. (2005). Albanski rečnik (albansko-srpski i srpsko-albanski) [Fjalor i gjuhës shqipe (shqip-serbisht dhe serbisht-shqip)]. Beograd: Jasen
- Miketić Subotić, S., Jovanović, B. (2019). *Srpski jezik 2. Učenje srpskog jezika za civilne službenike na Kosovu* [Gjuha serbe 2. Mësimi i gjuhës serbe për nëpunësit civilë në Kosovë]. Priština: OSBE, ECMI (libër, fletore pune dhe libër për mësimdhënësin)
- <https://fjalor-recnik.com/>

## Përmbajtja e lëndës

Java	Tema
Java 1:	Përshkrimi i lëndës/literaturës Prezantimi i temës, obligimeve dhe vlerësimit të studentëve Diskutime mbi planin e veprimit për zhvillimin e gjuhës BCSM të studentëve; Teknikat e të mësuarit të vokabularit; Diskutimi rreth prezantimeve.
Java 2:	Përshëndetjet; Informatat personale; Alfabeti i gjuhës BSKM; Përemrat vetorë; Fjalorthi javor.
Java 3:	Numrat dhe datat; Muajt e vitit; Ditët e javës; Shprehitë dhe rutina ditore; Koha e tashme e foljes BITI (JAM); Koha e tashme e foljes IMATI (KAM); Fjalorthi javor.
Java 4:	Kërkimi i informatave; Fjalitë pyetëse, parashtrimi i pyetjeve; Fjalët pyetëse KO, ŠTA, GDE, KAD, KAKO (KUSH, ÇFARË, KU, KUR, SI) Fjalorthi javor.
Java 5:	Përshkrimi i njerëzve; Pjesët e trupit; Zgjedhimi i foljeve;

	Koha e tashme (forma pohore dhe mohore); Fjalorthi javor.
Java 6:	Përshkrimi i vendeve; Shtëpia ime; Lakimi i emrave; Gjinia e emrave; Fjalorthi javor
Java 7:	Krijimi i takimeve; Në qytet; Koha e ardhme e foljeve BITI (JAM) dhe IMATI (KAM); Përgatitja për test; Fjalorthi javor.
Java 8:	Testi I
Java 9:	Situatat e përditshme: dyqani i ushqimeve; Në restorant; Ushqime dhe pije; Shumësi i emrave mashkullore; Mbiemrat mashkullorë; Fjalorthi javor.
Java 10:	Situatat e përditshme: shkolla, puna, fakulteti etj. Shumësi i emrave femërore; Mbiemrat femërorë; Fjalorthi javor.
Java 11:	Situatat e përditshme: hobi dhe koha e lire; Shumësi i emrave asnjans; Mbiemrat asnjans; Fjalorthi javor.
Java 12:	Situatat e përditshme: udhëtimet, fundjavë etj.; Tregimi i storieve; Koha e kryer; Lakimi i emrave: përdorimi i rasës emërore Fjalorthi javor
Java 13:	Situatat e përditshme: banka, posta, zyra Parashtrimi i pyetjeve për orientim; Lakimi i emrave: përdorimi i rasës gjinore; Alfabeti cirilik; Fjalorthi javor
Java 14:	Përgatitja për test

**Politikat akademike dhe kodi i mirësjelljes**

Përdorimi i telefonave mobilë nuk lejohet gjatë ligjëratave, si dhe për arsyen që vijimësia në ligjërata ndikon në notën përfundimtare të studentit, studentët nuk mund të hyjnë e të dalin nga klasa kur të duan. Studentët inkurajohen të diskutojnë çështje të ndryshme që lidhen me njësinë e kryer, pa ofenduar ose diskriminuar njeri-tjetrin dhe duke respektuar mendimin e tjetrit.

## Lënda: Gjuhë e sotme ballkanike II (kurs i gjuhës - niveli B1)

Informata bazë për lëndën	
Njësia akademike:	Ballkanistikë
Titulli i lëndës:	Gjuhë e sotme ballkanike II (kurs i gjuhës - niveli B1)
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I   Semestri II
Fondi i orëve në javë:	2+4
Kredi ECTS:	7
Koha/Vendi:	
Ligjërues/e i/e lëndës:	
Informata kontakti:	
Përshkrimi i lëndës:	Gjuhë e sotme ballkanike II (kursi i gjuhës - niveli B1) është një kurs i gjuhës së dytë në nivelin B1 sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës për Gjuhët (CEFR), që është një standard ndërkombëtar për përshkrimin e shkathtësive gjuhësore. Në këtë lëndë studentët do të mësojnë sipas udhëzimeve të dhëna nga CEFR dhe do të përvetësojnë aftësi gjuhësore të: të dëgjuarit dhe të kuptuarit e Gjuhës së sotme ballkanike; komunikimin në të folur dhe prodhimin e të folurit; të lexuarit dhe të shkruarit. Në këtë nivel të njohurive gjuhësore, studentët mund t'i kuptojnë pikat kryesore të inputit të qartë standard për aspekte të njohura që hasen rregullisht në punë, shkollë, kohë të lirë etj. Ata janë në gjendje që të përballen me shumicën e situatave që mund të lindin ndërsa udhëtojnë në një zonë ku flitet gjuha dhe mund të prodhojnë një tekst të lidhur të thjeshtë me tema të cilat janë të njohura ose me interes personal. Ata mund të përshkruajnë përvojat dhe ngjarjet, ëndrrat, shpresat dhe ambiciet dhe shkurtimisht të japin arsye dhe shpjegime për mendimet e planet e tyre. Studentët duhet të fitojnë shkathtësi të të folurit duke përdorur një vokabular të kufizuar për gjëra të rëndomta: ata mund ta prezantojnë veten, të shpjegojnë rutinën e tyre të përditshme, dëshirat dhe nevojat, mund të kërkojnë informacion në një mënyrë të thjeshtë.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që t'u ndihmojë

studentëve të përvetësojnë shkathtësi gjuhësore të një folësi të nivelit të ndërmjetëm në mënyrë që ata në mënyrë të pavarur të mund ta përdorin gjuhën në situata të zakonshme. Kjo do të thotë që studentët duhet t'u ligjërohen të gjitha fushat e shkathtësive gjuhësore sipas CEFR (të dëgjuarit dhe të kuptuarit e Gjuhës së sotme ballkanike; bashkëbisedimi dhe prodhimi i të folurit; lexim dhe shkrim) në nivel të ndërmjetëm, me fokus të posaçëm në të folurit dhe ndërveprimin.

Rezultatet e pritura të të nxënit:

Me përfundimin e kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë pikat kryesore të inputit standard të qartë për çështje të njohura që hasen rregullisht në punë, shkollë, kohë të lirë etj.;

- Të përballen me shumicën e situatave që mund të lindin ndërsa udhëtojnë në një zonë ku flitet gjuha në fjalë;

- Të prodhojnë një tekst të lidhur të thjeshtë me tema të cilat janë të njohura ose me interes personal;

- Të përshkruajnë përvojat dhe ngjarjet, ëndrrat, shpresat dhe ambiciet dhe shkurtimisht të japin arsye dhe shpjegime për mendimet dhe planet;

- Të kuptojnë shprehjet dhe fjalët që përdoren shpesh e që kanë të bëjnë me çështjet themelore personale dhe të përditshme;

- Të përvetësojnë një vokabular themelor që u mundëson atyre të merren me situata të përditshme me përmbajtje të parashikueshme;

- Të përdorin kohën e tashme, të shkuar dhe e të ardhme të foljeve themelore; ligjëratën e zhdrejtë, fjalitë e varura kushtore, të krahasojë dhe të përdorin saktë gramatikusht shumicën e rasave;

-Në mënyrë të pavarur të shkruaj tekste të gjata por të thjeshta.

#### Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjërata	2 (45 min)	15	22.5
Ushtrime	4 (45 min)	15	45
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	8	3

Testi, punimi i seminarit	10	1	10
Detyrë shtëpie	2	10	20
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	13	26
Përgatitja për provimin final	13	2	36
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	2	2	4
<b>Totali</b>			<b>170.5 orë</b> <b>175:25=7</b> <b>7 ECTS</b>

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata teorike; ushtrime gjatë orës së mësimit duke përdorur materiale të ndryshme; ligjërata praktike me asistentin e lëndës - ushtrime të ndryshme interaktive; detyra individuale të shtëpisë (të thjeshta nga gjuha amtare e studentëve në BSKM dhe anasjelltas; ushtrime në librin e punës; ese të shkurtra etj.); dëgjimi i gjuhës së folur të BSKM në programe të zgjedhura televizive/Internet (filma, muzikë, programe televizive edukative) ose ushtrime bashkëbisedimi/dëgjimi me folës të cilët BSKM e kanë gjuhë amtare jashtë fakultetit si punë në terren; studim vetanak.
Metodat e vlerësimit:	Pragu për kalimin e lëndës 60%; Vijimi i ligjëratarave nga studenti 30%; Detyrat individuale të përfunduara në klasë 10%; Detyrat individuale të përfunduara në shtëpi 10%; Vlerësimi nga testet 40%; Provimi përfundimtar 10%; Gjithsej 100%.
Literatura bazë:	Bjelaković, I., Vojnović, J. (2013). Naučimo srpski 1 [Le të mësojmë gjuhën serbe]. Novi Sad: Universiteti në Novi Sad
Literaturë ndihmëse:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ribnikar, V., Norris, D. (2003). Teach yourself Serbian [Mëso vetë gjuhën serbe]. US: Libra bashkëkohorë.</li> <li>- Ajdžanović, M., Čerpja, A., Kananaj, A., Štrbac, G. (2017). Mali rečnik / Fjalor i vogël: srpsko-albanski / albansko-srpski rečnik. Stručna revizija: Anila Kananaj. Hagë: Komisionari i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare</li> <li>- Alexander, R., Elias Bursać, E. (2006). <i>Bosnian, Croatian, Serbian, a textbook with exercises and basic grammar</i> [Gjuha boshnjake, kroate, serbe, libër me ushtrime dhe gramatikë bazike]. The University of Wisconsin Press</li> <li>- Hawkesworth, C., Čalić, J. (2006). <i>Colloquial Serbian</i> [Gjuha e folur serbe]. London: Routledge</li> <li>- Pešikan, M., Jerković, J., Pižurica, M. (2011). <i>Pravopis srpskog</i></li> </ul>

- jezika* [Drejtshkrimi i gjuhës serbe]. Novi Sad: Matica srpska
- Piper, P., Klajn, I. (2013). *Normativna gramatika srpskog jezika* [Gramatika normative e gjuhës serbe]. Novi Sad: Matica srpska
  - Stanojčić, Ž., Popović, Lj. (1992). *Gramatika srpskoga jezika. Udžbenik za I, II, III i IV razred srednje škole* [Gramatika e gjuhës serbe. Libër shkollor për klasat I, II, III dhe IV të shkollës së mesme]. Beograd: Zavod za udžbenike i nastavna sredstva [Enti i librit shkollor dhe mjeteve didaktike].
  - Tuna, E. et al. (2005). *Albanski rečnik (albansko-srpski i srpsko-albanski)* [Fjalor i gjuhës shqipe (shqip-serbisht dhe serbisht-shqip)]. Beograd: Jasen
  - Miketić Subotić, S., Jovanović, B. (2019). *Srpski jezik 3. Učenje srpskog jezika za civilne službenike na Kosovu*. [Gjuha serbe 3. Mësimi i gjuhës serbe për nëpunësit civilë në Kosovë]. Priština: OSBE, ECMI (libër, fletore pune dhe libër për mësimdhënësin)
  - <https://fjalor-recnik.com/>

## Përmbajtja e lëndës

Java	Tema
Java 1:	Përshkrimi i lëndës/literaturës; Prezantimi i temës, obligimeve dhe vlerësimit të studentëve; Njoftimi mbi objektivat, rezultatet e pritura të nxënies, metodat e mësimdhënies dhe metodat e vlerësimit; Diskutime mbi planin e veprimit për zhvillimin e gjuhës BCSM të studentëve; Pyetjet dhe rekomandimet e studentëve
Java 2:	Përshëndetjet; bisedat e rastit; Informatat personale; Lidhjet farefisnore: të afërmit e mi; Lakimi i përemrave pronorë; Fjalorthi javor.
Java 3:	Kërkimi i informatave; Përsëritja e formave të foljeve; Foljet vetvetore; Fjalorthi javor.
Java 4:	Situatat e përditshme: dyqani i ushqimeve Foljet ndihmëse HTETI (DUA) dhe JESAM (JAM) Fjalorthi javor.
Java 5:	Situatat e përditshme: shkolla, fakulteti, puna etj. Shkrimi i letrës/postës elektronike; Foljet modale (MOĆI, HTETI, ŽELETI, MORATI, SMETI, UMETI, VOLETI, TREBATI); Obligimet dhe lejet në kohën e tashme/e shkuar

	Lakimi i emrave: përdorimi i rasës dhanore; Fjalorthi javor.
Java 6:	Situatat e përditshme: udhëtimet, koha e lirë; Lakimi i emrave: përdorimi i rasës kallëzore; Rendi i fjalëve në fjali; Fjalorthi javor.
Java 7:	Bisedat e përditshme: ëndrrat, shpresat dhe ambiciet; Ndajfoljet; Shkrimi i ankesës zyrtare Përgatitja për test; Fjalorthi javor.
Java 8:	Testi I
Java 9:	Bisedat e përditshme: librat e letërsia; Koha e pakryer; Fjalorthi javor.
Java 10:	Bisedat e përditshme: arsimi; Përsëritja e formave të mbiemrave; Krahasimi i mbiemrave; Fjalorthi javor.
Java 11:	Bisedat e përditshme: lajmet; mediat, filmat etj. Shprehja e mendimit për tema të ndryshme dhe përshkrimi i ngjarjeve; Lidhëzat A, ALI, ILI Fjalorthi javor.
Java 12:	Bisedat e përditshme: stili i jetës; shëndeti dhe higjiena; Parafjalët; Lakimi i emrave: përdorimi i rasës instrumentale; Fjalorthi javor.
Java 13:	Bisedat e përditshme: çfarë tipi je?; ngjyrat; Lakimi i emrave: përdorimi i rasës vendore; Alfabeti cirilik: përsëritja Fjalorthi javor.
Java 14:	Përgatitja për test
Java 15:	Testi II dhe përgatitja për provim

### **Politikat akademike dhe kodi i mirësjelljes**

Përdorimi i telefonave mobilë nuk lejohet gjatë ligjëratave, si dhe për arsye që vijimësia në ligjërata ndikon në notën përfundimtare të studentit, studentët nuk mund të hyjnë e të dalin nga klasa kur të duan. Studentët inkurajohen të diskutojnë çështje të ndryshme që lidhen me njësinë e kryer, pa ofenduar ose diskriminuar njeri-tjetrin dhe duke respektuar mendimin e tjetrit.



## Titulli i lëndës: Gjuhësi e Përgjithshme

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Ballkanistikë
Titulli i lëndës:	Gjuhësi e Përgjithshme
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	
Të dhënat kontaktuese:	xxx
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi Gjuhësi e përgjithshme bën pjesë në mesin e kurseve themelore. Ka karakter formues, teorik. Kursi ofron të dhënat e përgjithshme të teorisë linguistike. Derisa deri tash, fonetika, gramatika, leksiku, variantet gjuhësore ishin trajtuar si pjesë e një gjuhë të caktuar, tani proceset kundrohen në rrafshin teorik, si procese të përgjithshme gjuhësore. Kursi ofron njohuri për drejtimet e përgjithshme gjuhësore, shkollat më të rëndësishme dhe konceptet teorike të gjuhësisë.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Njohja dhe familjarizimi me konceptet themelore në këto studime është një nga synimet kryesore të kursit. Synohet që pas këtij kursi studenti të jetë në gjendje të krijojë një ide më të saktë për vendosjen e dijeve që mund të marrë gjatë studimit të gjuhës shqipe në kuadër të dijes më të përgjithshme mbi gjuhët njerëzore, t'i vendosë ato në kuadër të aparaturës njohëse teorike të përgjithshme dhe t'i</p>

bëjë të krahasueshme me dijet për gjuhët e tjera, sepse të arritura mbi bazë të të njëjtave koncepte.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të :

- identifikojnë qasjet kryesore metodologjike të studimit të gjuhëve, teoritë dhe konceptet.
- I zbatojnë dijet që mund të marrë gjatë studimit të gjuhës në kuadër të dijes më të përgjithshme mbi gjuhët njerëzore;
- aplikojnë qasje të caktuara për probleme të ndryshme
- aplikojnë dijen teorike në studimet e tyre praktike edhe në seminarët që do t'i kryejnë gjatë semestrit.
- 
- krahasojnë me dijet për gjuhët e tjera, me të arriturat mbi bazë të të njëjtave koncepte

#### Ngarkesa e studentit (duhet të jetë nëpërputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	22.5
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	5	2	10
Konsultime me mësimdhënësin	15min	10	2.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	2	13	26
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2.5	15	37.5

Përgatitja për provimin final	2	10	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj.	2	2	4
Total			149 149:25=5.96 6 ECTS

**Metodat e mësimdhënies:** Mësimi do të mbështetet kryesisht në ligjërata, por edhe ushtrimet zënë një vend të rëndësishëm. Meqë seminari si punë e pavarur merr një pjesë të mirë të vlerësimit, edhe puna mentoriale e profesorit dhe asistentit do të jetë një nga metoat e punës.

**Metodat e vlerësimit:** Pjesëmarrje dhe angazhim 10%  
Test semestral 30 %  
Seminar 20%  
Test final 40%

**Literatura primare:** Lyons, J.: Hyrje në gjuhësinë teorike, përkth. E. Lika, Dituria, Tiranë, 2001.

**Literatura shtesë:**

- Barthes, R.: Elemente të semiologjisë, Aventura semiologjike, përkth. R. Ismajli, Rilindja, Prishtinë, 1987; botimi i dytë i plotësuar dhe i rishikuar te Dukagjini, biblioteka "Fryma", Pejë, 2008.
- Ducrot, O.–Todorov Tz.: Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit, përkth. R. Ismajli, Rilindja, Prishtinë, 1984. Hudson, Grover: Essential Introductory linguistics, Blackwell Publishers, Massachussets dhe London, 2000.
- Hudson, R. A.: Sociolingustika, përkthe. M. Ymeri, Dituria, Tiranë, 2003. Ismajli, R.: Shenjë e ide, Rilindja, Prishtinë, 1974.
- Ismajli, R.: **Shenjë e ide**, Rilindja, Prishtinë, 1974.
- Iviq, M.: Drejtimet në linguistikë, përkth. S. Drini, Rilindja, Prishtinë, 1974. Linke, A./ Nussbaumer, M./ Portmann, P.R.: Studinebuch Linguistik, Niemeyer, Tübingen, 1996.
- Martinet, A.: Elemente të gjuhësisë së përgjithshme, përkth. R.

Ismajli, bot. III, Dituria, Tiranë, 2002. Nuhiu, V.: Ndërndikimet gjuhësore, Rilindja, Prishtinë, 1985.

- Sapir, E.: Gjuha, përkth. V. Nuhiu, Rilindja, Prishtinë, 1986.
- Saussure, F. de: Kurs i gjuhësisë së përgjithshme, përkth. R. Ismajli, bot. II, Dituria, 2002.
- Trubeckoi, N.S.: Parime të fonologjisë, përkth. M. Bejta, Rilindja, Prishtinë, 1985.

## Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje ne gjuhësinë teorike – drejtimet, teoritë, metodat. Ç'është gjuhësia? Ç'din kur e din gjuhën?(Gramatika dhe leksikoni). Preskriptivizmi dhe deskriptivizmi. Ushtrimi duke bërë gjeneralizime, hipoteza.
Java 2:	Historia e mendimit mbi gjuhën. Fillimet e gjuhësisë. Greqia dhe Roma e lashtë. India. Mesjeta. Humanizmi dhe Renesanca. Racionalizmi. Shekulli 18. Gjuhësia si shkencë e pavarur – sh. 19. Gjuhësia krahasimtare-historike. Biologjizmi në gjuhësi. Gramatikanët e rinj. Gjeografia gjuhësore.
Java 3:	F. de Saussure dhe strukturalizmi. Shkolla e Pragës dhe fonologjia. Gjuhësia funksionale e A. Martinet-së. Binarizmi i Jakobsonit. Glosematika daneze. Gjuhësia amerikane – Bloomfield dhe bllumfildianistët. Gjuhësia gjenerative-transformacionale. Sociolinguistika. Pragmatika. Gjuhësia tekstore.
Java 4:	Shenja gjuhësore. Tre tipa shenjash: indicie; ikona; simbole. Shenja gjuhësore dhe shenja jogjuhësore. Struktura e shenjës gjuhësore: shenjuesi dhe i shenjuari; shprehja dhe përmbajtja; arbitrariteti dhe motivimi; konvencionaliteti; asociativiteti. Vlera e shenjës gjuhësore.
Java 5:	Aparati i të folurit prodhimi i tingujve. Nyjëtimi i tingujve. Përshkrimi akustik i tingujve. Analiza fonologjike. Literatura: Lyons, 2001; Martinet, 2002; trubeckoi, 1985; Ducrot – Todorov, 1984; dhe literatura plotësuese që do të jepet në klasë

Java 6:	Fjala, fjala sintaksore, leksema. Morfema dhe tipet e morfemave. Alomorfi. Monema. Llojet e monemave. Derivacioni: rrënja, tema, shtesat (para-, prapa-, ndër-shtesat). Kompozicioni.
Java 7:	Analiza e përbërësve të pandërmjetmë. Pjesët e ligjëratës të gramatikës tradicionale. Literatura: Lyons, 2001. Kategoritë gramatikore. Funkcionet gramatikore. Tipet e gjuhëve: sintetike, analitike, aglutinative, izoluese. Literatura: Lyons, 2001.
Java 8:	Funksionet gramatikore. Tema dhe rema. Fjalia. Sintagma. Sintaksa e fjalisë së thjeshtë. Gjymtyrët e fjalisë. Gjymtyrët e fjalisë dhe pjesët e ligjëratës. Literatura: Lyons, 2001; Martinet, 2002; Ducrot – Todorov, 1984.
Java 9:	Semantika. Kuptimi dhe domethënia. Kuptimi denotativ dhe kuptimi konotativ. Kuptimi gramatikor dhe kuptimi leksikor. Analiza semike. Leksikografia. Literatura: Lyons, 2001.
Java 10:	Pragmatika. Gjuhësia tekstore. Nga teksti te fjalia: koherenca/ kohezioni.
Java 11:	Sociolinguistika. Literatura: Martinet, 2002, Hudson, 2002
Java 12:	Kontakte të gjuhës. Bilinguizëm, plurilinguizëm, diglosi. Planifikim gjuhësor. Gjuhë standarde. Literatura: Nuhiu, 1985; Ismajli, 2005 dhe literatura që do të jepet në klasë.
Java 13:	Psikolinguistika: Teoritë kryesore – Nativizmi, bihejviorizmi, kognitivizmi
Java 14:	Të nxënit e gjuhës – teoritë (Chomsky, Aitchison, Gernsbacher, Crystal)
Java 15:	Prodhimi dhe të kuptuarit – teoritë (Levelt, Field etj)

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar të respektojnë normat themelore të sjelljes gjatë kohës së ligjëratave dhe ushtrimeve. Gjatë ushtrimeve studentët janë të obliguar të marrin pjesë aktive në mësim interaktiv. Atyre u mundësohet edhe prezantimi individual dhe grupor dhe qasja interaktive në mësim. Po ashtu

studentët kanë mundësi që të kryejnë seminarët e obligueshme nga kjo lëndë.

## Titulli i lëndës: HISTORI E ARTEVE BALLKANIKE

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës		
Titulli i lëndës:	Histori e arteve ballkanike		
Niveli:	BA		
Statusi i lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	Viti III   Semestri VI		
Numri i orëve në javë:	2+0		
Kreditë ECTS:	5 ECTS		
Koha / Vendi:	Klasa   Sipas orarit		
Mësimdhënësi:			
Të dhënat kontaktuese:			
Përshkrimi i lëndës:	Pas ndarjes së Perandorisë Romake, arti bizantin kishte karakteristika të pavarura të zhvillimit nga Roma, si në artin e pikturës, skulpturës, në arkitekturë, veçanërisht në ndërtimin e objekteve të kultit, e cila u shtresua në trashëgiminë kulturore, shpirtërore dhe estetike të popujt e Ballkanit. Ky ndikim kulturor do të hetohet përmes ndikimit në rrafshin gjuhësor		
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimi kulturor në Ballkan nëpërmjet artit.</li> <li>Historia e ndikimit të artit bizantin në zhvillimet kulturore në trevat e Ballkanit.</li> <li>Ndikimi i traditave kulturore bizantine në rrafshin gjuhësor.</li> </ul>		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të fitoj njohuri për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Trashëgiminë kulturore, shpirtërore dhe estetike të popujve të Ballkanit</li> <li>Ndikimin e artit bizantin në zhvillimet kulturore të popujt e Ballkanit.</li> <li>Ndikimi i zhvillimeve kulturore bizantine në rrafshin gjuhësor</li> </ul>		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Teori / Punë në laborator / Ushtrime			0
Punë praktike			0
Përgatitje për test intermediar	6	1	6
Konsultime me mësimdhënësin	20 min.	9	3
Puna në terren			0
Testi, punimi i seminarit	2	3	6
Detyrë shtëpie	2	10	20
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	15	45

Përgatitja për provimin final	3	4	12
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	4	8
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
<b>Totali</b>			<b>102:25=4,98 5 ECTS</b>

**Metodat e mësimdhënies:** Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrimeve që ofrojnë bazën praktike në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi.  
Studentët kanë punime seminari e punime me shkrim të kryera në mënyrë individuale, bëjnë punë në çifte dhe në grupe, edhe përmes projekteve, dhe bëjnë diskutime.

**Metodat e vlerësimit:** Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%.  
Vijueshmëria e studentit 5%;  
Detyrat individuale të kryera në klasë 5%;  
Detyrat individuale të kryera në shtëpi 10%;  
Vlerësimi nga testet 40%;  
Provimi final 40%.

**Literatura primare:**

1. E. H. Gombrich, (1996). Histori e artit. Tiranë.
2. Hugh Honour & John Fleming, (2009). A World History of Art, London.
3. Donald Preziosi ed., The Art of Art History: A Critical Anthology, Oxford, New York 1998.
4. Henry Maguire, (20012). Nature in Byzantine Art and Literature.
5. Liz James, (2000). Art and Text in Byzantin Culture. Cambridge University Press.

**Literatura shtesë:**

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	
Java 2:	
Java 3:	
Java 4:	
Java 5:	
Java 6:	
Java 7:	
Java 8:	
Java 9:	
Java 10:	
Java 11:	
Java 12:	
Java 13:	
Java 14:	
Java 15:	

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri

mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimdhënësit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.

## Titulli i lëndës: Histori e Ballkanit të Lashtë

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Histori e Ballkanit të Lashtë
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti II   Semestri III
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa   Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Mimoza Hasani-Pllana
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:mimoza.hasani@uni-pr.edu">mimoza.hasani@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë vjen me pretendimin për të vijëzuar një paraqitje integrale të historisë kulturore antike të Ballkanit. Lënda përmbajtësisht mbarështrohet si një analizë e komplekseve diverse etnokulturore në Ballkanin klasik. Duke ofruar si pikënisje prapavijën neolitike të hapësirave danubo-egjeane, prej kulturës së Vinçës e deri te indoevropianizimi i Ballkanit, lënda ofron një pasqyrë të shfaqjes së popujve që predominuan historinë klasike në Ballkan për të cilën rekordet historike nisin nga ekspansioni kolonizues helen në Adriatik dhe Detin e Zi, e deri te kontrolli romak që pasoi rënien e Maqedonisë antigonide. Pjesa e dytë e lëndës pasohet me një vështrim të përmbledhur të popullatave pre-greke, greke, ilire, thrake, maqedone e kelte që ndikuan rrjedhat politike e sociale të Ballkanit klasik. Në këto histori që tejkalojnë formatin e një narrative thjesht politike, mund të përkapen edhe trende të marrëdhënieve simbiotike mes etnive klasike që kanë populluar gadishullin Ballkan përgjatë lashtësisë.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Studentët që do të ndjekin këtë kurs do të krijojnë një tablo të plotë të kompleksitetit historik të Ballkanit në lashtësi. Përmes leximit të burimeve klasike, veçanërisht të literaturës greke dhe romake, studentët duhet të depërtojnë në botën antike të Ballkanit nëpërmjet burimeve autentike tekstuale. Ata duhet të njihen me origjinat dhe lëvizjet e popujve që kanë populluar Ballkanin dhe me ndërfaqet dhe marrëdhëniet ndërkulturore të të gjitha rrafshëve. Më shumë se sa me një histori njëdimensionale politike, përmes ligjëratave të këtij kursi studentët do të hyjnë në historinë antike të Ballkanit siç është konceptuar këtu, si një përfaqësim shumëdimensional nga lëvizjet etnike, kulturat e ilirëve, grekëve, maqedonëve, thrakasve</p>

	dhe këmbimeve mes tyre e popujve të tjerë. Përmes shërbimit me studimet e dhëna në literaturën e këtij syllabusi, kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftoj studentët me gjuhët, besimet religjioneze, mitet, shkrimet, kulturën materiale e arkitektonike, burimet historike dhe studimet historiografike për lashtësinë në Ballkan.
Rezultatet e pritura të të nxënit:	<p>Me përfundimin e kursit studnetët do të janë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegoni dhe diskutoni burimet parësore dhe dytësore që lidhen me historinë e Ballkanit të lashtë</li> <li>• Analizoni historinë e lashtë të Ballkanit në kontekste historike, socio-ekonomike, kulturore dhe fetare</li> <li>• Shpjegoni historinë e Ballkanit të lashtë; ngjarjet dhe temat kryesore të tij</li> <li>• Zhvilloni një qasje analitike për zhvillimin e periudhës</li> </ul>

#### Ngarkesa e studentit (duhet të jetë nëpërputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike			
Përgatitje për test	5	3	15
Konsultime me mësimdhënësin	15 min.	10	1.30
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	1	8	8
Detyrë shtëpie	2	14	28
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	14	28
Përgatitja për provimin final	2	8	16
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	3	3
Total			122 orë 122,5:25=5  5 ECTS

<b>Format e mësimdhënies dhe të mësimnxënies:</b>	Ligjërata; Ushtrime; Punime seminarike; Diskutime në grupe (studentët ndahen në grupe diskutimi për të: analizuar tekstet; zhvilluar pyetje dhe diskutime specifike në lidhje me tekstin; zhvilluar debata me gjuhë argumentuese).
<b>Mjetet e konkretizimit:</b>	TI: tekstet, tabela, mjetet audio-vizuale, audio-linguale, kompjuteri, videoprojektori, tabela smart.
<b>Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:</b>	Pjesëmarrje në ligjërata 10 % Pjesëmarrje aktive në ligjërata 10 % Testi semestral 10 % Seminar 15% Provimi përfundimtar 55 %
<b>Literatura primare:</b>	Georges Castellan, Histori e Ballkanit, Prishtinë, NGBGSH "GUTENBERG". 1997.
<b>Literatura shtesë:</b>	Shaban Demiraj, Gjuhësi ballkanike. Tiranë: Shkenca, 2004. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Ilirët dhe ilira te autorët antikë. Tiranë: Toena, 2002. Herodoti. Historitë. Tiranë: IDK, 2015. Tuqididi. Historia e luftës së Peleponezitet. Tiranë: ISP & Dita 2000, 2007. Zef Mirdita, Studime dardane. Prishtinë: Rilindja, 1979. Engjëll Sedaj, Homeri në letërsinë dhe kulturën shqiptare. Prishtinë: Rilindja, 1984. Pierre Cabannes, Historia e Adriatikut. Tiranë: IDK, 2013. Pierre Cabannes ,Ilirët: nga Bardhyli deri te Genti shek. IV – II p. K. Tiranë: Carpe Diem, 2010. Radislav Katicic,. Ancient languages of the Balkans. Paris: Mouton & Co., 1976. Nicholas Hammond, A History of Greece: To 322 B.C. Oxford: Oxford University Press, 1959. Nicholas Hammond, The Macedonian State: The Origins, Institutions and History. Oxford: Clarendon Press, 1993. Nicholas Hammond, Epirus: The Geography, the Ancient Remains, the History and the Topography of Epirus and Adjacent Areas. Michigan: Clarendon Press, 1967. Eugene Borza, In the Shadow of Olympus: The Emergence of Macedon. Princeton: Princeton University Press, 1992.
<b>Hartimi i planit mësimor</b>	
Java	Titulli i ligjërates
Java 1:	Ç'është Ballkani?
Java 2:	Trashëgëmia historike, shtetet dhe kultura
Java 3:	Pushtimi i Ballkanit
Java 4:	Ballkani nën sundimin osman

Java 5:	Orjenti i pushtimeve të Napoleonit
Java 6:	Kryengritjet serbe dhe greke
Java 7:	Dy krizat e para të çështjes lindore
Java 8:	Test 1
Java 9:	Shtetet e reja të krishtera dhe kriza e tretë lindore
Java 10:	Afirmimi dhe rivalitetet e shteteve të krishtera
Java 11:	Bosnje-Hercegovina nën okupimin e Vjenës
Java 12:	Rilindja shqiptare
Java 13:	Luftërat ballkanike
Java 14:	Test 2
Java 15:	Ballkani në Luftën e Dytë Botërore

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Vijueshmëri e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve që u ofrohen studentëve. Respektimi i rregullave profesionale dhe parimeve etike gjatë studimit.

Mjetet e komunikimit, gjatë orës mësimore nuk duhet të përdorën për qëllime që nuk përkasin me qëllimet e lëndës. Ndërsa mjetet e njëjta mund të përdorën për realizimin e lëndës mësimore, por duke mos e cenuar privatësinë e askujt në sallën e mësimimit.

<b>Pjesa teorike</b>	<b>Pjesa praktike</b>
25%	75 %

ballkanit te lashte

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë nëpërputhje me rezultatete nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Përgatitje për test	5	3	15
Konsultime me mësimdhënësin	15 min.	10	1.30
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	1	8	8
Detyrë shtëpie	2	14	28
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	14	28
Përgatitja për provimin final	2	8	16
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	3	3
Total			122 orë 122,5:25=5 5 ECTS



## Titulli i lëndës: HISTORIA OSMANE E BALLKANIT

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Historia osmane e Ballkanit
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i III-të, Semestri i V-të
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Departamenti i Ballkanistikës   Sipas orarit
Mësimdhënësi:	
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	Lënda “Historia Osmane e Ballkanit” do ta trajtojë në përgjithësi situatën në Ballkan, duke filluar nga depërtimet e para osmane, periudhën e sundimit osman, e deri tek fillimet e revolucioneve të cilat do ta përfshijnë Ballkanin gjatë shek. XIX. Në veçanti do të diskutohet për “Sistemin Osman” të instaluar në Ballkan; ndërrimin e strukturës fetare dhe luftërat e Perandorisë Osmane dhe pasojat e tyre në Ballkan. Lënda do të trajtojë zhvillimet më të rëndësishme, rrjedhojat e të cilave janë të pranishme edhe sot.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është njoftimi i studentëve me rrethanat e përgjithshme në të cilat ndodhej Ballkani në vigjilje dhe gjatë sundimit osman. Përveç popullsisë së Ballkanit nën sundimin osman do të diskutohet edhe për krahinat autonome të Ballkanit: Republikën e Dubrovnikut, Moldavinë dhe Vllahinë, dhe për popullsinë e Ballkanit nën sundimin habsburgas.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët do të fitojnë njohuri për:
	Depërtimet e para osmane dhe periudhën e sundimit osman në Ballkan.
	Rezistencën ndaj fushatave osmane.
	Luftërat e njëpasnjëshme të Perandorisë Osmane, posaqërisht me Austrinë, Rusinë dhe Republikën e Venedikut, marrëveshjet pasuese dhe implikimin i territoreve ballkanike në to.
	Interpretojnë zhvillimet historike gjatë periudhës otomane

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë nëpërputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.25
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike			
Përgatitje për test	5	3	15
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	10	1.30
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	1	8	8
Detyrë shtëpie	2	14	28
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	14	28
Përgatitja për provimin final	2	8	16
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	3	3
<b>Total</b>			<b>123.8 hours</b> <b>123.8:25=5.1</b> <b>5 ECTS</b>

Metodat e mësimdhënies:	<p>Orët e ligjëratave do të konsistojnë në ligjëratat interaktive, ku do të trajtohen temat e planifikuara sipas sillabusit. Ligjëratat do të shoqërohen edhe me teknologji vizuale dhe me materiale dhe dokumente shtesë që korrespondojnë me temën e sqaruar. Studentët do të angazhohen individualisht apo në grupe të vogla në shkrimin e punimeve/projekteve hulumtuese, rezultatet kryesore të të cilave do t'i prezantojnë në klasë gjatë orëve të fundit. Ata po ashtu do të angazhohen me detyra të shtëpisë, respektivisht ese nga temat që do të trajtohen</p> <p><b>Mjetet e konkretizimit / TI:</b> tekstet, tabela, mjetet audio-vizuale, audio-linguale, kompjuteri, videoprojektori, tabela smart</p>										
Metodat e vlerësimit:	<table border="0"> <tr> <td>Vijueshmëria%</td> <td>5%</td> </tr> <tr> <td>Punimi / projekti hulumtues %</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Pjesëmarrja aktive %</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Testi semestral %</td> <td>35%</td> </tr> <tr> <td>Provimi final %</td> <td>40%</td> </tr> </table>	Vijueshmëria%	5%	Punimi / projekti hulumtues %	10%	Pjesëmarrja aktive %	10%	Testi semestral %	35%	Provimi final %	40%
Vijueshmëria%	5%										
Punimi / projekti hulumtues %	10%										
Pjesëmarrja aktive %	10%										
Testi semestral %	35%										
Provimi final %	40%										
Literatura primare:	<p>Stavrianos, L.S. <i>The Balkans since 1453</i>. London:Hurst &amp; Company, 2000.</p> <p>Hupchick, Dennis P. <i>The Balkans: From Constantinople to Communism</i>. New York: Palgrave Macmillan, 2004.</p> <p>Kinross, Lord. <i>The Ottoman Centuries: The Rise and Fall of the Turkish Empire</i>. New York: Morrow Quill Paperbacks, 1977.</p> <p>Mazower, Mark. <i>The Balkans: A Short History</i>. New York: The Modern Library, 2002.</p> <p>Jelavich, Barbara. <i>Historia e Ballkanit: Shekulli i tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë</i>. Tiranë: botime përpjekja, 1999.</p> <p>Kaser, Karl. <i>Patriarchy after Patriarchy: Gender Relations in Turkey and in Balkans 1500-2000</i>. LIT, 2008.</p> <p>Kaser, Karl. <i>The Balkans and The Near East: Introduction to a Shared History</i>. LIT, 2011.</p> <p>Wachtel, Andrew Baruch. <i>The Balkans in World History</i>, New York, Inc: Oxford University Press, 2008.</p>										
Literatura shtesë:	<p>Berenger, Jean. <i>A History of Habsburg Empire, 1700-1918</i>. London and New York: Longman, 1997.</p> <p>Rich, Norman. <i>Diplomacia e Fuqive të Mëdha, 1814-1914</i>. Tiranë: Instituti i Dialogut &amp; Komunikimit, Botimet Toena, 2006.</p> <p>Woodruff, William. <i>A concise history of the Modern World: 1500 to the present, A guide to World Affairs</i>. London: Abacus, 2005.</p>										

**Hartimi i planit mësimor**

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Njoftimi me përmbajtjen dhe qëllimet e lëndës.
Java 2:	Depërtimet e para Osmane në Ballkan: Rënia e Galipolit (1354), Beteja e Maritsës dhe Beteja e Kosovës; Rrethanat e përgjithshme në Evropë dhe Ballkan në periudhën e zhvillimit Osman.
Java 3:	Ballkani nën sundimin osman; Instalimi i “Sistemit Osman”: administrimi, militarizimi; rezistenca ndaj sundimit Osman në Ballkan.
Java 4:	Shoqëria; Rolet familjare dhe gjinore në Ballkan gjatë periudhës Osmane.
Java 5:	Rrethanat fetare: Ndryshimi i strukturës fetare të popullsisë; Organizimi fetar dhe popullsia myslimane.
Java 6:	Statusi i popullsisë jomuslimane; Ndikimi i Kishës Ortodokse në jetën dhe identitetin e popullatës së krishterë.
Java 7:	Ballkani gjatë periudhës së destabilizimit osman: Rrethanat socio-ekonomike; Rrethanat politiko-diplomatike.
Java 8:	Testi semestral.
Java 9:	Luftërat e Perandorisë Osmane me Republikën e Venecias dhe pasojat e tyre.
Java 10:	Luftërat e Perandorisë Osmane me Austrinë dhe pasojat e tyre.
Java 11:	Luftërat e Perandorisë Osmane me Rusinë dhe pasojat e tyre.
Java 12:	Provincat autonome në Ballkan: Republika e Dubrovnikut, Moldavisë dhe Vllahisë.
Java 13:	Popullsia e Ballkanit nën sundimin e Habsburgëve.
Java 14:	Ballkani në prag të epokës së nacionalizmit.
Java 15:	Prezantimi i punimeve/projekteve hulumtuese.

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Mësimi fillon dhe përfundon sipas orarit.

Telefonat duhet të fiken.

Gjatë ligjëratave, diskutimeve apo debateve, nuk lejohet përdorimi i gjuhës që nxit urrejtje në baza racore, gjinore, etnike etj.

Ndalohet dhe dënohet kopjimi gjatë testeve semestrare/provimeve apo plagjiati gjatë shkrimit të eseve akademike/seminareve.

Konsultimet me profesorin e lëndës mbahen sipas orarit të caktuar për konsultime.

**Titulli i lëndës: HISTORIA E RE E BALLKANIT (SHEK. XIX-XX)**

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Historia e re e Ballkanit (shek. XIX-XX)
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti III   Semestri VI
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Salla
Mësimdhënësi:	
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Nacionalizmi që e kishte përfshirë Evropën pas Revolucionit Francez, ishte manifestuar në Ballkan me revolucionet e popujve të Ballkanit, të cilat së bashku me rezultatet e tyre, do të trajtohen në këtë lëndë. Më tej, do të diskutohet për krizat në Ballkan që do t'i paraprijnë Luftës së Parë Botërore, si Kriza e Aneksimit të Bosnje-Hercegovinës, Luftërat Ballkanike dhe Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe vrasja së Arqidukës Franc Ferdinand. Lufta e Parë Botërore përfundoi me shembjen e tri Perandorive: Osmane, Austro-Hungareze dhe Ruse, dhe Konferenca e Paqes së Parisit së bashku me traktatet me Fuqitë të cilat e humbën luftën, do të bëjnë ndryshime të mëdha territoriale në Evropë, ndryshime këto që do ta përfshijnë edhe Ballkanin, dhe të cilat do të trajtohen veçanërisht në këtë lëndë. Më tej do të diskutohet për situatën në Ballkan në mes të dy luftërave, gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe gjatë dominimit komunist, rrënja e të cilit sistem do të sjell ndryshime të tjera radikale në Ballkan, dhe do të pasohet nga shpërbërja e Jugosllavisë.</p>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"><li>• Qëllimi i lëndës është njoftimi i studentëve me ndryshimet dhe kthesat më të mëdha në Evropë në përgjithësi e në Ballkan në veçanti, që nga fillimet e Nacionalizmit e deri në përfundim të shekullit XX, ndryshime këto të cilat janë fillet e problemeve me të cilat edhe sot ballafaqohen popujt e Ballkanit.</li></ul>

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të kenë mundësinë:

- Nacionalizmin në Ballkan dhe manifestimin e tij me revolucione.
- Rivalitetin dhe gërshetimin e interesave të Fuqive të Mëdha në Ballkan.
- Situatën e përgjithme në Ballkan në prag të Luftës së Parë Botërore.
- Diplomacinë e shteteve ballkanike gjatë dy luftërave botërore si dhe luftën e tyre përkrah Fuqive të Mëdha.
- Zhvillimet në shtetet ballkanike gjatë dominimit komunist; rrënjën e komunizmit dhe shpërbërjen e Jugosllavisë.

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			0
Punë praktike			0
Përgatitje për test intermediar	2	2	4
Konsultime me mësimdhënësin	20 min.	4	1,5
Puna në terren			0
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	2	3	6
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	4	6	24
Përgatitja për provimin final	4	10	40
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	4	5	20
<b>Totali</b>			<b>102:25=5,04</b>

		5 ECTS
Metodologjia e mësimdhënies:	Orët e ligjëratave do të konsistojnë në ligjërata interaktive, ku do të trajtohen temat e planifikuara sipas sillabusit. Ligjëratat do të shoqërohen edhe me teknologji vizuale dhe me materiale dhe dokumente shtesë që korrespondojnë me temën e sqaruar. Studentët do të angazhohen individualisht apo në grupe të vogla në shkrimin e punimeve/projekteve hulumtuese, rezultatet kryesore të të cilave do t'i prezantojnë në klasë gjatë orëve të fundit. Ata po ashtu do të angazhohen me detyra të shtëpisë, respektivisht ese nga temat që do të trajtohen.	
Metodat e vlerësimit:	Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë; Vijimi i rregullt 5%  Angazhimi dhe pjesëmarrja active 10%  Vlerësimi i pare dhe i dyte 35%  Punimi seminarik 10%  Testi përfundimtar 40%	
Literatura bazë:	Stavrianos, L.S. <i>The Balkans since 1453</i> . London:Hurst & Company, 2000. Hupchick, Dennis P. <i>The Balkans: From Constantinople to Communism</i> . New York: Palgrave Macmillan, 2004. Kinross, Lord. <i>The Ottoman Centuries: The Rise and Fall of the Turkish Empire</i> . New York: Morrow Quill Paperbacks, 1977. Mazower, Mark. <i>The Balkans: A Short History</i> . New York: The Modern Library, 2002. Jelavich, Barbara. <i>Historia e Ballkanit: Shekulli i tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë</i> . Tiranë: botime përpjekja, 1999. Jelavich, Barbara. <i>History of the Balkans: Twentieth Century, Volume 2</i> , Cambridge:Cambridge University Press, 1983. Kaser, Karl. <i>Patriarchy after Patriarchy: Gender Relations in Turkey and in Balkans 1500-2000</i> . LIT, 2008. Kaser, Karl. <i>The Balkans and The Near East: Introduction to a Shared History</i> . LIT, 2011. Wachtel, Andrew Baruch. <i>The Balkans in World History</i> , New York, Inc: Oxford University Press, 2008.	
Literatura shtesë:	Berenger, Jean. <i>A History of Habsburg Empire, 1700-1918</i> . London and New York: Longman, 1997. Rich, Norman. <i>Diplomacia e Fuqive të Mëdha, 1814-1914</i> . Tiranë: Instituti i Dialogut & Komunikimit, Botimet Toena, 2006. Woodruff, William. <i>A concise history of the Modern World: 1500 to the present, A guide to World Affairs</i> . London: Abacus, 2005. Burime nga interneti	

<b>Hartimi i planit mësimor</b>	
<b>Java</b>	<b>Titulli i ligjëratës</b>
Java 1:	Informim për përmbajtjen dhe objektivin e lëndës.
Java 2:	Fillimet e Nacionalizmit në Ballkan.
Java 3:	Revolucionet e popujve të Ballkanit dhe pavarësimi i tyre.
Java 4:	Traktati i Shën Stefanit dhe Kongresi i Berlinit: Konsekuencat e tyre.
Java 5:	Shoqëria; Familja dhe rolet gjinore në Ballkan gjatë shekujve XIX dhe XX.
Java 6:	Ballkani gjatë periudhës 1878-1914: Çështja maqedone; Aneksimi i Bosnje-Hercegovinës; Luftërat Ballkanike; Konferenca e Ambasadorëve në Londër; Vrasja e Arqidukës Franc Ferdinand.
Java 7:	Testi semestral
Java 8:	Lufta e Parë Botërore: diplomacia dhe lufta e shteteve ballkanike.
Java 9:	Konferenca e Paqes së Parisit: Traktatet e paqes dhe ndryshimet territoriale të Ballkanit
Java 10:	Periudha në mes të dy Luftërave Botërore dhe Ballkani.
Java 11:	Lufta e Dytë Botërore: diplomacia dhe lufta e shteteve ballkanike.
Java 12:	Dominimi komunist në Ballkan, 1945-1991
Java 13:	Rrënja e komunizmit në Ballkan.
Java 14:	Shpërbërja e Jugosllavisë.
Java 15:	Prezantimi i punimeve/projekteve hulumtuese.

#### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Mësimi fillon dhe përfundon sipas orarit.

Telefonat duhet të fiken.

Gjatë ligjëratave, diskutimeve apo debateve, nuk lejohet përdorimi i gjuhës që nxit urrejtje në baza racore, gjinore, etnike etj.

Ndalohet dhe dënohet kopjimi gjatë testeve semestrale/provimeve apo plagjiati gjatë shkrimit të eseve akademike/seminareve.

Konsultimet me profesorin e lëndës mbahen sipas orarit të caktuar për konsultime.

## Titulli i lëndës: HYRJE NE STUDIMET BALLKANIKE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Hyrje në studimet ballkanike
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri II
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Departamenti i Ballkanistikës Sipas orarit
Mësimdhënësi:	
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Ballkani është një truall gjeografik, në të cilin popuj të ndryshëm kanë gjëlluar në kontakt të afërt për shekuj të tërë. Ky kontakt i vazhdueshëm ka krijuar konvergjenca të dukshme gjuhësore. Si rezultat i kësaj janë krijuar një sërë elementesh gjuhësore të përbashkëta për këto gjuhë dhe këto ngjashmëri kanë krijuar mes studiuesve idenë për Lidhjen gjuhësore ballkanike, apo siç njihet Sprachbundi Ballkanik. Në kuadër të Sprachbundit hyjnë gjuhë të tilla si shqipja, dialekte të serbishtes, bullgarishtja, maqedonishtja, greqishtja, romishtja, rumanishtja (të gjitha gjuhë indoevropiane, ë pesë degëve të ndryshme) dhe, në një shkallë tjetër, turqishtja ballkanike. Ky kurs ofron një pamje të elementeve të përbashkëta gjuhësore ballkanike, diskuton historinë e kontaktit dhe të bashkëjetesës dhe ndërndikimet gjuhësore në periudha të ndryshme.</p> <p>Kursi ofron një bazë nisëse teorike për të kuptuar bashkëjetesën ndëretnike në Ballkan, por edhe një hyrje të gjuhësisë, duke diskutuar disa nga tiparet kryesore konvergjuese ndër-gjuhësore.</p>
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka për qëllim të ofrojë bazën teorike të Sprachbundit Ballkanik, duke ofruar një panoramë të gjuhëve që e përbëjnë Sprachbundin, duke i dalluar elementet e përbashkëta, duke e analizuar kontaktin që

e i ka krijuar ato elemente të përbashkëta dhe duke ofruar një sfond të përgjithshëm kulturor. Studentët pritet të kenë njohuri mbi karakteristikat dalluese të Sprachbundit Ballkanik, të gjuhëve që e përbëjnë dhe të sfondit kulturor ku janë krijuar ato karakteristika. Po ashtu, pritet të krijohet vetëdijësimi mbi bashkëjetesën shumëshekullore që ka krijuar këto elemente të përbashkëta dhe të vëmendësohen për t'i dalluar dhe mposhtrur paragjykimet dhe stereotipat e krijuar nga kontekste të ndryshme ndërkohë.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:

- të krijojë një pasqyrë të historikut të kontakteve gjuhësore në Ballkan;
- të njohë gjuhët që përbëjnë Sprachbundin Ballkanik, sfondin e përgjithshëm të tyre dhe kontaktet mes tyre në histori dhe tash.
- të njohë bashkëpërkimet kryesore të fushës së fonetikës, të leksikut dhe të gramatikës;
- të njohë elementet kryesore të tipologjisë gjuhësore;
- të krijojë një ide themelore mbi studimet e deritashme në fushën e gjuhësisë ballkanike dhe të dijë autorët kryesorë që kanë kontribuar aty, në mënyrë që të mund të orientohet në literaturë më të thelluar në të ardhmen, në rast nevojë a dështire;
- të dallojë veçoritë e përbashkëta paralinguistike (gjestet, mimikën) dhe të tjera kulturore (mitet, zakonet) të popujve të ndryshëm që jetojnë në kontakte të afërta mes vete në Ballkan – por edhe që kanë jetuar në kontakte të afërta.
- të dallojë stereotipat dhe paragjykimet ndaj popujve

në Ballkan dhe ndaj Ballkanit përgjithësisht dhe të vëmendësohet për elementet e përbashkëta dhe bashkëjetesën shekullore të popujve ballkanikë.

### Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjërata	2 (45 min)	15	22.5
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	15	3.45
Testi, punimi i seminarit	10	2	20
Detyrë shtëpie	2	15	20
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	45
Përgatitja për provimin final	10	2	30
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
<b>Totali</b>			145.95 orë 145.95:25=5.83 6 ECTS

**Metodat e mësimdhënies:** Ligjëratat, prezantimet e përgatitura nga studentët.  
**Mjetet e konkretizimit / TI:** tekstet, tabela, mjetet audio-vizuale, audio-linguale, kompjuteri, videoprojektori, tabela smart

**Metodat e vlerësimit:** Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%.  
Vijueshmëria e studentit 10%;  
Detyrat individuale të kryera në klasë 0%;  
Detyrat individuale të kryera në shtëpi 10%;  
Vlerësimi nga testet 30%;  
Provimi final 50%.  
**Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:**

Pjesa teorike	Pjesa praktike
70%	30 %

**Literatura primare:**

1. Demiraj, Shaban. 2004. Gjuhësi ballkanike. Tiranë: ASHSH
2. Friedman, Victor. 2003. Studies on Albanian and Other Balkan Languages. Pejë: Dukagjini
3. Banfi, Emanuele. 1985. Linguistica Balkanica. Bologna

**ËLiteratura shtesë:**

Bokshi, Besim. 1984. Prapavendosja e nyjes në gjuhët ballkanike. Prishtinë: Rilindja

Ismajli, Rexhep. 2014. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Prishtinë: ASHAK

Beci, Bahri. 2002. Probleme të lidhjeve të shqipes. Pejë: Dukagjini

Asenova, Petja. 1989. Balkansko ezikoznanie. Osnovni problemi na Balkanskija ezikov sojuz. Sofija

Sandfeld, Kristian. 1930. Linguistique Balkanique, problemes et resultates.

Paris  
Todorova, Maria N. 2013. Ballkani imagjinar – Ballkani si alter ego e Europës. Tiranë: IDK

## Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Përkufizimi i problemit: Unioni gjuhësor ballkanik
Java 2:	Gjendja gjuhësore e Gadishullit Ballkanik në lashtësi
Java 3:	Gjendja e sotme gjuhësore në Ballkan: sfondi
Java 4:	Gjendja e sotme gjuhësore në Ballkan: sfondi
Java 5:	Kontakti gjuhësor – diskutime teorike
Java 6:	Elemente të përbashkëta ballkanike në fushën e fonetikës
Java 7:	Sinkretizmi i gjinorës dhe i dhanorës
Java 8:	Prapavendosja e nyjes në gjuhët ballkanike
Java 9:	Format e së ardhmes në gjuhët ballkanike
Java 10:	Rimarrja e kundrinës
Java 11:	Zhdukja e paskajores
Java 12:	Bashkëpërkime të tjera ballkanike në gramatikë
Java 13:	Leksiku i përbashkët – drejtimet e huazimeve
Java 14:	Veçori paralinguistike ballkanike
Java 15:	E kujt është kjo këngë? Veçori të përbashkëta kulturore mes popujve të Ballkanit

## Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Lënda është teorike kryesisht, por pritet një pjesëmarrje e caktuar e studentëve gjatë ligjëratave. Nuk ka politika të posaçme as pritshmëri, përveç atyre të parapara me kodin e etikës të Universitetit.

## Titulli i lëndës: IDIOMATIKË KONTRASTIVE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Idiomatikë kontrastive
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti IV   Semestri VIII
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Salla 46
Mësimdhënësi:	
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Gjuhët e Ballkanit ndajnë idioma të shumta, kolokacione dhe shprehje të huazuara, si "ha" që nënkupton diçka e pakëndshme.</p> <p>Kjo lëndë mëton të paraqesë idiomat dhe proverbat e përgjithshme në kontekst të bisedave të zakonshme dhe në shkathtësitë e të lexuarit dhe të shkruarit. Idiomat, frazat, dhe proverbat janë shprehje të bukura dhe sugjестive që nuk mund të kuptohen duke i definuar fjalët veçmas apo të izoluara nga konteksti.</p> <p>Njohja e idiomave do t'u mundësojë studentëve përmirësimin e leksikut dhe rrjedhshmërisë në të folur po ashtu do t'u lehtësojë dhe zhvillojë aftësitë në përkthim dhe interpretim.</p>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"><li>• Ky modul synon t'i njohë studentët me konceptet themelore dhe çështjet teorike e praktike të shprehjeve idiomatike;</li><li>• Të rrisë ndërgjegjësimin e studentëve lidhur me natyrën dinamike të gjuhës</li><li>• T'iu mundësojë ta shohin konceptin e fjalës dhe vendin e idiomave në sistemin gjuhësor.</li></ul>

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të kenë mundësinë:

- Kuptojnë idiomat
- Zbatojnë përdorimin e idiomave në gjuhë
- Krijojnë tekste të sakta dhe koherente sa përket stilit dhe gramatikës
- Zgjerojnë fjalorin
- Krahasojnë idiomat e gjuhëve ballkanike

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			0
Përgatitje për test intermediar	2	7	14
Konsultime me mësimdhënësin	15 min.	4	1
Puna në terren			0
Testi, punimi i seminarit	2	3	6
Detyrë shtëpie	2	5	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	6	12
Përgatitja për provimin final	2	5	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
<b>Totali</b>			<b>56:25=3,1 3 ECTS</b>

Metodologjia e mësimdhënies:

Ligjerata, ushtrime, punë me shkrim, debate etj.

**Mjetet e konkretizimit** / TI: tekstet, tabela, mjetet audio-vizuale, audio-linguale, kompjuteri, videoprojektori, tabela smart

<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Vijueshmëria-10%  Pjesëmarrja ne diskutime-10%  Prezantimi- 10 %  Testi I -10 %  Testi II – 10%  Provimi përfundimtar – 50 %</p> <p><b>Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:</b></p> <table border="1" data-bbox="625 558 1393 659"> <thead> <tr> <th data-bbox="625 558 998 596">Pjesa teorike</th> <th data-bbox="998 558 1393 596">Pjesa praktike</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="625 596 998 659">70%</td> <td data-bbox="998 596 1393 659">30 %</td> </tr> </tbody> </table>	Pjesa teorike	Pjesa praktike	70%	30 %
Pjesa teorike	Pjesa praktike				
70%	30 %				
<p>Literatura bazë:</p>	<p>M. McGinnis, “On the systematic aspect of idioms“. Linguistic Inquiry, (2003).  A. Sivački, “Frazeologizmi s konstituentom somatskog porekla u albanskom jeziku i njihovi prevodni ekvivalenti u srpskom” (doktorska disertacija), Beograd, 2017;  D. Mršević-Radović, “Frazeologija i nacionalna kultura”, Društvo za srpski jezik i književnost, Beograd, 2008;  G. Lakoff, M. Johnson, “Metaphors We Live By”, The University of Chicago Press, Chicago-London, 2003 (1980)</p>				
<p>Literatura shtesë:</p>	<p>Johnnathan Wright, , Idioms Organiser: Organised by Metaphor Topic and Key Word. LTP Organiser Series, 1999.  S. Glucksberg, Understanding Figurative Language: From Metaphor to Idioms. Oxford: Oxford University Press, 2001.  J. Mateu, “Paths and Telicity in Idiomatic Constructions: A Lexical Syntactic Approach to the Way Construction”. 2000.  Keith Brown Sarah Ogilve, Concise Encyclopedia of Languages of the World, Elsevier ltd. 2009.  J. Thomai, Xh. Lloshi: <i>Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit</i>, Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë/Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë: Studime Filologjike 1B.  Kovačević: <i>Hrvatski frazem i od glave do pete</i>, Institut za hrvatski jezik i jezikoslovlje, Zagreb  D. Mršević-Radović, “Frazeološke glagolsko-imeničke sintagme u savremenom srpskohrvatskom jeziku, Knjiga LX, Filološki fakultet, Beograd, 1987;  V. Ivir: <i>Kontrastivna analiza u prevođenju i prevođenje u kontrastivnoj analizi</i>, Kontrastivna jezička istraživanja, zbornik radova, Filozofski fakultet, Novi Sad,</p>				

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Përshkrimi i lëndës/literaturës; Prezantimi i temës, detyrimet dhe vlerësimi i studentëve; Informacion mbi objektivat, rezultatet e pritura nga studentët, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi; Pyetjet dhe rekomandimet e studentëve; Hyrje në nocionet bazë në idiomatikë (frazologji).
Java 2:	Një pasqyrë e shkurtër e frazeologjisë si disiplinë shkencore dhe zhvillimi i saj në kuadrin e gjuhësisë shqipe dhe BSKM; Çfarë është idiomatika dhe si përdoret në përkthim dhe interpretim, në mësimdhënien e gjuhës dhe në gjuhësi në përgjithësi.
Java 3:	Terminologjia bazë; Përcaktimi i frazeologjisë dhe idiomave (me theks të veçantë në gj. shqipe dhe BSKM)
Java 4:	Gjuhësia kontrastive dhe njohëse: si kontribuojnë në idiomatikë dhe frazeologji
Java 5:	Analiza kontrastive semantike dhe formale-strukturore; Kategoritë ekuivalente (përputhja totale, e pjesshme dhe zero formale-strukturore dhe ekuivalentët e përkthimit joidiomatikë); Shoqe false në shqip dhe BSKM.
Java 6:	Analiza konceptuale; Konceptime metaforike dhe metonimike; Metafora dhe metonimia konceptuale; Idioma të bazuara në përvojë dhe gjeste.
Java 7:	Fushat semantike; Fushat konceptuale; Fushat semantike: pozitive, negative dhe neutrale.
Java 8:	Testi I
Java 9:	Roli i simbolizmit në frazeologji; Frazologjia dhe etimologjia; Frazologjia dhe disiplina të tjera gjuhësore.

Java 10:	Sinonimia, antonimia dhe homonimia në idiomatikë dhe frazeologji
Java 11:	Gjetja e ekuivalentëve më të përshtatshëm të përkthimit (shqip/BCSM): analizë dhe punë praktike
Java 12:	Aktivitetet e klasës: analiza kontrastive semantike dhe formale-strukturore dhe kategori ekuivalente
Java 13:	Aktivitetet në klasë: analiza konceptuale (përcaktimi i konceptualizimeve dhe origjinës së idiomave)
Java 14:	Lloje të tjera shprehjesh të ngurtësuara (fjalë të urta, thënie, kolokacione, etj.)
Java 15:	Testi II

#### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Celularët / telefonat e mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPods) duhet të jenë të fikur (ose në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë ligjëratave përveç nëse nuk kërkohet për aktivitetin e caktuar në klasë.

Studentët duhet të sjellin me vete gjithmonë materiale për mbajtjen e shënimeve dhe të jenë të përgatitur për ligjëratat dhe për çdo aktivitet; Ardhja me kohë është thelbësore, si dhe studentët duhen të jenë aktiv gjatë ligjëratave përndryshe vetëm prania fizike do të vlerësohet si mungesë. Nga studentët pritet që të jenë të përgatitur dhe të gatshëm në çdo kohë që të kontribuojnë në aktivitetet në klasë.

## Titulli i lëndës: KOMUNIKIMI PUBLIK

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Komunikimi me publikun
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i II-të, Semestri i III-të
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Departamenti i Ballkanistikës Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Mimoza Hasani - Pllana
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:mimoza.hasani@uni-pr.edu">mimoza.hasani@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi Komunikimi me publikun synon të përmirësojë të kuptuarit e studentëve për teorinë dhe strategjitë e komunikimit në mjedise të ndryshme publike. Gjatë këtij kursi trajtohen tema si: fjalimi publik, mesazhi, bindja, marrëdhëniet me median dhe strategjitë efektive të komunikimit për audiencën të ndryshme. Qëllimi është të zhvillohen aftësitë e komunikimit të studentëve për kontekste profesionale dhe publike.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i lëndës Komunikimi me publikun është njohja e studentëve me teorinë themelore, konceptet bashkëkohore, teknikat dhe format e ndryshme të komunikimit me publikun; zhvillimit të mendimit kritik dhe dëgjimit aktiv. Po ashtu, lënda ka për qëllim edhe njohjen e studentëve me praktikat e mira të menaxhimit të krizave përmes komunikimit me publikun dhe hartimit të strategjive dhe planeve të komunikimit.</p>

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi :

- studentët do të njohin bazat teorike të marrëdhënieve me publikun, rëndësinë dhe fuqinë e të folurit në publik;
- studentët do të njohin metodat për krijimin e mesazheve bindëse;
- studentët do të fuqizojnë kompetencën e krijimit të fjalimeve të sakta dhe bindëse;
- studentët të njohin metodat e bindjes dhe të mendimit reflektues-kritik;
- studentët do të njohin praktika të mira për menaxhimin e krizave përmes komunikimit me publikun;
- studentët do të krijojnë aftësi të reja të komunikimit në organizatën ku punojnë dhe në shoqëri;
- studentët do të njohin elementet kyçe për krijimin e strategjive të komunikimit.

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Punë praktike	2	10	20
Përgatitje për test intermediar	5	2	10
Konsultime me mësimdhënësin	10 min.	12	2
Testi, punimi i seminarit	2	4	8
Seminare	1	10	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	8	24
Përgatitja për provimin final	5	3	15
Projektet, prezantimet, etj.	4	3	12
<b>Total</b>			<b>101 hours</b> <b>5 ECTS</b>

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata; Ushtrime; Punime seminarike; Prezantime; Vizita studimore në teren.
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrje në ligjërata 10 % Pjesëmarrje aktive në ligjërata 10 % Testi semestral 10 % Seminar 15% Provimi përfundimtar 55 %
Literatura primare:	Lattimore Dan et al., Marrëdhëniet me Publikun: Profesioni dhe Praktika, Botimi IV, McGraw-Hill Higher Education, Londër, 2012 Jay Blumler and Michael Gurevitch, The Crisis of Public Communication, Taylor & Francis Group, 1995. McNair, Brain, Hyrje në Komunikimin Politik, UET Press, Tiranë, 2009. Stephen E. Lucas, Arti i të folurit në Publik, UET Press, Tiranë, 2010. Marrëdhëniet publike, Joe Mrconi, UET Press, 2010.
Literatura shtesë:	Vilma Luoma-aho, and María José, The Handbook of Public Sector Communication, John Wiley & Sons, 2020. McLuhan, Marshall, Instrumentet e Komunikimit. Media si një zgjatim i njeriut, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, 2004.

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Natyra dhe historia e marrëdhënieve me publikun
Java 2:	Baza teorike e marrëdhënieve me publikun
Java 3:	Roli i folësit në publik Mesazhi Krijimi i imazhit
Java 4:	Hartimi dhe organizimi i fjalimit Pikat kryesore Materialet burimore dhe materialet mbështetëse

Java 5:	Marrëdhëniet me publikun, etika dhe kultura
Java 6:	Test
Java 7:	Të folurit në publik Format e të folurit në publik Saktësia
Java 8:	Metodat e mbajtjes së fjalimeve
Java 9:	Metodat e bindjes
Java 10:	Metodat e mendimit reflektues
Java 11:	Menaxhimi i kirzave përmes marrëdhënieve me publikun
Java 12:	Marrëdhëniet publike dhe media
Java 13:	Marrëdhëniet publike dhe funksioni i marketingut
Java 14:	Komunikimi dhe të dëgjuarit
Java 15:	Krijimi i strategjive të komunikimit

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Vijueshmëri e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve që u ofrohen studentëve. Respektimi i rregullave profesionale dhe parimeve etike gjatë studimit.  
Mjetet e komunikimit, gjatë orës mësimore nuk duhet të përdorën për qëllime që nuk përkasin me qëllimet e lëndës. Ndërsa mjetet e njëjta mund të përdorën për realizimin e lëndës mësimore, por duke mos e cenuar privatësinë e askujt në sallën e mësimimit.

### Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
55%	45 %

## Titulli i lëndës: KONTAKTET E GJUHËVE

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë		
Titulli i lëndës:	Kontaktet e gjuhëve		
Niveli:	BA		
Statusi i lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	Viti III   Semestri V		
Numri i orëve në javë:	2+0		
Kreditë ECTS:	5 ECTS		
Koha / Vendi:	Klasa   Sipas orarit		
Mësimdhënësi:			
Të dhënat kontaktuese:			
Përshkrimi i lëndës:	Lënda mësimore përqendrohet në studimin e dukurisë së kontakteve të gjuhëve dhe ndërndikimeve gjuhësore si karakteristikë e këtyre kontakteve. Në këtë lëndë paraqiten njohuri të përgjithshme për studimet në fushën e kontakteve të gjuhëve, të ndërndikimeve dhe të huazimeve gjuhësore. Po ashtu, ofrohen informata themelore teorike e konceptore lidhur me kontaktet e gjuhëve si dukuri sociolinguistike.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që studentët të njihen me gjerësisht për dukurinë e kontakteve gjuhësore. Objektivi i kësaj lënde është që t'u ndihmojë studentëve të kuptojnë natyrën e kontakteve gjuhësore dhe dukuritë që i karakterizojnë këto kontakte. Në kuadër të kursit studentët do të marrin informacione të përgjithshme lidhur me dukuritë që shfaqen si rezultat i kontakteve të gjuhëve dhe për natyrën e tyre. Në mënyrë specifike, ata do të njihen me format e huazimeve gjuhësore, me ndarjet dhe nëndarjet e tyre.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon mbi natyrën e kontakteve të gjuhëve;</li> <li>• Analizon dukuritë e kontakteve gjuhësore;</li> <li>• Gjeneron lidhur me dukuritë e të huazuarit gjuhësor dhe llojet e huazimeve;</li> <li>• Vlerëson ndikimin e përgjithshëm të huazimeve në shoqëri dhe në gjuhë;</li> <li>• Krahason dukuri gjuhësore mes gjuhësh në kontakt.</li> </ul>		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,25
Teori / Punë në laborator / Ushtrime			
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	5	3	15

Konsultime me mësimdhënësin	15m	10	1,30
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	1	8	8
Detyrë shtëpie	2	14	28
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	2	8	16
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj.	3	1	3
<b>Totali</b>			<b>125 orë 5 ECTS</b>

**Metodat e mësimdhënies:** Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe me anë të detyrave të vazhdueshme në shtëpi. Studentët kanë punime seminari e punime me shkrim të kryera në mënyrë individuale, bëjnë punë në çifte dhe në grupe, edhe përmes projekteve, si dhe lidhur me to diskutojnë në klasë.

**Metodat e vlerësimit:** Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%.  
Vijueshmëria e studentit 5%;  
Detyrat individuale të kryera në klasë 5%;  
Detyrat individuale të kryera në shtëpi 10%;  
Vlerësimi nga testet 40%;  
Provimi final 40%.

**Literatura primare:**

1. Vesel Nuhiu, Ndikimet ndërgjuhësore, Rilindja, Prishtinë, 1990.
2. Sara G. Thomason, Language Contact, Georgetown University Press, Washington D.C., 2001.

**Literatura shitesë:**

- Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit (përmbledhje punimesh të konferencës), ASHAK, Prishtinë, 2012.
- Rexhep Ismajli, Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik, ASHAK, Prishtinë, 2015.
- Gjithashtu, studentët do të orientohen në çdo orë që vetë ta hulumtojnë literaturën tjetër në biblioteka dhe nëpërmjet internetit, në mënyrë që të aftësohen për kërkime të pavarura.

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje në studimet e gjuhëve në kontakt
Java 2:	Të huazuarit intim dhe të huazuarit kulturor
Java 3:	Si ndikojnë gjuhët mbi njëra-tjetrën
Java 4:	Interferenca leksikore
Java 5:	Analiza e të huazuarit gjuhësor
Java 6:	Dygjuhësia individuale
Java 7:	Raporti midis mikrosociolinguistikës dhe makrosociolinguistikës në studimin kush flet, cilën gjuhë, me kënd dhe kur
Java 8:	Kontaktet gjuhësore
Java 9:	Fonologjizmi dhe përtrirja e fonemave latente gjatë të huazuarit gjuhësor
Java 10:	Hulumtimi mbi dygjuhësinë në Afrikë
Java 11:	Gjuhësia dhe kolonializmi
Java 12:	Kontaktet gjuhësore të shqipes në Greqi
Java 13:	Globalizimi dhe komunikimi gjuhësor në botë; shtrirja e anglishtes si gjuhë globale

Java 14:	Shqipja dhe globalizimi
Java 15:	Sintezë e problemeve të diskutuara dhe ripërmbledhje e lëndës

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët janë të obliguar t'i vijnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.

## Titulli i lëndës: LEKSIKOLOGJI E GJUHËS AMTARE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Leksikologji e gjuhës amtare
Niveli:	BA (Baçelor)
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti III   Semestri VI
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa   Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Shpëtim Elezi
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:shpetim.elezi@uni-pr.edu">shpetim.elezi@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	Lënda mësimore përqendrohet në studimin e sistemit leksikor të gjuhës dhe në studimin e kuptimeve gjuhësore. Në këtë lëndë paraqiten njohuri të përgjithshme për studimet leksikore dhe semantike në kuadrin teorik, si dhe në shqipe në veçanti. Njëkohësisht, ofrohen informata themelore e konceptore lidhur me studimet leksiko-semantike.
Qëllimet e lëndës:	Në këtë kurs trajtohen aspekte të ndryshme të problemeve nga fusha e leksikologjisë dhe semantikës. Objektivi i kësaj lënde është që t'u ndihmojë studentëve të nxënë njohuritë themelore nga fusha e leksikologjisë, semantikës dhe leksikografisë. Pra, të marrin njohuri lidhur me natyrën e njësive të leksikut, funksionin dhe kuptimin e tyre.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon konceptet themelore nga fusha e leksikologjisë dhe semantikës;</li> <li>• Gjeneron njohuri lidhur me teorinë dhe praktikën e hartimit të fjalorëve në fushë të leksikografisë</li> <li>• Dallon njësitë e leksikut dhe formën e kuptimit të tyre;</li> <li>• Analizon lëvizjet semantike dhe ndikimin e tyre në sistemin leksikor të gjuhës shqipe;</li> <li>• Analizon strukturën e njësive semantike;</li> <li>• Identifikon shtresat e leksikut, stilet dhe ligjërimet në gjuhën standarde shqipe;</li> </ul>

### Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2 (45 min)	15	22.5
Ushtrime	2 (45 min)	15	22.5
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	15	3.45
Përgatitje për test intermediar	10	2	20
Testi, punimi i seminarit	2	10	20
Detyrë shtëpie	2	10	20
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	10	3	30
Përgatitja për provimin final	1	2	2
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	2	2

Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
Totali			144.45 orë 144.45:25=5.77 6 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	<p>Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrimeve që ofrojnë bazën praktike në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi.</p> <p>Studentët kanë punime seminari e punime me shkrim të kryera në mënyrë individuale, bëjnë punë në çifte dhe në grupe, edhe përmes projekteve, dhe bëjnë diskutime.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%.</p> <p>Vijueshmëria e studentit 5%;</p> <p>Detyrat individuale të kryera në klasë 5%;</p> <p>Detyrat individuale të kryera në shtëpi 10%;</p> <p>Vlerësimi nga testet 40%;</p> <p>Provimi final 40%.</p>		
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> <li>Jani Thomaj, Leksikologjia e gjuhës shqipe, SHBLU, Tiranë, 2002.</li> <li>Jani Thomaj, Prejardhja semantike në gjuhën shqipe, IGJL, ASHSH. Tiranë. 1989.</li> <li>John Lyons, Hyrje në gjuhësinë teorike, Dituria, Tiranë, 2001.</li> </ol>		
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>Jackson, Howard – Amvela Ze, Etienne, Words, Meaning, Vocabulary. Continuum. London, New York, 2004.</li> <li>David Singleton, Language and lexicon: and introduction. First published in Great Britain by Arnold Co-published in the United States of America by Oxford University Press Inc., 198 Madison Avenue, New York, NY10016. 2000.</li> </ul>		
<b>Hartimi i planit mësimor</b>			
Java	Titulli i ligjëratës		
Java 1:	Hyrje në leksikologjinë shqipe; fusha e studimeve dhe lidhja e leksikologjisë me disiplinat e tjera të gjuhësisë		
Java 2:	Gjuha si sistem i shenjave; shenja, i shënjuari dhe shënjuesi		
Java 3:	Fjala si njësi leksikore në gjuhën shqipe; veçoritë dhe struktura e fjalës		
Java 4:	Grupe paradigmatiske të fjalëve sipas ndërtimit: fjalët e formuara me ndajshesa dhe pa ndajshesa; fjalët e formuara me përbërje dhe përngjitje në gjuhën shqipe		
Java 5:	Togfjalëshat dhe njësitë frazeologjike; klasifikimi i njësive frazeologjike në gjuhën shqipe		
Java 6:	Homonimet në gjuhën shqipe; zhvillimi historik i fjalëve dhe vlera e tyre në gjuhën shqipe		
Java 7:	Semantika leksikore; historia dhe zhvillimi i semantikës; zhvillimi i semantikës shqipe		
Java 8:	Test 1		
Java 9:	Kategoritë themelore të semantikës: kuptimi leksikor dhe lëvizja kuptimore Struktura e kuptimit leksikor dhe teoria e fushave semantike		
Java 10:	Dukuritë e semantikës leksikore; prejardhja e kuptimeve në gjuhën shqipe dhe nxjerrja e përbërësve kuptimorë.		
Java 11:	Fjalët me shumë kuptime, lëvizjet kuptimore gjatë formimit të fjalëve; tipat e kuptimeve të fjalëve		
Java 12:	Sinonimet dhe antonimet në gjuhën shqipe		
Java 13:	Leksiku i gjuhës shqipe; shtresëzimet e leksikut të shqipes sipas burimi dhe sipas përdorimit; leksiku i gjuhës standarde shqipe; ligjërimet dhe stilet		

	funkcionale
Java 14:	Leksikografia shqipe dhe zhvillimi i saj Sintezë e problemeve të diskutuara dhe ripërmbledhje e lëndës
Java 15:	Test 2

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimitdhënësit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.

**Titulli i lëndës: LEKSIKOLOGJI E GJUHËS SË SOTME BALLKANIKE ME PRAKTIKË GJUHËSORE**

<b>Informata bazë për lëndën</b>	
Njësia akademike:	Programi i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Leksikologji e gjuhë së sotme ballkanike me praktikë gjuhësore
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti III   Semestri VI
Fondi i orëve në javë:	2+4
Kredi ECTS:	7
Koha/Vendi:	
Ligjërues/e i/e lëndës:	
Informata kontakti:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë ofron një hyrje në leksikologji - disiplinë gjuhësore e cila merret me fjalët, kuptimin e tyre dhe lidhjet e kuptimësisë midis fjalëve. Përveç kësaj, shpjegohen edhe parimet themelore të fjalëformimit në gjuhën së sotme ballkanike. Kjo lëndë e leksikologjisë jep një pasqyrë të koncepteve kryesore leksikologjike, por gjithashtu merret me disa koncepte kryesore të semantikës leksikore dhe morfologjisë derivative, disiplina që janë të lidhura ngushtë me leksikologjinë. Në fokus do të jetë përvetësimi i disa koncepteve themelore si leksema, semema, kuptimi (parësor, dytësor), polisemia, metafora, metonimia, fjalët e huazuara, idiomat, frazeologjizmat, sinonimet, antonimet, denotimet, konotacionet; gjithashtu do të shtjellohet përdorimi pragmatik i fjalëve që u përkasin regjistrave të ndryshëm, siç janë dialektizmat, arkaizmat, regjistri zyrtar dhe joformal (zhargoni, e folmja/slang etj.). Një segment i kësaj lënde merret me proceset kryesore të fjalëformimit, siç janë prejardhja dhe kompozimi apo përbërja, si dhe disa procese tjera fjalëformuese jo dhe aq të përdorura të pranishme në gjuhë së sotme ballkanike. Lënda synon të përmirësojë zotësitë gjuhësore të studentëve jo vetëm nëpërmjet mësimin të fjalëve të reja, por duke mësuar se si të krijojnë fjalë të reja me fjalëformim me prejardhje dhe si të fitohen kuptime të reja të</p>

	<p>fjalëve të cilat janë të njohura për studentët. Në kuadër të kësaj lënde studentët gjithashtu njoftohen me fjalorët përkatës njëgjuhësh që mund t'i përdorin.</p>
<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<p>Synimet kryesore të kësaj lënde janë njoftimi me terminologjinë e përdorur në leksikologji, semantikën leksikore dhe morfologjinë derivative, si dhe konsolidimi i një kornize teorike të domosdoshme për të kuptuar proceset e fjalëformimit dhe lidhjet e kuptimësisë mes fjalëve. Një nga qëllimet e kësaj lënde është të njoftojë studentët me fjalorët përkatës njëgjuhësh, si dhe mënyrën e duhur të përdorimit të tyre, ashtu që ata të mund ta zgjerojnë fjalorin si dhe shkathtësitë e lidhura me përkthimin.</p>
<p>Rezultatet e pritura të të nxënit:</p>	<p>Me rastin e përfundimit të kësaj lënde, pritet që studentët të jenë në gjendje:</p> <p>Të kuptojnë konceptet kryesore të përdorura në leksikologji, semantikë leksikore dhe morfologji derivative (leksema, semema, kuptim (parësor, dytësor), poliseminë, metaforën, metoniminë, fjalët e huazuara, idiomat, frazeologjizmat, sinonimet, antonimet, denotimet, konotacionet; dialektizmat, arkaizmat, të folmet; proceset e fjalëformimit: prejardhja dhe kompozimi apo përbërja);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të shpjegojnë mekanizmat kryesorë me anë e të cilëve disa fjalë zhvillojnë kuptimin dytësor;</li> <li>- Të shpjegojnë proceset kryesore të fjalëformimit dhe të fitojnë aftësi për të formuar fjalë të reja, duke përdorur parashtesa, prapashtesa dhe prefiksoide të ndryshme;</li> <li>- Të kuptojnë kuptimin e parashtesave, prapashtesave dhe prefiksoideve të shpeshta;</li> </ul>

- Të kuptojnë disa idioma, frazeologjizma, arkaizma dhe dialektizma të shpeshta;
- Të zgjerojnë fjalorin me më shumë sinonime dhe antonime;
- Të avancojnë aftësitë e përkthimit duke e zgjeruar fjalorin dhe duke përvetësuar kuptime të reja të fjalëve tanimë të njohura;
- Të dinë se çfarë fjalori përkatës njëgjuhësh të përdorin për qëllimet e duhura dhe si të kërkojnë fjalët;
- Të kuptojnë ngjashmëritë dhe dallimet kryesore midis gjuhës amtare dhe gjuhë së sotme ballkanike për sa i përket formimit të fjalëve, idiomave, si dhe kuptimit të fjalëve, si dhe të shpjegojnë se pse disa aspekte mund të shkaktojnë probleme tek nxënësit e gjuhës joamtare.

<b>Ngarkesa e punës së studentëve (e cila duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënësve)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë mësimore</b>	<b>Ditë / javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	22,5
Teori/Ushtime/Studim i orientuar	4	15	45
Punë praktike			0
Përgatitja e provimit të ndërmjetëm (kolokium)	7	3	21
Konsultime me ligjëruesin e lëndës	10 min.	12	2
Punim seminarik	5	4	20
Testi	1	1	1
Detyrat e shtëpisë	2	12	24
Studim vetanak (bibliotekë/shtëpi)	2	13	26
Përgatitja e provimit përfundimtar	4	3	12
Koha e vlerësimit (test, kuiz, provim përfundimtar)	1	2	2
Projekte, prezantime etj.	1	1	1
<b>Total</b>			<b>154 orë 176,5:25= 7,06 7 ECTS</b>

**Metodat e mësimdhënies:** Ligjërata teorike; ushtime gjatë orës së mësimimit duke përdorur materiale të ndryshme; ligjërata praktike me asistentë me rishikim të kornizës teorike dhe ushtime të ndryshme interaktive (kërkimi i fjalëve në fjalor; gjetja e sinonimeve, antonimet; shpjegimi i kuptimit

	duke përdorur kontekstin; ushtrime të fjalëformimit); një punim seminarik (punë individuale ose në grup, deri në 2000 fjalë) dhe konsultime me mësimdhënësin gjatë shkrimit të tij; detyra individuale të shtëpisë; një test i ndërmjetëm (kolokium); studim vetanak.
Metodat e vlerësimit:	Pragu për kalimin e lëndës 60%; Vijimi i ligjëratave nga studenti 15%; Detyrat individuale të përfunduara në klasë 10%; Detyrat individuale të përfunduara në shtëpi 15%; Vlerësimi nga testet 40%; Provimi përfundimtar 20%; Gjithsej: 100%
Literatura bazë:	Një nga librat vijues, sipas mendimit të profesorit; kapitujt mbi leksikologjinë dhe fjalëformimin: - R. Dragičević (2007), <i>Leksikologija srpskog jezika</i> , Zavod za udžbenike, Beograd - Stanojčić, Ž., Popović, Lj. (2011). <i>Gramatika srpskog jezika za gimnazije i srednje škole</i> . Beograd: Zavod za udžbenike - Piper, P., Klajn, I. (2014). <i>Normativna gramatika srpskog jezika</i> . Novi Sad: Matica srpska - Mrazović, P., Vukadinović, Z. (1990). <i>Gramatika srpskohrvatskog jezika za strance</i> . Novi Sad / Sremski Karlovci: Izdavačka knjižarnica Zorana Stojanovića - Kurešević, M., Belegišanin-Zakić, D. (2010). <i>Gramatika srpskog jezika za strance: Serbian Language Grammar for Foreigners, with exercises and key</i> . 2nd edition. Beograd: Azbukum - Klajn, I. (2006). <i>Gramatika srpskog jezika za strance</i> . Beograd: Zavod za udžbenike.
Literaturë ndihmëse:	- Brown, W., Alt, T. (2004). <i>A Handbook of Bosnian, Serbian, and Croatian</i> . Slavic and East European Language Research Center (SEELRC), Duke University (pp. 50-53) - Sivački, A. (2017). <i>Phraseologisms containing constituents of somatic origin in the Albanian language and translation equivalents thereof in Serbian / Frazeologizmi s konstituentom somatskog porekla u albanskom jeziku</i> . PhD thesis. Beograd: Univerzitet u Beogradu, Filološki fakultet
<b>Përmbajtja e lëndës</b>	
Java	Tema e ligjëratës
Java 1:	Përshkrimi i lëndës/literaturës; Prezantimi i temës, detyrimet dhe vlerësimi i studentëve; Informacion mbi objektivat, rezultatet e pritura nga studentët, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi;

	Pyetjet dhe rekomandimet e studentëve.
Java 2:	Hyrje në terminologjinë themelore dhe përkufizimi i leksikologjisë si disiplinë gjuhësore; Përkufizimi i koncepteve kryesore (leksema, semema, kuptimi (parësor, dytësor), polisemia, metafora, metonimia, fjalët e huazuara, idiomat, frazeologjizmat, sinonimet, antonimet, emërtimi, konotacionet, fjalëformimi)
Java 3:	Fjalorët njëgjuhësh të gjuhës së sotme ballkanike; Fjalorët përkatës dygjuhësh; struktura, klasifikimi dhe udhëzimet për përdorimin e tyre;
Java 4:	Polisemia – përkufizime, koncepte bazë dhe përdorim në mësimdhënien dhe nxënien e L2, dhe në përkthim/interpretim
Java 5:	Metafora konceptuale dhe metonimia konceptuale - konceptet dhe teoritë kryesore, përkufizimet dhe dallimet kryesore
Java 6:	Huazime; Huazimet nga gjuhë të tjera (anglisht, frëngjisht, latinisht, greqisht, gjermanisht, shqip, etj.)
Java 7:	Arkaizmat; dialektizma; slang; zhargon; Rishikimi dhe përgatitja për testin.
Java 8:	Test 1
Java 9:	Sinonimia, antonimia dhe homonimia
Java 10:	Idioma – përkufizime dhe koncepte themelore; Rëndësia e njërive frazeologjike në mësimdhënien dhe të nxënit L2, dhe përkthimin/interpretimin
Java 11:	Kolokimet; denotim; konotacion; shënim Llojet e kolokimeve; Rëndësia e kolokimeve në mësimdhënien dhe të nxënit e L2, dhe përkthimin/interpretimin
Java 12:	Fjalëformimi: parimet bazë; kompozicioni; disa procese fjalëformimi të vogla dhe më rrallë të përdorura
Java 13:	Fjalëformimi: prejardhje; prapashtesat dhe kuptimi i tyre; zvogëluese dhe shtuese

Java 14:	Fjalëformimi: prejardhje; parashtesat, parashtesat dhe kuptimi i tyre
Java 15:	Test 2

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Përdorimi i telefonave mobilë nuk lejohet gjatë ligjëratave, si dhe për arsyen që vijimësia në ligjëratat ndikon në notën përfundimtare të studentit, studentët nuk mund të hyjnë e të dalin nga klasa kur të duan. Studentët inkurajohen të diskutojnë çështje të ndryshme që lidhen me njësinë e kryer, pa ofenduar ose diskriminuar njëri-tjetrit dhe duke respektuar mendimin e tjetrit. Studentët do t'i nënshtrohen një testi të ndërmjetëm dhe një testi përfundimtar.

## Titulli i lëndës: Letërsi e gjuhës amtare (shqipe)

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Ballkanistikë
Titulli i lëndës:	Letërsi e gjuhës amtare (shqipe)
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti III   Semestri V
Numri i orëve në javë:	4+2
Kreditë ECTS:	7 ECTS
Koha / Vendi:	Salla
Mësimdhënësi:	
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Studenti do të njohet me letërsinë shqipe që nga fillimet e saj, do të njohë autorët dhe veçoritë e tyre, diskutet e periudhave të ndryshme të letërsisë dhe vlerën letrare e historike të saj.</p> <p>Kursi ofron një klasifikim sistematik që nga fillimet e shkrimit shqip (shek. XV), përkatësisht letërsinë e vjetër shqipe, letërsinë humaniste, romantizmin në letërsi shqipe, letërsinë moderne, e deri tek letërsia bashkëkohore, pra, letërsinë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit XX. Në kuadër të kësaj do të përmenden zhanret e ndryshme letrare si dhe autorët dhe veprat kryesore, siç janë: Marlin Barletit, Gjon Buzuku, Jeronim de Rada, Naim dhe Sami Frashëri, Faik Konica, Ismail Kadare, etj. duke përfshirë edhe letërsinë arbëreshe e shekullit XVIII, letërsinë alhamiado- poezinë e bejtexhinjve, letërsinë katolike e shekullit XVIII, si dhe poezitë dhe prozat kryesore ndër shekuj.</p>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"><li>• Njohja me letërsinë shqipe që nga shekulli XV-XX</li><li>• Njohja me shkrimtarët kryesorë të letërsisë shqipe dhe veprat e tyre</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohja me veçoritë letrare kryesore të këtyre periudhave;</li> <li>• Njohja me tematikat kryesore të veprave</li> <li>• Pasurimi i kulturës letrare dhe zhvillimi i shijes estetike.</li> </ul>
--	--

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të kenë mundësinë:
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të fitojnë informacione dhe të demonstrojnë njohuri për letërsinë shqipe gjatë historisë;</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të njohin disa nga autorët kryesorë</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të dallojnë veçoritë karakteristike të letërsisë së periudhave kryesore;</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të rrisin më tej aftësinë për analizë kritike të veprës letrare;</li> <li>• të njohin epokat e ndryshme</li> </ul>

Ngarkesa e punës së studentëve (e cila duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënies)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	4 (45 min)	15	45
Punë praktike	2 (45 min)	15	22,5
Përgatitja e provimit të ndërmjetëm (kolokium)	5	2	10
Konsultime me ligjëruesin e lëndës	10 min	12	2
Test, punim seminarik	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja për provimin përfundimtar	4	6	24
Koha e vlerësimit (test, kuiz, provim përfundimtar)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	2	1	2
Gjithsej			151 orë 173:25 = 6.94 7 ECTS

Metodologjia e mësimdhënies:	Realizimi i programit nga lënda Letërsi e gjuhës amtare (shqipe) I bëhet me pjesëmarrjen aktive të studentëve në ligjërata dhe në ushtrime. Studentët
------------------------------	---

	qysh në fillim të semestrit do të pajisen me programin e lëndës dhe do të përcaktohen për nga një temë për të cilën do të punojnë seminarët dhe prezantimet. Me këtë rast, studentët do të mësojnë edhe për punën e pavarur, për mbledhjen e seleksionimin e materialit të nevojshëm për hartimin e një punimi. Për temën e zgjedhur studentët do të referojnë gjatë orës së ushtrimeve.
Metodat e vlerësimit:	Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë; Vijueshmëria-10% Pjesëmarrja ne diskutime-10% Prezantimi- 10 % Testi I -10 % Testi II – 10% Provimi përfundimtar – 50 %
Literatura bazë:	Rexhep Qosja:Historia e Letërsisë Shqipe III, 1984) ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, Historia e letërsisë shqiptare, Tiranë 1983, Rilindja, Prishtinë 1989 Robert Elsie, Historia e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë – Pejë 1997
Literatura shtesë:	Sabri Hamiti, Letërsia e vjetër shqipe (Vepra 8), 1995 Sabri Hamiti, Letërsia moderne shqipe, Libri shkollor, Prishtinë 1998  Rexhep Qosja, Shkrimtarë dhe periudha, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1975

<b>Hartimi i planit mësimor</b>	
Java	Titulli i ligjëratisë
Java 1:	Prezantimi i lëndës. Objekti dhe tematika e studimit
Java 2:	Letërsia humaniste shqiptare- vepra e Marlin Barletit
Java 3:	Letërsia e vjetër shqipe “Meshari” i Gjon Buzukut
Java 4:	Letërsia arbëreshe e shek. XVIII

Java 5:	Letërsia alhamiada- poezia e bejtexhinjve
Java 6:	Vepra e Gjon Nikollë Kazazit dhe letërsia katolike e shek. XVIII
Java 7:	Poezia gojore sipas zhanreve Këngët rituale kalendarike dhe familjare Proza popullore shqiptare e seleksionuar sipas zhanreve Struktura e mitit, gojëdhënës, legjendave gojore në prozë
Java 8:	Testi I
Java 9:	Romantizmi në letërsinë evropiane dhe Romantizmi në letërsinë shqipe- Vepra letrare e Jeronim de Radës
Java 10:	Veprat poetike e Naim Frashërit- “Lulet e Verës dhe “Bagëti e Bujqësia”-
Java 11:	Drama “Besa” dhe romani “Dashuria e Talatit me Fitneten”-Sami Frashëri
Java 12:	Letërsi moderne shqipe Shndërrimet e poezisë Konstituimi i prozës Elemente të dramës e të dramatikës
Java 13:	Lasgush Poradeci: 1. Vallja e Yjeve, 2. Ylli i Zembrës, 3. Ekskursioni teologjik i Sokratit, 4. Kamadeva Faik Konica: Kritika letrare; Luigj Gurakuqi: Vargnimi n’gjuhë shqype; Fan S. Noli: Introdiktat
Java 14:	Letërsia bashkëkohore shqipe- Kadare, Agolli, Qosja, Podrimja, Demaçi
Java 15:	Testi II

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Celularët / telefonat e mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPods) duhet të jenë të fikur (ose në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë ligjëratave përveç nëse nuk kërkohet për aktivitetin e caktuar në klasë.

Studentët duhet të sjellin me vete gjithmonë materiale për mbajtjen e shënimeve dhe të jenë të përgatitur për ligjëratat dhe për çdo aktivitet; Ardhja me kohë është thelbësore, si dhe studentët duhen të jenë aktiv gjatë ligjëratave përndryshe vetëm prania fizike do të vlerësohet si mungesë. Nga studentët pritet që të jenë të përgatitur dhe të gatshëm në çdo kohë që të kontribuojnë në aktivitetet në klasë.

## Lënda: LETËRSI E GJUHËVE BALLKANIKE

Informata bazë për lëndën	
Njësia akademike:	Ballkanistikë
Titulli i lëndës:	Letërsi e gjuhëve ballkanike
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti III   Semestri V
Fondi i orëve në javë:	4+2
Kredi ECTS:	7
Koha/Vendi:	Sipas orarit
Ligjërues/e i/e lëndës:	Prof. ass. dr. Mimoza Hasani-Pllana
Informata kontakti:	<a href="mailto:mimoza.hasani@uni-pr.edu">mimoza.hasani@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	<p>Qëllimi i kësaj lënde është të njoftojë studentët me disa vepra themelore të letërsisë të shkruara në gjuhët e sotme ballkanike. Kjo lëndë ofron një hyrje të shkurtër të letërsisë dhe të veprave nga disa autorë të rëndësishëm që shkruan vepra letrare gjatë shekullit të XX-të. Studentët do të njihen me karakteristikat e gjinive letrare dhe do të mësojnë për autorët emblematik të letërsisë, shqipe, greke, serbe, bullgare, rumune, boshnjake, turke dhe kroate. Autorët që do të trajtohen janë: Ernest Koliqi me veprat “Tregtar flamujsh” dhe “Hija e maleve”; Nikos Kazantzakis me veprat “Zorba” dhe “Tundimi i fundit”; Meša Selimović me veprat “Kështjella” dhe “Vdekja dhe Dervishi”; Desanka Maksimovic “Një letër dashurie”, BULLGAR SHTOHET”, Mircea Eliade me veprën “Netët e Bengalit”, Desanka Maksimović me veprën “Letër dashurie”, Orhan Kemal me veprat “Ëndrra të burgosura në qelinë 72”, Nikola Vaptsarov me vjersha të zgjedhura dhe “Shtëpia e babait” dhe Dževad Karahasan me veprën “Sara dhe Serafina”</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i lëndës është që të njoftojë studentët me gjinitë letrare kryesore dhe autorët e shquar që kanë shkruar në gjuhët e sotme Ballkanike gjatë shekullit XX. Poezitë, novelat, romanet dhe tregimet do t'u prezantohen studentëve në mënyrë që të njohin letërsinë e fqinjëve. Derisa jetojnë në një shoqëri ballkanike, ata duhet të kenë njohuri që përfshijnë kombet, kulturat dhe botëkuptimet letrare përtej</p>

kufijve të vendit.

Rezultatet e pritura të të nxënit:

- Me rastin e përfundimit të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:
- Shpjegojnë karakteristikat themelore të letërsisë së vendeve fqinje.
  - Të renditin veprat kryesore letrare të autorëve për të cilët kanë mësuar;
  - Të kuptojnë temat, motivet e fushat kryesore të pranishme në veprat e autorëve për të cilët kanë mësuar;
  - Të kenë një panoramë më të gjerë të traditës letrare të popujve ballkanik;
  - Të kuptojnë traditën, arketipet dhe vlerat e një komuniteti përmes letërsisë së tij;
  - Të interpretojnë vepra letrare
  - Të analizojnë veprat letrare për nga tematika, motivet, simbolet etj.
  - Të shkruajnë ese duke interpretuar vepra letrare me këndvështrim kritik.

**Ngarkesa e punës së studentëve (e cila duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit)**

Aktiviteti	Orë në klasë	Ditë / javë	Gjithsej
Ligjërata	4 (45 min)	15	45
Punë praktike	2 (45 min)	15	22,5
Përgatitja e provimit të ndërmjetëm (kolokium)			0
Konsultime me ligjëruesin e lëndës	10 min	12	2
Lexim	2	15	30
Punim seminarik	5	1	5
Detyrat e shtëpisë	1	15	15
Studim vetanak (bibliotekë/shtëpi)	2	15	30
Përgatitja e provimit përfundimtar	5	5	25
Koha e vlerësimit (test, kuiz, provim përfundimtar)	1	2	2
Gjithsej			154 orë 176,5:25 = 7,04

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata teorike; ushtrime gjatë orës së mësimit duke përdorur materiale të ndryshme; leximi i veprave të veçanta letrare të rëndësishme; një punim seminarik deri në 1500 fjalë (punë individuale ose në grup); detyra individuale të shtëpisë; studim vetanak.
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrje në ligjërata 10 % Pjesëmarrje aktive në ligjërata 10 % Testi semestral 10 % Seminar 15% Provimi përfundimtar 55 %
Literatura bazë:	Ernest Koliqi, “Hija e maleve dhe Tregtar flamujsh”, Berk, Tiranë, 2020. Nikos Kazantzakis, “Zorba” Pema, Prishtinë, 2022. Mircea Eliade, "Bengal Nights/ Netët e Bengalit" University of Chicago Press, 1995. Desanka Maksimovic , “Një letër dashurie”, SKZ, 1983. Dževad Karahasan, “Sara dhe Serafina” Durieux, 1999. Miroslav Krleža, “Lirika”, Svjetlost Sarajevo, 1966. Orhan Kemal, “My father`s House/Shtëpia e babait”, Everest, Stamboll, 2013. Antologji e poezisë bullgare, Dudaj, Tiranë, 2001. Nikola Vaptsarov, Vjersha të zgjedhura, Naim Frashëri, Tiranë, 1952.
Literaturë ndihmëse:	Kujtim Rrahmani, “Intertekstualiteti dhe oraliteti: E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku”, AIKD, Prishtinë, 2002. Nikos Kazantzakis, “Tundimi i fundit”, Pegi, Tiranë, 2015. Orhan Kemal, “Ëndrra të burgosura në qelinë 72”, Fan Noli, Tiranë, 2013. Miroslav Krleža, The Banquet in Blitva/Banket në Blitva”, Northwestern University Press, 2002.

### Përmbajtja e lëndës

Java	Tema e ligjërates
Java 1:	Letërsia e gjuhëve ballkanike në shek.XX
Java 2:	Ernest Koliqi: “Hija e maleve”
Java 3:	Ernest Koliqi: “Tregtar flamujsh”
Java 4:	Miroslav Krleža, “The Banquet in Blitva/Banketi në Blitva”

Java 5:	Miroslav Krleža, "Lirika"
Java 6:	Dževad Karahasan, "Sara dhe Serafina"
Java 7:	Test
Java 8:	Orhan Kemal, "Ëndrra të burgosura në qelinë 72",
Java 9:	Orhan Kemal, "My father`s House/Shtëpia e babait"
Java 10:	Antologji e poezisë bullgare
Java 11:	Nikola Vaptsarov, "Vjersha të zgjedhura"
Java 12:	Desanka Maksimovic "Një letër dashurie"
Java 13:	Mircea Eliade, "Bengal Nights/ Netët e Bengalit"
Java 14:	Nikos Kazantzakis: "Zorba"
Java 15:	Nikos Kazantzakis: "Tundimi i fundit"

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Vijueshmëri e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve që u ofrohen studentëve. Respektimi i rregullave profesionale dhe parimeve etike gjatë studimit.

Mjetet e komunikimit, gjatë orës mësimore nuk duhet të përdorën për qëllime që nuk përkasin me qëllimet e lëndës. Ndërsa mjetet e njëjta mund të përdorën për realizimin e lëndës mësimore, por duke mos e cenuar privatësinë e askujt në sallën e mësimit.

### **Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:**

<b>Pjesa teorike</b>	<b>Pjesa praktike</b>
60%	40 %

**Titulli i lëndës: LETËRSI KRAHASIMTARE**

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Letërsi krahasimtare
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti III   Semestri VI
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Salla
Mësimdhënësi:	Agron Gashi
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Letërsia Krahasimtare si lëndë e cila studion lidhjet dhe marrëdhëniet midis dy e më shumë letërsive, ndikimin e tyre ndaj njëra tjetrës, si dhe ngjashmëritë ose dallimet midis letërsive dhe veprave të ndryshme, duke e mos anashkaluar raportin e letërsisë me filozofinë, historinë, filmin, muzikën, etj. do të ndihmojë studentët në punë hulumtuese – shkencore në një fushë specifike të studimeve letrare.</p> <p>Në kuadër të kësaj metodologjia letrare krahasimtare ofron njohuri specifike të metodologjisë letrare, instrumentet dhe nocionet teoriko – letrare siç janë: influencat, interaksionet letrare, relacionet, plagjjarizmi, burimet e letërsisë, gjeneza e zhanreve letrare, intertekstualiteti, përkthimet, receptimi, lexuesi dhe të lexuarit, kontaktet letrare etj.</p> <p>Të gjithë këta konstituentë do të zhvillohen përmes një procesi interaktiv, ku do të përfshihen shembuj të letërsive të veçanta dhe përfaqësues kryesorë të tyre.</p>
Qëllimet e lëndës:	Objektivat e kësaj lënde janë:

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Si një fushë ndërkulturore, të krijojë marrëdhëniet dhe njohjet ndërkulturore</li> <li>• Të hapë mendimet dhe qasjet e studentëve ndaj kulturave dhe zakoneve të tjera</li> <li>• Të njohë studentët me vlerat universale,</li> <li>• Të njohë studentët me konceptet dhe postulatet themelore të disiplinës së Komparatistikës si dhe me zhvillimet aktuale të saj te ne dhe në botë.</li> <li>• Të aftësojë studentët individualisht apo në grupe të hulumtojnë vetë dukuri, vepra e autorë të letërsive ballkanike dhe botërore në kontekstin krahasimtar.</li> </ul>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të kenë mundësinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të fitojnë informacione dhe të demonstrojnë njohuri për letërsinë e shkruar në vende të ndryshme e në periudha të ndryshme historiko – letrare;</li> <li>• Të tregojnë aftësi për lexime kritike si dhe për shkrime kritike – analitike e krahasimtare;</li> <li>• Të përdorin me saktësi literaturën shkencore teoriko – letrare e historiko – letrare.</li> <li>• Te shkruajnë ese kritike për vepra të ndryshme letrare</li> </ul>

<b>Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)</b>			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			0
Punë praktike			0
Përgatitje për test intermediar	4	2	8
Konsultime me mësimdhënësin	15 min.	10	2,5

Puna në terren			0
Testi, punimi i seminarit	2	8	16
Detyrë shtëpie	2	10	20
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	14	42
Përgatitja për provimin final	2	5	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj.	2	1	2
<b>Totali</b>			<b>125:5=5 5 ECTS</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Puna është teorike në kombinim nga të cilat dalin shpjegimet për diskutet e këtyre fazave të letërsisë në kontekst me zhvillimet e letërsive tjera. Këmbëngulet që studentët të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e veta lidhur me programin e shtjelluar. Interpretimi i veprave nga ana e studentëve. Detyra të shtëpisë, punime seminarike për qasjen teorike, si dhe prezantime individuale dhe ekipore.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë; Vijimi i rregullt 10%  Angazhimi dhe pjesëmarrja active 10%  Vlerësimi i parë dhe i dytë 20%  Punimi seminarik 10%  Testi përfundimtar 50%		
<b>Literatura bazë:</b>	Homeri: Iliada – Gj. Fishta: Lahuta e Malcis; Eskili: Orestia – Shekspiri: Hamleti; Dante Aligieri: Komedia hyjnore – Servantesi: Don Kishoti i Mançës; Stendal: E kuqja dhe e zeza – Tolstoj: Ana; Uliksi; E Heminguej: Për kë bien kambanat – P. Marko: Hasta la ; Ivo Brešan: Predstava Hamleta u selu Mrduša Donja – Shekspiri: Hamlet; Ag. Matoš – Poe (vepra të zgjedhura)		
<b>Literatura shtesë:</b>	Yves Chevrel: Letërsi e krahasuar, Tiranë 2002; Rene Velek e Ostin Uoren: Teoria e letërsisë; Northrop Fraj: Anatomia e kritikës; Osman Gashi: Studime interliterare, Prishtinë 2001; Miti dhe romantizmi evropian, Prishtinë 2005;; Eliot, Thomas Sterns: Ese të zgjedhura, Prishtinë, 1982; Zvonko Kovač: Poredbena i/ili interkulturna povijest književnosti, Zagreb, 2001. Miroslav Beker, Uvod u komparativnu književnost, Školska knjiga, Zagreb, 1995. Zoran Konstantinović: Uvod u komparativno proučavanje književnosti, Beograd, 1984. Slika drugog u balkanskim i srednjoevropskim književnostima, zbornik, Beograd, 2006.		

## Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje në lëndë Letërsia kombëtare, Letërsia botërore dhe Letërsia e përgjithshme
Java 2:	Letërsia e krahasuar – postulatet themelore, bazat teorike dhe historia
Java 3:	Periodhat letrare dhe zhanret letrare
Java 4:	Letërsia perëndimore deri në Renesancë
Java 5:	Letërsia perëndimore pas Renesancës
Java 6:	Morfologjia letrare (gjinitë, zhanret e format letrare – perspektiva globale)
Java 7:	Periodizimi ndërkombëtar i letërsisë – periodhat letrare; brezat (gjeneratat)
Java 8:	Testi I
Java 9:	Tematologjia: Letërsia dhe fusha të tjera
Java 10:	Idetë letrare (vështrim i përgjithshëm)
Java 11:	Idetë religjioze dhe idetë filozofike Idetë shkencore dhe idetë politike
Java 12:	Shkëmbimet letrare ndërkombëtare
Java 13:	Intertekstualiteti si bazë e letërsisë krahasimtare
Java 14:	Reminishencat, huazimet letrare dhe ndikimet
Java 15:	Testi II

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Celularët / telefonat e mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPods) duhet të jenë të fikur (ose në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë ligjëratave përveç nëse nuk kërkohet për aktivitetin e caktuar në klasë. Aktivitetet e tjera, të tilla si kontrollimi i emailit personal ose shfletimi i faqeve të internetit, janë të ndaluara.

Studentët duhet të sjellin me vete gjithmonë materiale për mbajtjen e shënimeve dhe të jenë të përgatitur për ligjëratat dhe për çdo aktivitet; Ardhja me kohë është thelbësore, si dhe studentët duhen të jenë aktiv gjatë ligjëratave përndryshe vetëm prania fizike do të vlerësohet si mungesë. Nga studentët pritet që të jenë të përgatitur dhe të gatshëm në çdo kohë që të kontribuojnë në aktivitetet në klasë.

## Titulli i lëndës: MEDIET NË BALLKAN

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Mediet në Ballkan
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i IV, Sem. VIII
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Departamenti i Ballkanistikës Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Mimoza Hasani-Pllana
Të dhënat kontaktuese:	mimoza.hasani@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Mediet si mjet i komunikimit masiv dhe i informimit zyrtar dhe jozyrtar kanë rol të pazëvendësueshëm për shoqëritë, individët, për komunitete të caktuara që ndahen nga masa për nga profesioni, shtresa shoqërore, përkatësia etnike, fetare, gjinore, mosha, ideologjia; si dhe për nga orientimet dhe interesave të ndryshëm. Organet, organizatat, grupet e caktuara shfrytëzojnë mjetet mediale për të komunikuar me target-grupin e vetë, me qëllim të informimit, të krijimit të opinionëve, për të krijuar bindje, për të bërë thirrje etj. Në këtë kurs do të ofrohen informata lidhur me aspektet e lartshënuara të mediave dhe për organet, institucionet mediale në Ballkanin Perëndimor.
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka për qëllim të ofrojë njohuri themelore për konceptet e ndryshme të mediave dhe për mediat në Ballkan, me theks të veçantë në Ballkanin Perëndimorë, si dhe të trajtoj aspektet e ndryshme të mediave në raport me masën.
Rezultatet e pritura të të nxënit:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:

- të përshkruaj konceptin e mediave dhe të llojeve të ndryshme të media;
- të krijoj një opinion për fuqinë e mediave në mobilizimin ose demobilizimin e masës;
- të argumentoj anët pozitive dhe negative të fuqisë mediale në aspektin e efekteve/rezultateve ndaj shoqërisë, një grupi të caktuar apo ndaj një individi;
- të diskutoj etikën profesionale sa i përket aspektit të indoktrinimit, të krijimit të opinionit përmes mediave;
- të jetë i informuar për instrumentet ligjore dhe institucionale të mbikëqyrjes së mediave;
- të analizoj rolin e mediave në lëvizjet shoqërore, bazuar në shembuj konkret në arealin e Ballkanit perëndimorë;
- të zhvilloj këndvështrim pozitiv për aspektet ekonomike të mediave si gjenerues i të mirave ekonomike.

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Teori/Punë në laborator/Ushtime			0
Punë praktike	2	5	10
Përgatitje për test intermediar	2	4	8
Konsultime me mësimdhënësin	20 min.	15	6
Puna në terren			0
Testi, punimi i seminarit	3	3	9
Detyrë shtëpie	2	5	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	14	42
Përgatitja për provimin final	4	2	8
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	4	1	4
<b>Total</b>			<b>101:25=4,96 5 ECTS</b>

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata; Ushtrime;
Mjetet e konkretizimit:	Punime seminarike; Diskutime në grupe (studentët ndahen në grupe diskutimi për të: shkruar dhe analizuar tekstet; zhvilluar pyetje dhe diskutime specifike në lidhje me tekstin; zhvilluar debata me gjuhë argumentuese).
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrje në ligjërata 10 % Pjesëmarrje aktive në ligjërata 10 % Testi semestral 10 % Seminar 15% Provimi përfundimtar 55 %
Literatura primare:	Kemal Kurspahic, Prime time crime: Balkan media in war and peace, 2003, Washington. Pål Kostø, Media Discourse and Yugoslav Conflicts, MPG Books Ltd, 2009, Great Britain.
Literatura shtesë:	Freedom of Media in The Western Balkans (2014). European Parliament- Directorate General For External Policies of The Union. <a href="https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2014/534982/EXPO_-STU(2014)534982_EN.pdf">https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2014/534982/EXPO_-STU(2014)534982_EN.pdf</a>
<b>Hartimi i planit mësimor</b>	
Java	Titulli i ligjërates
Java 1:	Mediat: Konceptet themelore dhe mjetet mediale
Java 2:	Mediat dhe politika
Java 3:	Mediat, shoqëria dhe ekonomia
Java 4:	Mediat dhe globalizimi
Java 5:	Mediat aktuale në Ballkanin perëndimorë
Java 6:	Mediat në procesin e shpërbërjes së ish Jugosllavisë
Java 7:	Mediat në ish Jugosllavi
Java 8:	Qëndrimi i mediave të ndryshme në një ngjarje shoqërore: Rast studimi
Java 9:	Klasifikimi i mediave në Ballkanin perëndimor sipas burimeve buxhetore

Java 10:	Klasifikimi i mediave në Ballkanin perëndimor sipas politikave editoriale
Java 11:	Klasifikimi i mediave në Ballkanin perëndimor sipas gjuhëve editoriale
Java 12:	Klasifikimi i mediave në Ballkanin perëndimor sipas fushave editoriale
Java 13:	Organet e mbikëqyrjes së mediave në Ballkanin perëndimor
Java 14:	Etika profesionale dhe legjislacioni medial në Ballkanin perëndimorë
Java 15:	Liria shtypit në Ballkanin perëndimorë dhe asociacionet mediale

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Vijueshmëri e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve që u ofrohen studentëve. Respektimi i rregullave profesionale dhe parimeve etike gjatë studimit.

Mjetet e komunikimit, gjatë orës mësimore nuk duhet të përdorën për qëllime që nuk përkasin me qëllimet e lëndës. Ndërsa mjetet e njëjta mund të përdorën për realizimin e lëndës mësimore, por duke mos e cenuar privatësinë e askujt në sallën e mësimit.

### **Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:**

<b>Pjesa teorike</b>	<b>Pjesa praktike</b>
50%	50 %

## Titulli i lëndës: MEDIET SHQIPTARE NË BALLKAN

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Mediet shqiptare në Ballkan
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti IV   Semestri VII
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Departamenti i Ballkanistikës   Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Mimoza Hasani-Pllana
Të dhënat kontaktuese:	Mimoza.hasani@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Mediet pasqyrojnë shoqërinë. Mediet shqiptare ofrojnë mundësi për të diskutuar përgjithësisht mbi shoqërinë shqiptare: kahjet e zhvillimit, ndryshimet në rrjedhën e kohës, veçoritë dalluese, ideologjitë në kohë. Mediet shqiptare kanë pasur një rrugë të veçantë. Nisin në kuadër të Rilindjes Këmbëtare si mjet për shprehje dhe përhapje identitare, por me kohë u përshtaten rrethanave shoqërore. Baza kryesore do të jenë medet në konceptin e tyre bazik: mjete informacioni, pra gazetat, radio, televizioni dhe mediumet e reja, në formën e portaleve. Megjithatë, një pjesë e vogël e kursit do të trajtojë edhe elementin propagandistik, por edhe mediumet si kanale komunikuese: filmi, botimet e të ngjashme.</p> <p>Kursi përfshin pjesën informative, por ka edhe anën praktike – studentët do të kenë mundësi të nxënë edhe elementet kryesore të të hartuarit për nevoja të medieeve në shqipen.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Lënda ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme lidhur me mediet fillimisht dhe për mediet shqiptare në veçanti. Studentët pritet të kenë njohuri mbi karakteristikat dalluese të shkrimit mediatic, njohuri mbi teoritë kryesore të medieeve dhe të kenë një panoramë të historikut mediatic shqiptar. Njëherësh, synojmë që studentëve t'u</p>

Rezultatet e pritshme të nxënies:	ofrohet edhe një sfond i përgjithshëm mbi filmin, artin përgjithësisht, reklamat në kulturën shqiptare.
	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:
	- të krijojë një pasqyrë të historikut të medieve shqiptare;
	- të dallojë drejtimet kryesore të gazetarisë dhe të dijë të klasifikojë llojet e medieve në epoka të ndryshme;
	- të nxitet për orientim nga gazetaria e përgjegjësive sociale; të krijojë të menduar kritik, por gjithëpërfshirës në shoqëri.
	- të njohë dallojë karakteristikat dalluese të medimeve të reja – interneti – në shoqërinë shqiptare;
	- të krijojë një pasqyrë rreth filmit, botimeve, reklamës, artit në kulturë shqiptare;
	- të mësojë strukturat tekstore të të shkruarit në medie përgjithësisht dhe karakteristikat dalluese strukturore të lajmit në mediet shqiptare;
- të mësojë elemente të këndvështrimit tekstor (koha e foljes, përdorimi i mbiemrave) në tekstet e shkruara dhe të kuptojë zgjedhjet stilistike dhe regjistrat e përdorimit të gjuhës në mediet të shkruara dhe audio-vizive.	

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			0
Punë praktike	2	5	10
Përgatitje për test intermediar	2	2	4
Konsultime me mësimdhënësin	15 min.	4	1
Puna në terren			0
Testi, punimi i seminarit	3	1	2
Detyrë shtëpie	4	3	12

Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	6	12
Përgatitja për provimin final	3	5	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.	2	1	2
<b>Total</b>			<b>55:25=3,1 3 ECTS</b>
<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Ligjërata; Ushtrime; Punime seminarike; Diskutime në grupe (studentët ndahen në grupe diskutimi për të: analizuar tekstet; zhvilluar pyetje dhe debat me gjuhë argumentuese).		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Pjesëmarrje në ligjërata 10 % Pjesëmarrje aktive në ligjërata 10 % Testi semestral 10 % Seminar 15% Provimi përfundimtar 55 %		
<b>Literatura primare:</b>	Bardh Rugova, Gjuha e gazetave, KOHA, Prishtinë, 2009. Hamit Boriçi, Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare, “Gjergj Fishta”, Tiranë 1997. Blendi Fevziu, Histori e shtypit shqiptar 1848 – 2005, Onufri, Tiranë, 2005.		
<b>Literatura shtesë:</b>	Komiteti për lirinë e shtypit në botë, Manual për gazetarët e Evropës Qendrore dhe Lindore, Dituria, Tiranë, 1999.		
<b>Hartimi i planit mësimor</b>			
<b>Java</b>	<b>Titulli i ligjëratisë</b>		
Java 1:	Pasqyrë e përgjithshme e medieve me vështrim të veçantë mbi mediet shqiptare		
Java 2:	Mediet shqiptare dhe Rilindja Kombëtare: Nga L’Albanese d’Italia e tutje		
Java 3:	Mediet e para shqipe në Kosovë		

Java 4:	Katër drejtimet kryesore të gazetarisë: autoritarizmi, totalitarizmi, libertarianizmi dhe përgjegjësia sociale
Java 5:	Autoritarizmi – mediet në kohën e Mbretit Zog
Java 6:	Totalitarizmi – mediet në kohën e monizmit
Java 7:	Totalitarizmi – ngjashmëri dhe dallime, Shqipëri - Kosovë
Java 8:	Libertarianizmi – mediet pas vitit 1991
Java 9:	Përgjegjësia sociale, rasti i gazetaës “Koha Ditore”
Java 10:	Shtypshkronjat shqiptare
Java 11:	Filmi shqiptar
Java 12:	Histori e reklamave në shqipen i
Java 13:	Mediet e reja, etika profesionale dhe legjislacioni medial në Kosovë dhe në Shqipëri
Java 14:	Veçori të shkrimit mediatic në gjuhën shqipe: struktura tekstore
Java 15:	Veçori të shkrimit mediatic në gjuhën shqipe: elemente të stilit dhe këndvështrimi tekstor

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Vijueshmëri e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve që u ofrohen studentëve. Respektimi i rregullave profesionale dhe parimeve etike gjatë studimit.

Mjetet e komunikimit, gjatë orës mësimore nuk duhet të përdoren për qëllime që nuk përkasin me qëllimet e lëndës. Ndërsa mjetet e njëjta mund të përdoren për realizimin e lëndës mësimore, por duke mos e cenuar privatësinë e askujt në sallën e mësimi.

### **Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:**

<b>Pjesa teorike</b>	<b>Pjesa praktike</b>
40%	60 %

## Titulli i lëndës: METODOLOGJI E PUNIMIT SHKENCOR

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Metodologji e punimit shkencor
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti IV   Semestri VII
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Salla
Mësimdhënësi:	
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Fusha e Ballkanistikës është komplekse, ndërsa hulumtimi shkencor është ndër prioritarët. Kjo krijon nevojën e njohjes së metodologjisë së punimit shkencor që do të mund të shfrytëzohej për të kërkuar e aplikuar dijet për dukuri të ndryshme ballkanike. Metodologjia e punimit shkencor mund të përkufizohet si kërkim sistematik dhe me metoda shkencore të informacioneve relevante për këtë fushë komplekse. Si një aktivitet hulumtues akademik, hulumtimi shkencor përfshin informacionet bazike të kërkimit shkencor, si: identifikimin dhe përkufizimin e problemeve, mbledhjen, organizimin dhe vlerësimin e fakteve dhe të dhënave, formulimin e hipotezave, analizimin dhe zgjidhjen e problemeve, zbatimin e induksionit e të deduksionit dhe testimin e kujdesshëm të përfundimeve për të përcaktuar nëse ato përputhen me hipotezat, shfrytëzimin e saktë të referencave. Nëpërmjet kësaj lënde bëhet avancimi metodologjik i hulumtuesve sasiore e cilësore, si për të vlerësuar në mënyrë kritike hulumtimet e publikuara, ashtu edhe për të realizuar hulumtimet e tyre.</p>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"><li>• të thellojnë njohuritë për dukuri të caktuara;</li><li>• të krijojnë njohuri të mjaftueshme për aplikimin e metodave analitike dhe shkencore;</li><li>• të demonstrojnë të kuptuarit e metodave hulumtuese të aplikueshme në fushën e tyre të</li></ul>

Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>studimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të planifikojnë hulumtimin e tyre;</li> <li>të aplikojnë metodologjinë hulumtuese kuantitative dhe kualitative në hulumtimin e tyre.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të kenë mundësinë:</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të jenë të aftë ta përdorin metodologjinë kërkimore në fushën e kërkimeve linguistike nga aspekti teorik dhe praktik.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>të hulumtojnë e argumentojnë mendimet dhe hipotezat e shtruara në një punim;</li> <li>të nxjerrë rezultate shkencore duke zbatuar metoda adekuate gjatë studimit.</li> </ul>

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Teori/Punë në laborator/Ushtime			0
Punë praktike	2	5	10
Përgatitje për test intermediar	1	5	5
Konsultime me mësimdhënësin	20 min.	15	6
Puna në terren			0
Testi, punimi i seminarit	2	5	10
Detyrë shtëpie	2	5	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	14	42
Përgatitja për provimin final	2	5	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj.	3	1	3
<b>Totali</b>			<b>102:25=4,98 5 ECTS</b>

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtime, punë praktike, konsultime, punime seminari, detyra të shtëpisë, projekte hulumtuese, prezantime, diskutime etj. Përmes këtyre metodave dhe teknikave të punës, studentët do të shfaqin dijet dhe mendimet e tyre, si dhe do të diskutojnë lidhur me problemet e caktuara. Kështu, do të nxitet të formohet mendimi i pavarur shkencor i
------------------------------	---

	studentit, si një hulumtues dhe kërkues i përhershëm i të vërtetës shkencore.
Metodat e vlerësimit:	Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë; Vlerësimi i parë: 25% Vlerësimi i dytë: 30% Detyrat e shtëpisë : 10% Vijimi i rregullt: 5% Provimi final: 30% Total: 100%
Literatura bazë:	Ecco, Umberto. (1997). <i>Si bëhet një punim diplome</i> . Tiranë. Barnet, S. - Ballanca, P. – Stubbs, M. (2008). <i>Shkrimi akademik</i> . Tiranë. Mackey, A. & Gass, S. (2005). <i>Second language research: Methodology and design</i> . Mahwah, NJ: Erlbaum.
Literatura shtesë:	Barnet and Stubbs's (1995). <i>Practical Guide to Writing – with readings</i> . New York. Johnston, Barbara (2000). <i>Qualitative methods in Sociolinguistics</i> . Oxford University Press.
<b>Hartimi i planit mësimor</b>	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Rëndësia e metodologjisë kërkimore shkencore; qasjet bashkëkohore në punën kërkimore.
Java 2:	Hulumtimi ndërdisiplinar, dallimet në mes të shkencave ekzakte dhe shoqërore; zgjedhja e temës.
Java 3:	Roli dhe rëndësia e shtruarjes së hipotezave gjatë punës kërkimore; qëllimi i hulumtimit.
Java 4:	Përcaktimi i objektivave dhe formësimi i kuadrit të temës.
Java 5:	Mbledhja e materialit bibliografik dhe ndërtimi i korpusit studimor.
Java 6:	Plani i punimit dhe nxjerrja e referencave.
Java 7:	Metodologjia: dizajnimi i studimit; metoda kuantitative dhe kualitative; metodat e mbledhjes së dhënave; marrja dhe tipat e mostrës. Përgatitja e pyetësorit
Java 8:	Testi I
Java 9:	Format dhe stilet e citimit të burimeve; përdorimi i referencave autor/datë dhe fusnotat. Citimet dhe plagjiatura.
Java 10:	Aspekti etik në punën kërkimore-shkencore; rregullat dhe udhëzimet ndërkombëtare; parimet bazë; metodat e sigurimit dhe të mbrojtjes së respektit të informantëve (dhënia me shkrim i pëlqimit me vetëdije,

	konfidencialiteti, grupet e rrezikuara).
Java 11:	Përdorimi i teknologjisë informative në hulumtimin shkencor; njohja me sistemet softuerike që përdoren për hulumtim dhe për përgatitjen e temës.
Java 12:	Shkrimi i temës, redaktimi dhe nxjerrja e përfundimeve; ndërtimi i indeksit të termave dhe të emrave; pasqyra e lëndës.
Java 13:	Shqyrtimi përfundimtar i punimit.
Java 14:	Publikimi dhe formatet e publikimit.
Java 15:	Testi II

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët duhet t'i ndjekin me rregull ligjëratat. Në rast të mungesave të shumta të paarsyeshme studentëve nuk do t'u verifikohet pjesëmarrja e rregullt në ligjëratat e ushtrime. Prania e studentëve në ligjëratat dhe në ushtrime shënohet në fletët e evidencës. Hartimi i seminarit është i domosdoshëm me qëllim që të kalohet provimi.

Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t'i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave.

## Titulli i lëndës: MORFOLOGJI E GJUHËS AMTARE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Morfologji e Gjuhës Amtare
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti II, Sem. I
Numri i orëve në javë:	2+4
Kreditë ECTS:	7
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	Agnesa Hasimja
Të dhënat kontaktuese:	xxx
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda Morfologji e gjuhës amtare është ndarë në dy pjesë. Fillimisht nis me fjalëformimin që në shqipen është shumë i rëndësishëm dhe në këtë kurs synon të mësohet kundruar nga këndvështrime të ndryshme – morfosintaksore, leksiko-semantike dhe kognitive. Fjalëformimi i shqipes është shumë i larmishëm dhe së këndejmi ndërton raporte të ndryshme morfosintaksore, por edhe semantike dhe kognitive. Në vazhdim të kursit mësohen pjesët e ligjëratës që i takojnë sistemit emëror të shqipes, përfshirë emrin, mbiemrin, përemrin dhe numërorin. Pjesët e ligjëratës gjithashtu mësohen jo vetëm në bazqë të formës, por edhe të funksionit që kryejnë.</p> <p>Pjesa e dytë e këtij moduli trajton sistemin foljor dhe pjesët e pandryshueshme të ligjëratës në gjuhën shqipe. Fillimisht sistemi foljor i shqipes, edhe i çliruar nga problemet me foljet e parregullta që i kanë gjuhët si anglishtja, është shumë i komplikuar për shkak të mënyrave të shumta dhe unike, si dhe për shkak të kohëve të foljeve. Gjithashtu lënia pasdore e disa kohëve foljore me rastin e njësimin të shqipes, e</p>

bën sistemin foljor edhe më interesant. Edhe ndajfolja është e rëndësishme, por nuk mbeten prapa pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, të cilat kanë funksione të ndryshme sintaksore, të cilat e bëjnë materien e studimit të kësaj lënde shumë interesante dhe të rëndësishme, jo vetëm vetvetiu por edhe për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në sintaksën e shqipes.

#### Qëllimet e lëndës:

Kjo lëndë synon t'i fusë studentët në studimet mbi njohjen e formës dhe strukturës së fjalëve të gjuhës shqipe, duke ua mësuar atyre konceptet themelore dhe të avancuara të morfologjisë, në pjesën e parë ku flitet për strukturën e fjalëve dhe të fjalëformimit dhe për tipat e fjalëformimit në gjuhën shqipe; pjesë të ligjëratës që janë pjesë e sistemit nominal të shqipes, që janë emri, mbiemri e përemri, si dhe numërorët.

Pjesa e dytë e lëndës synon t'i pajisë studentët më njohjen të thelluara lidhur me pjesë e ligjëratës që janë pjesë e sistemit verbal të shqipes, që janë folja e ndajfolja, si dhe pjesëza, parafjala, lidhëza e pasthirrma. Po ashtu, kursi synon t'i mësojë studentët për ta bërë identifikimin funksional të fjalëve të shqipes dhe klasifikimin po ashtu funksional të tyre nëpër pjesë të ligjëratës.

Kjo natyrë e morfologjisë së shqipes i bën këto studime edhe më të nevojshme dhe më praktike, duke i përgatitur studentët edhe për kurset e mëpastajme të gramatikës, në pjesën e sintaksës dhe për studime të historisë së gjuhës.

#### Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti:

	<ul style="list-style-type: none"> <li>definon nocionet themelore dhe ato më të avancuara të morfologjisë së shqipes</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>definon rregullat e fjalëformimit të shqipes</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>analizon pjesët e ligjëratës sipas funksionit të tyre.</li> <li>analizon tekste në nivelin morfologjik</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>dallon format analitike nga format sintetike</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>krahason raportet paradigmatiche dhe raportet sintagmatike me rastin e fjalëformimit</li> </ul>

### Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjërata	2 (45 min)	15	22.5
Ushtrime	4 (45 min)	15	45
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	8	2
Testi, punimi i seminarit	8	2	16
Detyrë shtëpie	2	10	20
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja për provimin final	10	2	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	6	12
Projektet, prezantimet, etj.	2	2	4
<b>Totali</b>			171.5 orë 176:25=7.04 7 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi organizohet përmes ligjëratave dhe ushtrimeve në klasë. Po ashtu studentët marrin detyra shtëpie dhe fletëteste të vazhdueshme të cilat më pas ushtrohen dhe analizohen gjatë orëve të ushtrimeve. Punimet e seminareve janë një pjesë integrale e zhvillimit të kursit me ç'rast studentët realizojnë punë të pavarura individuale dhe grupore. Punimet e seminarit shfrytëzohen nga studentët edhe për ta përsosur përdorimin e aparaturës dhe metodologjisë së punës shkencore. Studentët po ashtu kanë dispozicion orët e konsultimeve në zyrë me mësimdhënësin e lëndës.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi intermediar: 20%

	Puna në terren: 10% Detyrat dhe seminarët: 10% Vijimi i rregullt: 10% Provimi final: 50% Total: 100%
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gramatika e gjuhës shqipe 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2002</li> </ul>
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, EDFa, Tiranë, 2004</li> <li>Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe (për mësimdhënësit e gjuhës shqipe) Prishtinë,</li> <li>Ali Jashari, Flutura Çitaku, Morfologjia e zbatuar, Zero Print, Prishtinë, 2014</li> <li>Vepra letrare, fragmentet e të cilave do të përdoren për ushtrime</li> </ul>

<b>Hartimi i planit mësimor</b>	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Njohuri të përgjithshme për morfologjinë dhe objektin e studimit
Java 2:	Struktura morfologjike e fjalës. Identifikimi i morfemave, temat e fjalës dhe tipat e fjalëve (struktura dhe fjalëformimi)
Java 3:	Mënyrat dhe tipat e fjalëformimit. Emri-njohuritë themelore, kategoritë gramatikore dhe grupet leksikore. Formimi i emrave. Kategoritë gramatikore të emrave. Tipat e lakimit.
Java 4:	Mbiemri- njohuri të përgjithshme, kategoritë gramatikore, Kategoria e shkallës të mbiemrat, Emërzimi i mbiemrit dhe formimi i mbiemrave. Lakimi i mbiemrit.
Java 5:	Numërori. Njohuritë e përgjithshme. Veçoritë strukturore e morfologjike të numërorëve themelore. Thyesat.
Java 6:	Përemri, njohuri të përgjithshme, klasifikimi. Përemrat vetorë, trajtat e

	shkurtra, vetvetorët dhe dëftorët. Lakimi i përemrave vetorë.
Java 7:	Përemrat pronorë, llojet dhe emërimi i tyre. Përemrat lidhorë dhe përemrat e pacaktuar.
Java 8:	Folja- njohuri të përgjithshme, klasifikimi i foljeve. Klasifikimi i foljeve në zgjedhime
Java 9:	Foljet e parregullta. Format gramatikore të mënyrës dëftore
Java 10:	Format gramatikore të habitores, lidhores dhe kushtores
Java 11:	Format gramatikore të dëshirores dhe urdhërores
Java 12:	Format e pashtjelluara të foljeve
Java 13:	Ndajfolja, njohuri të përgjithshme. Shkallët e ndajfoljeve dhe formimi i ndajfoljeve
Java 14:	Parafjala. Pjesëza
Java 15:	Lidhëzat, klasifikimi morfologjik dhe ai sintaksor. Pashirrma dhe onomatopeja.

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar të respektojnë normat themelore të sjelljes gjatë kohës së ligjëratave dhe ushtrimeve. Gjatë ushtrimeve studentët janë të obliguar të marrin pjesë aktive në mësim interaktiv. Atyre u mundësohet edhe prezantimi individual dhe grupor dhe qasja interaktive në mësim. Po ashtu studentët kanë mundësi që të kryejnë seminarët e obligueshme nga kjo lëndë.

## Lënda: MORFOLOGJIA E GJUHËS SË SOTME BALLKANIKE ME PRAKTIKË GJUHËSORE

Informata bazë për lëndën	
Njësia akademike:	Programi i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Morfologjia e gjuhës së sotme ballkanike me praktikë gjuhësore
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti II   Semestri II
Fondi i orëve në javë:	4+4
Kredi ECTS:	7
Koha/Vendi:	
Ligjërues/e i/e lëndës:	
Informata kontakti:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda Morfologji e një gjuhës së sotme ballkanike fokusohet në një sistem shumë të ndërlikuar eptimi të lakimeve dhe zgjedhimeve. Morfologjia e gjuhës së sotme ballkanike është e eptueshme, gjë tipike për gjuhët sllave, dhe ka një paradigmë komplekse për pjesët e ndryshueshme të ligjëratës, të ndryshme për emrat, mbiemrat dhe foljet, si dhe të ndryshueshme brenda secilit prej këtyre tri kategorive.</p> <p>Kjo lëndë synon të japë një përmbledhje të shkurtër të kategorive të ndryshme gramatikore si: gjinia (mashkullore, femërore dhe asnjënjëse), rasa (emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, thirrore, instrumentale dhe vendore), numri (njëjës dhe shumës), veta (e parë, e dytë, e tretë), kohët (p.sh. e tashme, e shkuar, e ardhme), aspekti (progresiv dhe joprogresiv), trajta (e shquar dhe e pashquar), diateza (veprore dhe pësore), mënyra (p.sh. dëftore, urdhërore) dhe shkalla (pohore, krahasore, sipërore).</p> <p>Kjo nëndisiplinë gjuhësore merret me që të gjitha dhjetë pjesët e ligjëratës (emrat, përemrat, mbiemrat, ndajfoljet, numërorët, foljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrmat) dhe nënklasat e tyre. Kjo është një temë me rëndësi thelbësore për të fituar rrjedhshmëri në gjuhët e sotme ballkanike.</p>
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i kësaj lënde është të aftësojë

studentët që t'i kuptojnë dhe njohin strukturat e ndryshme morfologjike, si dhe zbatimin e duhur të tyre në gjuhët e sotme ballkanike, si në të folur ashtu dhe në të shkruar. Përmes ligjëratave dhe ushtrimeve, studentët do të fitojnë njohuri për klasat e fjalëve, klasifikimet specifike brenda secilës prej tyre, si dhe kategoritë e tyre përkatëse gramatikore, si dhe të dinë mirëfilli se si t'i kombinojnë fjalët në fjali. Kjo lëndë zhvillon një bazë të fortë për renditje më fleksibile të fjalëve në fjali, si dhe është bazë për lëndën e më tutjeshme të sintaksës.

Rezultatet e pritura të të nxënit:

Me rastin e përfundimit të kësaj lënde, pritet që studentët të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë konceptet, metodat dhe klasifikimet kryesore që përdoren në morfologji;
- Të renditin pjesët e ligjëratës, t'i shpjegojnë e kategorizojnë ato;
- Të kenë vështrim sistematik mbi mbasesat kryesore të lakimit, të cilat do t'u mundësojnë të përdorin të njëjtën paradigmë me fjalët e reja që mësojnë;
- Të avancojnë njohuritë e tyre për renditjen e fjalëve;
- Të zhvillojnë bazë të fortë për lëndën e sintaksës;
- Të aplikojnë njohuritë teorike si në nivelin verbal ashtu edhe të shkruar të gjuhës;
- Të kuptojnë ngjashmëritë dhe dallimet kryesore midis gjuhës amtare dhe gjuhës së sotme ballkanike për sa i përket morfologjisë, si dhe të shpjegojnë se pse disa aspekte të morfologjisë së gjuhës së sotme ballkanike mund të shkaktojnë probleme tek nxënësit e gjuhës joamtare;
- Të përplotësojnë rrjedhshmërinë dhe saktësinë verbale e të shkruar duke kuptuar e aplikuar kategoritë kryesore gramatikore si: gjinia (mashkullore, femërore dhe asnjënjësore), rasa (emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, thirrrore, instrumentale dhe vendore), numri (njënjës dhe shumës), veta (e parë, e dytë, e tretë), kohët (p.sh. e tashme, e kaluar, e ardhme), aspekti (progresiv dhe joprogresiv), trajta (e shquar dhe e pashquar), diateza (veprore dhe pësore), mënyra

(p.sh. dëftore, urdhërore) dhe shkalla (pohore, krahasore dhe sipërore).

### Ngarkesa e punës së studentëve (e cila duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	4 (45 min)	15	45
Punë praktike	4 (45 min)	15	45
Përgatitja e provimit të ndërmjetëm (kolokium)	7	2	14
Konsultime me ligjëruesin e lëndës	10 min	12	2
Test, punim seminarik	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	13	26
Përgatitja për provimin përfundimtar	5	3	15
Koha e vlerësimit (test, kuiz, provim përfundimtar)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
Gjithsej			176 orë 176:25 = 7 7 ECTS

#### Metodat e mësimdhënies:

Ligjërata; ushtrime gjatë orës duke përdorur materiale të ndryshme; punë praktike me asistent profesor; një punim seminarik për semestër (punë individuale ose grupe, deri në 1000 fjalë) dhe konsultime me mësimdhënës gjatë mbajtjes së lëndës; detyra individuale të shtëpisë; një test të ndërmjetëm (kolokium).

#### Metodat e vlerësimit:

Pragu për kalim të lëndës 60%;

Vijimi i ligjëratave nga studenti 15%;

Detyrat individuale të përfunduara në klasë 10%;

Detyrat individuale të përfunduara në shtëpi 10%;

Vlerësimi nga testet 40%;

Provimi përfundimtar 25%;

Gjithsej: 100%.

#### Literatura bazë:

Një nga librat vijues, sipas mendimit të profesorit; kapitujt mbi morfologjinë:

- Stanojčić, Ž., Popović, Lj. (2011). *Gramatika srpskog jezika za gimnazije i srednje škole* [Gramatika e gjuhës serbe për gjimnaze dhe shkolla të mesme]. Beograd: Zavod za udžbenike [Enti i librit shkollor]
- Piper, P., Klajn, I. (2014). *Normativna gramatika srpskog jezika*

	<p>[Gramatika normative e gjuhës serbe]. Novi Sad: Matica srpska</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mrazović, P., Vukadinović, Z. (1990). <i>Gramatika srpskohrvatskog jezika za strance</i> [Gramatika e gjuhës serbokroate për të huaj]. Novi Sad / Sremski Karlovci: Izdavačka knjižarnica Zorana Stojanovića [Libraria botuese e Zoran Stojanoviqit]</li> <li>- Kurešević, M., Belegišanin-Zakić, D. (2010). <i>Gramatika srpskog jezika za strance: Gramatika e gjuhës serbe për të huajt, me ushtrime dhe zgjidhje</i>. Botimi i 2-të. Beograd: Azbukum</li> <li>- Klajn, I. (2006). <i>Gramatika srpskog jezika za strance</i> [Gramatika e gjuhës serbe për të huaj]. Beograd: Zavod za udžbenike [Enti i librit shkollor].</li> </ul>
Literaturë ndihmëse:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Brown, W., Alt, T. (2004). <i>A Handbook of Bosnian, Serbian, and Croatian</i> [Doracak i boshnjakishtes, serbishtes e kroatishtes]. Qendra Kërkimore për Gjuhët Sllave dhe të Evropës Lindore (SEELRC), Universiteti Duke (faqe 21-49)</li> </ul>

Përmbajtja e lëndës	
Java	Tema e ligjëratis
Java 1:	Përshkrimi i lëndës/literaturës; Prezantimi i temës, detyrimet dhe vlerësimi i studentëve; Informacion mbi objektivat, rezultatet e pritura nga studentët, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi; Pyetjet dhe rekomandimet e studentëve.
Java 2:	Korniza teorike e morfologjisë (diskutim i koncepteve kryesore, si morfemat, mbaresat, eptimi, prejardhja, lakimi, zgjedhimi), Hyrje në kategoritë gramatikore: gjinia (mashkullore, femërore dhe asnjëse), rasa (emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, thirrore, instrumentale dhe vendore), numri (njëjës dhe shumëjës), veta (e parë, e dytë, e tretë), kohët (p.sh. e tashme, e kaluar, e ardhme), trajta (e shquar dhe e pashquar), diateza (veprore dhe pësore), mënyra (p.sh. dëftore, urdhërore) dhe shkalla (pohore, krahasore dhe sipërore).
Java 3:	Klasifikimet e lakimit të emrave; forma emërore dhe thirrore; krahasimi kontrastues i emrit me gjuhën amtare të studentit; gjinia e emrave
Java 4:	Emri: rasa gjinore dhe kallëzore
Java 5:	Emri: rasa dhanore dhe vendore; rasa instrumentale; Shqyrtimi i gjitha rasave të grupeve të emrave
Java 6:	Përemri: lakimi i përemrave vetorë, dëftorë, pronorë dhe të tjerë

Java 7:	Parafjalët – klasifikimi, semantika, krahasimi me gjuhën amtare të studentit
Java 8:	Test 1
Java 9:	Foljet ndihmëse dhe modale;
Java 10:	Folja: klasifikimi; lloje të ndryshme të klasifikimeve dhe teorive baza paskajore dhe e tashme e foljeve; pjesorja L dhe pjesorja pësore
Java 11:	Foljet: kohët
Java 12:	Hyrje në foljet e kryera, të pakryera dhe të tejshkuara; rishikimi i foljeve
Java 13:	Ndajfoljet (krahasimi dhe formimi),
Java 14:	Parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrmat; lloje të tjera fjalësh jo lakore
Java 15:	Testi 2

#### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Përdorimi i telefonave mobilë nuk lejohet gjatë ligjëratave, si dhe për arsyen që vijimësia në ligjërata ndikon në notën përfundimtare të studentit, studentët nuk mund të hyjnë e të dalin nga klasa kur të duan. Studentët inkurajohen të diskutojnë çështje të ndryshme që lidhen me njësinë e kryer, pa ofenduar ose diskriminuar njëri-tjetrin dhe duke respektuar mendimin e tjetrit. Studentët do t'i nënshtrohen një testi të ndërmjetëm dhe një testi përfundimtar.

## Titulli i lëndës: NORMË E GJUHËS AMTARE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Normë e gjuhës amtare
Niveli:	BA (Baçelor)
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I   Semestri I
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	7 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa   Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Shpëtim Elezi
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:shpetim.elezi@uni-pr.edu">shpetim.elezi@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Normë e gjuhës amtare ofron bazën e drejtshkrimit të gjuhës standarde shqipe, siç janë parimet dhe rregullat e drejtshkrimit të saj. Ky kurs u ofron studentëve shpjegimet dhe sqarimet e nevojshme teorike lidhur me përvetësimin dhe aplikimin në praktikë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës standarde shqipe. Ligjërimi me shkrim është i nevojshëm për të gjithë për nevoja akademike dhe profesionale, andaj për të shkruar korrekt dhe pa gabime drejtshkrimore është e domosdoshme që të mësohen rregullat drejtshkrimore të shqipes standarde, qofshin ato të natyrës fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore. Kursi përfshin edhe përdorimin korrekt të shenjave të pikësimit.
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs ka për qëllim ngritjen e nivelit dhe kulturës së shkrimit të studentëve në shqipen standarde lidhur me planifikimin dhe hartimin e shkrimit, përdorimin korrekt të normës gjuhësore në të gjitha rrafshet dhe nivelet e gjuhës, si në aspektin drejtshkrimor, fonetik, gramatikor, leksikor, stilistik dhe të shenjave të pikësimit. Po ashtu kursi ka për qëllim që studenti të arrijë të identifikojë, të korrigjojë, të shpjegojë e të zbatojë rregullat drejtshkrimore të shqipes standarde, si dhe të hartojë tekste të ndryshme (ese, seminare, diploma, hulumtime etj.) në përputhje me këto rregulla gjuhësore dhe teknika të shkrimit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon gabimet drejtshkrimore e gjuhësore në tekste;</li> <li>• Shpjegon rregullat drejtshkrimore dhe gjuhësore në përgjithësi;</li> <li>• Zbaton rregullat drejtshkrimore e gjuhësore në shkrime;</li> <li>• Analizon rregullat duke u bazuar në parime të ndryshme të drejtshkrimit;</li> <li>• Rekomandon lidhur me rregullat drejtshkrimore e gjuhësore.</li> </ul>

- Harton tekste në përputhje me rregullat gjuhësore dhe me teknikat e të shkruarit;

### Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjërata	2 (45 min)	15	22.5
Ushtrime	2 (45 min)	15	22.5
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	15	3.45
Testi, punimi i seminarit	10	2	20
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja për provimin final	10	2	30
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet etj.	2	2	4
<b>Totali</b>			181.45 orë 181.45:25=7.25 7 ECTS

**Metodat e mësimdhënies:** Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrimeve që ofrojnë bazën praktike në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi. Mësimdhënia gjatë ligjëratave do të jetë e organizuar nëpërmjet një diskutimi interaktiv për tema të caktuara. Gjatë ushtrimeve mësimdhënia është e orientuar nga studentët, ndërsa mësimdhënësi e kontrollon rrjedhën e orës dhe të shpjegimit të koncepteve të diskutueshme dhe të paqarta. Studentët kanë punime seminari e punime me shkrim të kryera në mënyrë të pavarur e individuale, por bëjnë edhe punë në çifte e në grupe, shkrime tekstesh e hulumtime, si dhe përmes projekteve e prezantimeve, duke nxitur debate e diskutime.

**Metodat e vlerësimit:** Kufiri i kalueshmërisë është 61%.  
 - Vijueshmëria (L + U) 5%  
 - Angazhimi (L + U) 5%  
 - Detyrat individuale në klasë dhe në shtëpi (U) 10%  
 - Prezantimi 10%  
 - Seminari 10%  
 - Testi I semestral (kolokuiumi I) 30%  
 - Testi II semestral (kolokuiumi II) 30%  
 Total 100%: 61-68% (nota 6), 69-76 (7), 77-84 (8), 85-93 (9), 94-100 (10).

**Literatura primare:**

1. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH, 1973.
2. Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH, 1976.
3. Rregullat e pikësisimit në gjuhën shqipe. Tiranë: ASHSH, 2002.

**Literatura shtesë:**

1. Rami Memushaj, Shqipja standarde, Tiranë: Toena, 2004.
2. Isa Bajçinca, Shqipja standarde dhe probleme rreth saj. Prishtinë, 2016.
3. Gjovalin Shkurtaç, Kultura e gjuhës, Tiranë, 2006.
4. Bardh Rugova, Ideologjia e gabimit gjuhësor, Prishtinë: ASHAK, 2021.
5. Fadil Sulejmani, Praktikum i gjuhës shqipe, Prishtinë, 1981
6. Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë: ASHSH, 2006. Në: [www.fjalorthi.com](http://www.fjalorthi.com)
7. Gramatika e gjuhës shqipe, 1, 2, Tiranë: ASHSH, 2002.
8. Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH, 1973.
9. Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (Projekt). Prishtinë: UP, 1967.
10. Umberto Eco, Si bëhet një punim diplome. Tiranë: botime përpjekja, 1997.
11. Zijadin Munishi, Zgjedhimi i foljeve, Prishtinë: Artini, 2013.

12. A. Dhrimo, R. Memushaj, Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë: Infobotues, 2011.
13. Gjovalin Shkurtaç, Si të shkruajmë shqip? Tiranë: Toena, 2008.
14. Kristina Jorgaqi, Sportel i hapur i shqipes, Tiranë: Ombra GVG, 2008.
15. Rexhep Ismajli, Gjuhë standarde dhe histori identitetesh, Tiranë: ASHSH, 2005.
16. Rexhep Ismajli, Drejtshkrimet e shqipes, Prishtinë: ASHAK, 2005.
17. Shpëtim Elezi, Përdorimi i shqipes standarde nga mësimdhënësit e ciklit fillor. Në "Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 34/1, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2015.
18. Shpëtim Elezi, Çështja e shumësit me -nj, -inj, -enj në sistemin emëror të shqipes standarde. Në "Albanologji", nr. 2, IAP, Prishtinë, 2012.
19. Gjuha jonë (revistë e botuar nga IGJL në Tiranë).
20. Gjuha shqipe (revistë e botuar nga IA në Prishtinë).
21. Gjuha letrare për të gjithë, Tiranë, 1976.
22. Propozime për drejtshkrimin (1976-2014), I, II. Shkup, 2022.

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Procesi i të shkruarit; Planifikimi i shkrimit; Teksti; Paragrafi; Citimet dhe shënimet; Redaktimi dhe korrektimi
Java 2:	Historia e shkrimit; Historia shqipes standarde; Gjuha standarde shqipe; Nocionet <i>gjuhë standarde – gjuhë letrare</i> ; Veçoritë e shqipes standarde; Parimet dhe rregullat e drejtshkrimit të shqipes standarde dhe zbatimi i tyre
Java 3:	Gjuha standarde dhe dialektet; Faktorë gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë me ndikim në përvetësimin dhe zbatimin e normës së shqipes së shkruar
Java 4:	Emri: gjinia, trajta, rasa dhe shumësi i emrave
Java 5:	Përemrat dhe përdorimi i tyre
Java 6:	Folja dhe shkrimi i formave foljore
Java 7:	Çështje sintaksore: Rendi dhe përshtatja e gjymtyrëve në fjali; Kalket sintaksore ( <i>KOLOKUIUMI 1</i> )
Java 8:	Drejtshkrimi i zanoreve, Grupe dhe takime zanoresh
Java 9:	Drejtshkrimi i zanores ë: e theksuar, e patheksuar (paratheksore, pastheksore: jofundore e fundore)
Java 10:	Shkrimi i bashkëtingëlloreve; Grupe dhe takime bashkëtingëlloresh
Java 11:	Përdorimi i shkronjës së madhe
Java 12:	Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes
Java 13:	Përdorimi dhe drejtshkrimi i nyjave të përparme, i pjesëzave dhe i parafjalëve të përsëritura
Java 14:	Shenjat e pikësimit; Apostrofi; Shkrimi i datave ( <i>KOLOKUIUMI 2</i> )
Java 15:	Përdorimi i leksikut ( <i>PREZANTIMET</i> )

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme në përputhje me masave disiplinore që parashihen në rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimdhënësit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.



## Lënda: PËRKTHIM GJUHË AMTARE – GJUHË E SOTME BALLKANIKE

Informata bazë për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Përkthim gjuhë amtare – gjuhë e sotme ballkanike
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti IV   Semestri VIII
Fondi i orëve në javë:	2+4
Kredi ECTS:	7
Koha/Vendi:	
Ligjërues/e i/e lëndës:	
Informata kontakti:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë ndërthurë teorinë dhe praktikën e përkthimit përmes përdorimit të një game metodologjish për shfrytëzimin dhe menaxhimin e burimeve gjuhësore për qëllime të përkthimit dhe interpretimit nga gjuha shqipe në gjuhë e sotme ballkanike. Lënda përfshin aspekte të ndryshme të përkthimit dhe interpretimit në praktikë, në mënyrë që t'i njohë më tej studentët me përkthimin dhe interpretimin në këtë drejtim gjuhësor të veçantë. Përveç zhanreve letrare si esetë, proza, poezia, drama, dëshmitë dhe letërsia për fëmijë e librat komikë, studentët do të zhvillojnë aftësi që lidhen me përkthimin dhe interpretimin joletrar në fushat akademike, shkencore, administrative dhe fusha tjera teknike. Duke përkthyer tekste të caktuara dhe duke i rishikuar ato në klasë, studentët do të mësojnë se si të identifikojnë dhe përdorin me sukses qasjet dhe teknikat e ndryshme të përkthimit. Në shërbim të këtij qëllimi, në këtë lëndë do të përdoren tekste me burim nga jeta reale dhe burime me audio/video përmbajtje, në mënyrë që studentëve t'u ofrohet një pasqyrë e materialeve të ndryshme me të cilat përballen përkthyesit profesionistë si dhe të mjeteve teknologjike dhe burimeve në internet që përdoren në këtë fushë. Rishikimet e përjavshme përqendrohen në një</p>

larmi aspektesh në lidhje me terminologjinë, me theks në konceptin e ekuivalencës dhe përkthimit të idiomave, zhargonit, gjuhës figurative dhe aspekteve gramatikore (veçanërisht në rastet kur ka përputhshmëri të kufizuar ose zero midis gjuhës shqipe dhe gjuhë e sotme ballkanike). Për më tepër, studentët do të njihen mirë me llojet e interpretimit në konferenca dhe gjykatë ndërsa adresojnë temat e kualifikimeve dhe aftësive të interpretit (mbajtja e shënimeve, ndërtimi i kujtesës etj.), përgjegjësinë profesionale dhe komunikimin ndërkulturor të rëndësishëm për interpretimin nga shqipja në gjuhë e sotme ballkanike. Për më tepër, studentët do të mësojnë si të përkthejnë saktë nga gegërishtja, veçanërisht në kuptimin e njohjes së nuancave semantike dhe frazeologjisë specifike ose thekseve dhe shqiptimeve të ndryshme në mënyrë që t'i përmirësojnë jo vetëm shkathtësitë gjuhësore por edhe të fitojnë kompetencën e nevojshme për komunikimin ndërkulturor.

#### Qëllimet e lëndës:

David Morley, The Cambridge Introduction to Creative Writing, Cambridge University Press, 2007.  
Umberto Eco, Si shkruhet një punim diplome, Dituria, 2006, Tiranë.  
Cristopher Tribble, Writing, Oxford University Press, Oxford, 1996  
Agron Gashi: Shkrimi kreativ, Material në dorëshkrim.

**Literatura shtesë:**

- Thomas S. Kane, Si të shkruajmë shqip?, CDE, Tiranë, 2010
- Rexhep Qosja, Tri mënyra të të shkruarit shqip

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje në shkrimin kreativ
Java 2:	Leximi dhe shkrimtari vetanak
Java 3:	Shkrimi kreativ dhe kritika kreative
Java 4:	Përvoja dhe imagjinata
Java 5:	Shkrimi kreativ i çastit
Java 6:	Sfidat e shkrimit kreativ
Java 7:	Ndikimi dhe imitimi
Java 8:	Fletorja e shkrimtarit: disiplina
Java 9:	Proceset e shkrimit kreativ
Java 10:	Shkrimi kreativ letrar

Java 11:	Ndërtimi i personazhit dhe i botës
Java 12:	Të shkruarit e poezisë
Java 13:	Uni i shkrimtarit
Java 14:	Këndvështrimi
Java 15:	Shkrimi kreativ joletrar

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimdhënësit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.

## Titulli i lëndës: SINTAKSË E GJUHËS AMTARE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Sintaksë e gjuhës amtare
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II, sem.IV
Numri i orëve në javë:	2+4
Kreditë ECTS:	7
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.ass.dr. Bahri Koskoviku
Të dhënat kontaktuese:	bahri.koskoviku@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda <i>Sintaksë e gjuhës amtare</i> trajton strukturën gramatikore të shqipes, tipat e fjalive sipas kuptimit dhe strukturës; strukturën hierarkike të fjalisë: përbërësit e fjalisë së thjeshtë (GE kryefjalë, GF i kallëzuesit), përbërësit e grupit emëror (përcaktorët) dhe të grupit foljor (kundrinorët), funksionet e tyre semantike e gramatikore brenda grupit të fjalëve (kryefjalë, kallëzues, komplement, adjunkt); tipat e marrëdhënieve sintaksore, mënyrat dhe mjetet e shprehjes së raporteve sintaksore në fjali. Funksionet gramatikore të përbërësve sintaksorë në fjali. Fjalitë e përbëra me bashkërenditje, fjalitë e përbëra me nënrenditje dhe tipin e fjalive të përbëra jolidhëzore, ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë.
Qëllimet e lëndës:	Ky modul ka për qëllim t'u ofrojë njohuri të përgjithshme studentëve për strukturën sintaksore të shqipes, për tipat e fjalive, për përbërësit bazë të fjalisë

së thjeshtë dhe funksionet e tyre semantike dhe gramatikore, për përbërësit e grupit emëror (përcaktorët) dhe përbërësit e grupit foljor (kundrinorët) duke vazhduar me rrethorët si njësi sintaksore që ndërtojnë lidhje sintaksore me fjalinë, me veçoritë e ndërtimit të fjalisë dhe disa specifika karakteristike për shqipen (rendi i përbërësve, mungesa e kryefjalës etj.) dhe fjalitë eliptike. Në kuadër të analizës gramatikore të fjalisë përfshihen edhe konceptet: gramatikalitet e jogramatikalitet, koncepti i sintagmës, struktura argumentore e foljes, konceptimi i fjalisë si hierarki strukturore etj. Në vijim ofrohen njohuri edhe për fjalinë e përbërë dhe tipat e marrëdhënieve sintaksore (raportet bashkërenditëse, nënrenditëse dhe asidentike).

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti:

- Identifikon tipat e ndryshëm të fjalive dhe përbërësit sintaksorë të fjalisë së thjeshtë
- kupton funksionin gramatikor dhe semantik të përbërësve sintaksorë
- dallon disa specifika karakteristike për shqipen
- Vlerëson gramatikalitetin e fjalisë

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	4	15	60
Punë praktike	-	-	-

Përgatitje për test intermediar	6	2	12
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	15	5
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	7		7
Detyrë shtëpie,	15		15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	12		12
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2		2
Projektet, prezantimet, etj.	2		2
<b>Totali</b>			175 orë 175: 25 = 7 7 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, punë me shkrim, debate etj.
Metodat e vlerësimit:	Kalueshmëria 51% Vlerësimi i testit intermediar: 30% Detyrat e shtëpisë dhe seminarët: 10% Vijimi i rregullt dhe angazhimi: 10% Provimi final: 50% Total: 100%
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mehmet Celiku, Sintaksë e gjuhës shqipe, Tiranë 2012</li> <li>• Thoma Dhima, Gjuha Shqipe – Sintaksa, Tiranë 2005</li> <li>• Gramatika e gjuhës shqipe 2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2002</li> </ul>
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• John Lyons, Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme</li> <li>• Menella Totoni, Fraza me nënrenditje, Tiranë 2000</li> <li>• Radford, A. (1997). Syntax. A minimalist introduction. The MIT Press Cambridge Massachusetts. England.</li> <li>• Kelmendi T., Studime sintaksore, Prishtinë, 2008.</li> </ul>

- Rugova.S, L & Rugova, B. (2012). Sintagmat parafjalore të shqipes. (Konferencë shkencore kushtuar 100- vjetorit të lindjes së Agna Desnickajës). Shën Petërburg. Rusi.
- Graffi, G. (2003). *Sintaksa. Tiranë. SHB Dituria.*

## Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Njohuri të përgjithshme për sintaksën.
Java 2:	Njohuri të përgjithshme për fjalinë: tipat e fjalive sipas kuptimit dhe strukturës
Java 3:	Struktura e fjalisë: përbërësit e fjalisë së thjeshtë. Funkcionet gramatikore dhe semantike të përbërësve të fjalisë.
Java 4:	Struktura hierarkike e fjalisë
Java 5:	Përbërësit bazë të fjalisë së thjeshtë: Grupi emëror-kryefjalë dhe Grupi foljor (Predikati)
Java 6:	Përbërësit e grupit emëror (GE) (përcaktorët) dhe determinerët (fjalët përcaktuese)
Java 7:	Përbërësit e grupit foljor: kundrinori i drejtë dhe kundrinori i zhdrejtë
Java 8:	Rrethanorët
Java 9:	Disa specifika të ndërtimit të fjalisë në gjuhën shqipe. Fjalitë eliptike.
Java 10:	Fjalja e përbërë: Marrëdhëniet bashkërenditëse, marrëdhëniet nënrenditëse dhe jolidhëzore.
Java 11:	Fjalja e përbërë me marrëdhënie bashkërenditëse.
Java 12:	Fjalja e përbërë me marrëdhënie nënrenditëse: fjalitë e varura filluese, fjalitë e varura përcaktore dhe fjalitë lidhore

Java 13:	Fjalja e përbërë me nënrenditje: fjalitë rrethore
Java 14:	Pozicioni i fjalisë së varur (klauzës) në fjalinë e përbërë. Test 2
Java 15:	Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë.

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë me rregull ligjëratat. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimdhënësit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.

## Lënda: SINTAKSË E GJUHËS SË SOTME BALLKANIKE ME PRAKTIK GJUHËSORE

Informata bazë për lëndën	
Njësia akademike:	Programi i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Sintaksë e gjuhës së sotme ballkanike me praktik gjuhësore (C1)
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimit:	Viti II   Semestri IV
Fondi i orëve në javë:	4 +4
Kredi ECTS:	7
Koha/vendi:	
Ligjërues/e i/e lëndës:	
Informata kontakti:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë paraqet një hyrje në bazat e sintaksës së gjuhës së sotme Ballkanike bazuar në modelin strukturalist. Ajo trajton fjalët dhe strukturat sintaksore më komplekse sesa fjalët - togfjalëshin, fjalinë dhe periudhën. Studentët do të kuptojnë modelin strukturor të llojeve më të zakonshme të togfjalëshave dhe periudhave, si të atyre me bashkërenditje ashtu dhe me nënrenditje, në mënyrë që të mësojnë si të flasin/shkruajnë fjali më të ndërlikuara dhe më të gjata, por gramatikisht të sakta. Pjesa tjetër e lëndës përqendrohet në funksionin sintaksor të fjalëve, togfjalëshave dhe pjesëve të varura në fjali dhe shërbehet me funksione të kryefjalës, kallëzuesit, kundrinorit të drejtë dhe të zhdrejtë e të rrethanorëve. Një nga temat e përfshira nga kjo lëndë është vendosja enklitike në fjali, por kjo çështje do të mësohet në mënyrë implicite gjatë gjithë lëndës.</p> <p>Njohuritë e mëparshme mbi morfologjinë e gjuhës së sotme Ballkanike do të avancohen përmes mësimit të kuptimit morfologjiko-sintaksor të rasave të veçanta përmes studimit të frazave të ndryshme parafjalore, kundrinorit të drejtë/të zhdrejtë dhe rrethanorëve. Studentët po ashtu do të krahasojnë strukturën morfologjiko-sintaksore të gjuhës së tyre amtare me strukturën e gjuhës së sotme Ballkanike, për t'i kuptuar bazat teorike të sintaksës dhe të jenë në gjendje të analizojnë dhe përdorin struktura më</p>

	komplekse në të folur /shkruar, duke avancuar kështu kompetencat gjuhësore.
Qëllimet e lëndës:	Objektivat kryesore të kësaj lënde janë njohja me terminologjinë e përdorur në sintaksë dhe hartimi i kuadrit të përshtatshëm teorik të nevojshëm për analizimin dhe krijimin e strukturave si fraza, periudha dhe fjalia. Studentët duhet të mësojnë si të formojnë struktura më të gjata, më komplekse sintaksore, gramatikusht të sakta, si dhe të kuptojnë formimin e tyre, të jenë në gjendje t'i analizojnë ato dhe të përvetësojnë modelet e tyre, që të mund t'i përdorin ato në të folur /shkruar. Një nga synimet është përvetësimi i aftësive të kërkuara për përkthim dhe zhvillimi i renditjes së fjalëve të folësit amtar.
Rezultatet e pritura të të nxënit:	<p>Me rastin e përfundimit të kësaj lënde, pritet që studentët të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Të kuptojnë konceptet kryesore, metodat dhe klasifikimet e përdorura në sintaksë;</li> <li>- Të kuptojnë ngjashmëritë dhe dallimet kryesore midis gjuhës amtare dhe gjuhës së sotme Ballkanike për sa i përket sintaksës dhe të shpjegojnë pse disa aspekte të sintaksës të gjuhës së sotme Ballkanike mund të shkaktojnë probleme tek nxënësit e gjuhës së dytë;</li> <li>-Të përvetësojnë renditje të gjymtyrëve në fjali si të një folësi amtar.</li> <li>-Të shpjegojnë se si formohen lloje të ndryshme të togfjalëshave, periudhave dhe fjalive;</li> <li>-Të shpjegojnë se cili është funksioni sintaksor i fjalëve, togfjalëshave, periudhave dhe fjalive;</li> <li>-Të kuptojnë domethënien morfologjiko-sintaksore të rasave të ndryshme;</li> <li>-Të bëjnë analiza sintaksore të fjalive;</li> <li>-Të përdorin struktura sintaksore më komplekse në të folur/shkruar;</li> <li>- Të formojnë lloje të ndryshme të fjalive të sakta (fjali pohuese dhe pyetëse, urdhra, fjali me pjesë të varur me bashkërenditje ose nënrenditje);</li> </ul>

- Të aplikojnë njohuritë teorike për lloje të ndryshme të kryefjalës, kallëzuesit, kundrinorit dhe rrethanorëve në të folur/të shkruar;

**Ngarkesa e punës së studentëve (e cila duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	4 (45 min)	15	45
Punë praktike	4 (45 min)	15	45
Përgatitja e provimit të ndërmjetëm (kolokium)	7	2	14
Konsultime me ligjëruesin e lëndës	10 min	12	2
Test, punim seminarik	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	13	26
Përgatitja për provimin përfundimtar	5	3	15
Koha e vlerësimit (test, kuiz, provim përfundimtar)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
<b>Gjithsej</b>			176 orë 176:25 = 7 7 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata teorike; ushtrime në klasë duke përdorur materiale të ndryshme; ligjërata praktike me asistentë me rishikimin e kuadrit teorik dhe ushtrime të ndryshme interaktive (formimi i strukturave të ndryshme, analiza e fjalive, ngushtimi/zgjerimi i strukturave sintaksore, ushtrime të renditjes së fjalëve, ushtrimet e vendosjes klitike); një test semestral; detyra individuale të shtëpisë, studim vetanak.
Metodat e vlerësimit:	Pragu për kalimin e lëndës është 60%;  Vijimi i ligjëratave nga studenti 15%; Detyrat individuale të përfunduara në klasë 10%; Detyrat individuale të përfunduara në shtëpi 20%; Vlerësimi nga testet 35%; Provimi përfundimtar 20%; Gjithsej: 100%
Literatura bazë:	Një nga librat vijues, sipas mendimit të profesorit; kapitujt mbi sintaksën: - Stanojčić, Ž., Popović, Lj. (2011). <i>Gramatika srpskog jezika za gimnazije i srednje škole</i> [Gramatika e gjuhës serbe për gjimnaze dhe shkolla të mesme]. Beograd: Zavod za udžbenike [Enti i librit

	<p>shkollor]</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Piper, P., Klajn, I. (2014). <i>Normativna gramatika srpskog jezika</i>. [Gramatika normative e gjuhës serbe]. Novi Sad: Matica srpska</li> <li>- Mrazović, P., Vukadinović, Z. (1990). <i>Gramatika srpskohrvatskog jezika za strance</i> [Gramatika e gjuhës serbokroate për të huaj]. Novi Sad / Sremski Karlovci: Izdavačka knjižarnica Zorana Stojanovića [Libraria botuese e Zoran Stojanoviçit]</li> <li>- Kurešević, M., Belegišanin-Zakić, D. (2010). <i>Gramatika srpskog jezika za strance: Gramatika e gjuhës serbe për të huaj, me ushtrime dhe zgjidhje</i>. Botimi i dytë. Beograd: Azbukum</li> <li>- Klajn, I. (2006). <i>Gramatika srpskog jezika za strance</i> [Gramatika e gjuhës serbe për të huaj]. Beograd: Zavod za udžbenike [Enti i librit shkollor].</li> </ul>
Literaturë ndihmëse:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Brown, W., Alt, T. (2004). <i>Doracak i boshnjakishtes, serbishtes dhe kroatishtes</i>. Qendra hulumtuese për gjuhët sllave dhe ato të Evropës Lindore (SEELRC), Universiteti Duke (faqe 53-73)</li> </ul>

Përmbajtja e lëndës	
Java	Tema e ligjëratis
Java 1:	Përshkrimi i lëndës/literaturës; Prezantimi i temës, detyrimet dhe vlerësimi i studentëve; Informacion mbi objektivat, rezultatet e pritura nga studentët, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi; Pyetjet dhe rekomandimet e studentëve.
Java 2:	Hyrje në terminologjinë bazë dhe përcaktimi i sintaksës si disiplinë gjuhësore; Përcaktimi i koncepteve kryesore sintaksore (fjala, togfjalëshi, fjalia, periodha; kryefjala, kallëzuesi, kundrina, ndajfoljet)
Java 3:	Tipologjia e kryefjalëve dhe kallëzuesve (kryefjala gramatikore dhe logjike; kallëzuesi i thjeshtë/përbërë, foljor/këpujor) Kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë; kuptimi sintaksor i rasës dhanore dhe kallëzore
Java 4:	Ndajfoljori i strukturuar si një fjalë, frazë dhe togfjalësh; zgjerimi dhe ngushtimi i strukturave ndajfoljore; kuptimi sintaksor i rasës gjinore, instrumentale dhe vendore
Java 5:	Zgjerimi/ngushtimi i kryefjalës, kallëzuesit, kundrinorit dhe rrethanorëve; radhitja e fjalëve; rishikim
Java 6:	Vendosja klitike enklitike
Java 7:	Fjalitë me bashkërenditje; lidhëzat <i>i</i> , <i>ni</i> , <i>ali</i> ; radhitja e fjalëve; vendosja klitike Fjalitë me bashkërenditje; lidhëzat <i>osim</i> , <i>ili</i> ; radhitja e fjalëve; vendosja klitike;

	rishikim
Java 8:	Testi 1
Java 9:	Informata të shkurtra për renditjen e fjalëve në fjalitë pohuese, pyetëse dhe urdhërore; rishikim; ligjërata e zhdrejtë; krahasim i strukturave me ato të përdorura në gjuhën amtare të studentit
Java 10:	Fjalitë me nënrenditje: fjalitë kushtore me <i>nëse</i> ; renditja e gjymtyrëve në fjali; përdorimi i kohëve në kuptimin e tyre të transponuar
Java e 11	Fjalitë me nënrenditje: fjalitë e varura kohore; lidhëzat <i>dok, kad</i> ; renditja e gjymtyrëve në fjali; përdorimi i kohëve të ndryshme
Java e 12.	Fjalitë me nënrenditje: fjalitë e varura vendore; lidhëzat <i>gde</i> ; renditja e gjymtyrëve në fjali; përdorimi i kohëve të ndryshme
Java e 13	Fjalitë me nënrenditje: fjalitë e varura shkakore; lidhëza <i>jer</i> ; renditja e gjymtyrëve në fjali; përdorimi i kohëve të ndryshme
Java e 14	Fjalitë me nënrenditje: fjalitë e varura kundrinore; përsëritje
Java e 15	Testi 2

### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Përdorimi i telefonave mobilë nuk lejohet gjatë ligjëratave, si dhe për arsye që vijimësia në ligjërata ndikon në notën përfundimtare të studentit, studentët nuk mund të hyjnë e të dalin nga klasa kur të duan. Studentët inkurajohen të diskutojnë çështje të ndryshme që lidhen me njësinë e kryer, pa ofenduar ose diskriminuar njëri-tjetrin dhe duke respektuar mendimin e tjetrit. Studentët do t'i nënshtrohen një testi të ndërmjetëm dhe një testi përfundimtar.

## Titulli i lëndës: TEORI DHE PRAKTIKË PËRKTHIMI

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Teori dhe praktikë përkthimi
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i III-të, Semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	2+4
Kreditë ECTS:	7 ECTS
Koha / Vendi:	Departamenti i Ballkanistikës  Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Mimoza Hasani - Pllana
Të dhënat kontaktuese:	mimoza.hasani@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Teoria e përkthimit është disiplinë shkencore që merret me studimin e procesit të përkthimit dhe me produktin e këtij procesi. Fillimisht është trajtuar si pjesë e gjuhësisë, për tu pasuruar me të dhëna gjuhësisë së tekstit. Në dritën e këtyre të dhënave është zhvilluar koncepti i ekuivalencës së formës dhe i përmbajtjes. Koncepti i ekuivalencës lind si rezultat i përpjekjes për t'i gjetur zgjidhje problemit të procesit të përkthimit dhe problemeve të përkthyesit.</p> <p>Përkthimi si veprimtari ka një të kaluar shumë më të vjetër se teoria e përkthimit. Në pjesën e ushtrimeve, me shembuj konkret të përkthimit ndërmjet çifteve gjuhësore, do të trajtohen aspektet e ekuivalencës së: nivelit të fjalës, përtej nivelit të fjalës, gramatikore, tekstuale, pragmatike dhe semiotike.</p>
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka për qëllim të trajtoj procesin e zhvillimit të teorisë së përkthimit në kuadër të teorive të gjuhësisë dhe të shqyrtoj shfaqjen e ekuivalencës së formës dhe të kuptimit, si rezultat i zhvillimit të gjuhësisë dhe i gjuhësisë së tekstit. Pjesa e ushtrimeve ka për qëllim që

Rezultatet e pritura të të nxënit:

përmes shembujve konkret të sugjeroj zgjidhje të pranueshme për problemet me të cilat ballafaqohet përkthyesi, në situata konkrete të përkthimit të teksteve të zhanreve dhe të përmbajtjeve të ndryshme.

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:

- të familjarizohet me nocionet lidhur me aspektin teorik dhe praktik të përkthimit;
- të zhvilloj qëndrim kritik për konceptin e ekuivalencës dhe llojeve të ekuivalencës në përkthim;
- të zhvilloj një kulturë të përgjithshme lidhur me etikën e përkthimit si proces dhe produkt;
- të familjarizohet me teknikat dhe strategjitë e përkthimit;
- të zhvilloj një kulturë të përgjithshme për mjetet dhe burimet që lidhen me procesin dhe produktin e përkthimit;
- të bëjë ushtrime konkrete përkthimi të teksteve të zhanreve dhe përmbajtjeve të ndryshme;
- të bëjë analizë dhe kritikë të përkthimit.

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Teori/Punë në laborator/Ushtime	4	15	45
Punë praktike	2	10	20
Përgatitje për test intermediar	5	2	10
Konsultime me mësimdhënësin	10 min.	12	2
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	4	8
Detyrë shtëpie	1	10	10

Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja për provimin final	5	3	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	4	2	8
<b>Total</b>			<b>75 hours</b> <b>174,5:25=6,98</b> <b>7 ECTS</b>

<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Ligjërata; Ushtrime; Punime seminarike; Diskutime në grupe (studentët ndahen në grupe diskutimi për të: analizuar dhe përkthyer tekstet; zhvilluar pyetje dhe diskutime specifike në lidhje me tekstin e përkthyer; zhvilluar debata me gjuhë argumentuese).
--------------------------------	---

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Pjesëmarrje në ligjërata 10 % Pjesëmarrje aktive në ligjërata 10 % Testi semestral 10 % Seminar 15% Provimi përfundimtar 55 %
------------------------------	---

<b>Literatura primare:</b>	Jeremy Munday, <i>Introducing Translation Studies</i> , Routledge, 2016. Peter Fawcett, <i>Translation and Language</i> . St Jerome Publishing, 2003 Mona Baker, <i>In other word: A Coursebook on Translation</i> , Routledge, 2018. Erich Prunc, <i>Hyrje në Shkencën e Translacionit</i> , Papyrus, Prishtinë, 2005
----------------------------	---

<b>Literatura shtesë:</b>	Shykrane Gërmizaj (2005). <i>Translation Theory in the Classroom</i> , Prishtinë, 2005. Nataša Pavlović, <i>Uvod u teorije prevođenja</i> , Lekyam International, 2015.
---------------------------	--

### **Hartimi i planit mësimor**

<b>Java</b>	<b>Titulli i ligjërates</b>
Java 1:	Konceptet themelore të përkthimit. Historiku i përkthimit

Java 2:	Gjuha dhe përkthimi, llojet e përkthimit
Java 3:	Gjuha dhe përkthimi si mjet komunikimi
Java 4:	Funksioni gjuhësor i përkthimit, llojet/zhanret e tekstit
Java 5:	Zhanret kryesore të tekstit, zhanret e tekstit në pikëpamje të teorive të përkthimit
Java 6:	Tekstet letrare dhe përkthimi letrar
Java 7:	Ekuivalenca dhe përputhshmëria
Java 8:	Strategjitë e përkthimit
Java 9:	Tekstet profesionale dhe terminologjia e teksteve teknike dhe juridike
Java 10:	Fushat në të cilat gjen zbatim përkthimi në Kosovë dhe legjislacioni për përkthyes dhe interpretë
Java 11:	Mjetet, burimet dhe softuerët e përkthimit
Java 12:	Gjuhët ballkanike dhe gjuhët botërore në të cilat zhvillohet veprimtaria përkthyes në Ballkanin perëndimorë
Java 13:	Analizë dhe kritikë përkthimi
Java 14:	Idiomatika, frazeologjia dhe ekuivalenca
Java 15:	Disa norma dhe standarde ndërkombëtare për përkthim simultan dhe konsektiv

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Vijueshmëri e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve që u ofrohen studentëve. Respektimi i rregullave profesionale dhe parimeve etike gjatë studimit.

Mjetet e komunikimit, gjatë orës mësimore nuk duhet të përdorën për qëllime që nuk përkasin me qëllimet e lëndës. Ndërsa mjetet e njëjta mund të përdorën për realizimin e lëndës mësimore, por duke mos e cenuar privatësinë e askujt në sallën e mësimi.

### **Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:**

<b>Pjesa teorike</b>	<b>Pjesa praktike</b>
50%	50 %

## Titulli i lëndës: TEORI TË MËSIMDHËNIES

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Teori të mësimdhënies
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti IV, Sem. VII
Numri i orëve në javë:	2+0
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Departamenti i Ballkanistikës   Sipas orarit
Mësimdhënësi:	
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	Lënda përfshin tema lidhur me: konceptet themelore për modelet, strategjitë, teknikat dhe metodat e mësimdhënies; faktorët që ndikojnë në zhvillimin e cilësisë së mësimdhënies; identifikimi i dallimeve individuale të studentëve/nxënësve; krijimi i aktivitetit mësimdhënës bazuar në dallime individuale; vlerësimi i mjedisit të mësimdhënies sipas kontekstit mësimdhënës.
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka për qëllim që t'i aftësojë studentët për ta kuptuar raportin ndërmjet procesit të nxënies me mësimdhënie, dhe studentëve t'i ofroj njohuri për zbatimin e modeleve, strategjive, metodave dhe teknikave të ndryshme të mësimdhënies në zhvillimin e një programi efektiv mësimor.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:

- të identifikoj lidhjen ndërmjet koncepteve: edukim, arsim, mësimdhënie, nxënie, mësimdhënës;

- të familjarizohet me konceptet model, metodë, teknikë dhe strategji e mësimdhënies;

- të identifikoj lidhjen ndërmjet koncepteve: model, metodë, teknikë dhe strategji e mësimdhënies;

- t'i kuptoj parimet themelore të modeleve kryesore të mësimdhënies;

- të demonstroj dallimet ndërmjet modelet kryesore të mësimdhënies;

- t'i kuptoj parimet themelore të metodave kryesore të mësimdhënies;

- të demonstroj dallimet ndërmjet metodave kryesore të mësimdhënies;

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22,5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			0
Punë praktike			0
Përgatitje për test intermediar	8	2	16

Konsultime me mësimdhënësin	10 min	12	2
Puna në terren			0
Testi, punimi i seminarit			0
Detyrë shtëpie	3	13	39
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	13	39
Përgatitja për provimin final	10	2	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	6	1	6
<b>Total</b>			<b>126:25=5,94 6 ECTS</b>

<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Ligjëratat, prezantimet e përgatitura nga studentët në grupe 2-3 studentësh, detyrë shtëpie individuale.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Kufiri i kalueshmërisë: 50%. Vijueshmëria e studentit 10%; Detyrat individuale të kryera në klasë 0%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 20%; Vlerësimi nga testet 30%; Provimi final 50%.
<b>Literatura primare:</b>	1. Xhavit Rexhaj (2019). Teori dhe strategji të mësimdhënies. Kolegji AAB. 2. Zeki Kaya & Selçuk Akdemir (2016). Learning and Teaching. Çözüm-Ankara. 3. Bardhyl Musai (2014). Metodologji e mësimdhënies. CDE.
<b>Literatura shtesë:</b>	1. David Krit (2018). Constructivist Education in Age of Accountability. Palgrave Macmillan.

<b>Hartimi i planit mësimor</b>	
<b>Java</b>	<b>Titulli i ligjëratës</b>
Java 1:	Rëndësia e njohurisë për modelin, strategjinë, metodën dhe teknikën mësimore në procesin e mësimdhënies
Java 2:	Konceptet themelore të modeleve, strategjive, metodave dhe teknikave të mësimdhënies

Java 3:	Parimet e nevojshme për krijimin e një mjedisi të mësimdhënies efektive
Java 4:	Teoritë kognitive të të nxënit
Java 5:	Modeli konstruktivist i mësimdhënies
Java 6:	Mësimdhënia efektive
Java 7:	Mësimdhënia ndërvepruese
Java 8:	Teoria e të mësuarit social
Java 9:	Teoria e inteligjencave të shumëfishta
Java 10:	Të nxënit bazuar në projekte
Java 11:	Të nxënit bazuar në probleme
Java 12:	Të nxënit bazuar në punën e trurit (Brain based learning)
Java 13:	Të menduarit kritik
Java 14:	Të nxënit të ndihmuar nga TI-ja
Java 15:	Mësimi nga distanca

#### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Materialet mësimore duhet të mirëmbahen. Komunikimi i studentëve me mësimdhënësin duhet të përqendrohet në arritjen e qëllimeve të lëndës. Ky komunikim në sallë të mësimimit ose në kabinetin e mësimdhënësit (gjatë konsultimeve) duhet të jetë transparent dhe në kuadër të mirësjelljes. Po ashtu edhe komunikimi përmes e-mailit apo edhe kanaleve/mjeteve tjera që i mundësin TI-ja, duhet të jetë në funksion të zhvillimit akademik.

Mjetet e komunikimit, gjatë orës mësimore duhet të mos përdorën për qëllime që nuk përkasin me qëllimet e lëndës. Ndërsa mjetet e njëjta mund të përdorën për realizimin e lëndës mësimore, por duke mos e cenuar privatësinë e askujt në sallën e mësimimit.

## Titulli i lëndës: VARIETETET E GJUHËS AMTARE (DIALEKTOLOGJI E SOCIOLINGUISTIKË)

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Varietetet e gjuhës amtare (dialektologji e sociolinguistikë)
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti IV   Semestri VII
Numri i orëve në javë:	4+2
Kreditë ECTS:	7
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kjo lëndë përqendrohet në studimin e dukurive gjuhësore në kuadrin shoqëror. Duke u mbështetur në sociolinguistikën si disiplinë do të njoftohen me konceptet dhe teoritë themelore dhe metodat e hulumtimit. Në këtë lëndë paraqiten njohuri të përgjithshme për varietetet gjuhësore dhe ndryshimet gjuhësore. Do të analizohen dialektet, kolokuializmat, vernakulet, pixhinët dhe kreolet, idiolektet, slangu si dhe perspektivat sinkronike dhe diakronike ndaj ndryshimeve gjuhësore. Me theks të veçant do të fokusohet në të folmet e gjalla, gjegjësisht dialektet e gjuhës amtare të cilat pasqyrojnë ligjërimin e gjallë në të gjitha fazat shoqërore. Për këtë arsye qysh nga fillimet e studimit të dialekteve, studentët do të përvetësojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre në këtë segment të dijes gjuhësore. Kursi i kësaj lënde do t'u ofrojë studentëve dije mbi tërësinë e varianteve dialektore, duke u thelluar në njohjen e degëzimeve apo mikrosistemeve dhe makrosistemeve, duke mos i lënë anash as të folmet e diasporave që për gjuhësinë shqiptare kanë një rëndësi të veçantë.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi kryesor i këtij kursi është që studentët të njihen me format e studimeve gjuhësore në raport me bashkësitë shoqërore. Është me rëndësi që studentët të kuptojnë ndikimin e faktorëve shoqërore në ligjërim dhe të jenë në dijeni për</p>

Rezultatet e pritshme:

varietetet e ndryshme gjuhësore që ekzistojnë në kuadër të një bashkësie shoqërore dhe në këtë kuptim të njihen edhe me variacionin gjuhësor të gjuhës shqipe. Do të përfitojnë njohuri për shqipen dialektore, sistemet e saj: dialektet, nëndialektet, grupet e të folmeve dhe njohuri të mjaftueshme për funksionin dhe domenet e përdorimit të këtyre sistemeve. Po ashtu, synim i rëndësishëm është edhe njohja e studentëve me strukturën gjuhësore të të folmeve të 2 diasporës, si: E folmja e italo-arbëreshëve, E folmja e arbëreshëve të Greqisë, E folmja e shqiptarëve të Ukrainës, E folmja e shqiptarëve të Mandricës, E folmja e arbëneshëve të Zarës, E folmja e shqiptarëve të Peshterit.

---

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti:

- definojnë konceptet themelore nga fusha e sociolinguistikës dhe të njihen me problemet themelore të sociologjisë së gjuhës
- identifikojnë varietetet e ndryshme të gjuhës shqipe, krahas gjuhës standarde,
- interpretojnë historinë e procesit të standardizimit të shqipes
- analizojnë implikimet e çështjeve gjuhësore në çështje të tjera shoqërore, politike e kulturore.
- aplikojnë në terren metodat bashkëkohore të dialektologjisë për mbledhjen e materialeve

	të synuara.
	<ul style="list-style-type: none"> <li>identifikon dhe të mbledh në terren material dialektor.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>sistematizon dhe analizon materialin e vjelë</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krahason variante të ndryshme dialektore dhe njëkohësisht të përcakton përkatësinë e tyre idiomatike.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon përkatësinë regjionale të folësve të shqipes.</li> </ul>

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë nëpërputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	4	15	45
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	22,5
Punë praktike			0
Përgatitje për test intermediar	1	7	7
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	12	2
Puna në terren	2	6	12
Testi, punimi i seminarit	1	5	10
Detyrë shtëpie	2	7	14
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	12	34
Përgatitja për provimin final	3	6	18
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	7
<b>Total</b>			<b>153:25=7,02 7 ECTS</b>

Metodat e mësimdhënies:	Kursi do të organizohet nëpërmes ligjëratave, ushtrimeve, seminareve, detyrave në shtëpi etj. Metodologjia e mësimdhënies do të jetë interaktive, me studentin në qendër. Do të ketë diskutime, prezentime, bashkëpunim grupor, etj.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi intermediar: 10% Puna në terren: 20%

	<p>Detyrat dhe seminarët: 10%</p> <p>Vijimi i rregullt: 5%</p> <p>Provimi final: 55%</p> <p>Total: 100%</p>
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ronald Wardhough, An Introduction to Sociolinguistics. Blackwell Publishing. 2006.</li> <li>• Dialektologjia, I, II, III, IV, V, VI, Tiranë</li> <li>• Bahri Beci, Rreth bazës dialektore të shqipes standarde, Filologji, nr. 2, Prishtinë, 1997.</li> </ul>
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ismajli, R. (2019), Bashkësi gjuhësore, njësitë, varietet, ASHAK:Prishtinë</li> <li>• Bahri Beci, Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës, Tiranë, 1995.</li> <li>• Studime gjuhësore I (Dialektologji), IA, Prishtinë 1978.</li> <li>• Idriz Ajeti, Zhvillimi historik i të folmes geqe të arbneshëve të Zarës, Prishtinë, 1998.</li> <li>• Eqrem Çabej, Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre, në Konferenca e dytë e studimeve albanologjike, vëllimi III, 1960.</li> <li>• Waslav Cimohovski, Dialeki i Dushmanit, në librin e ASHAK "Për gjuhën shqipe", Prishtinë, 2004.</li> <li>• Gjovalin Shkurtaj, Ligjërimet arbëreshe, Tiranë, 2006.</li> <li>• Voronina, M. Domosileckaja, L. Sharapova, E folmja e shqiptarëve të Ukrainës, Shkup, 1966.</li> <li>• Atlasi dialekto</li> <li>• Claus Haebler, Albanische Grammatik der Mundarten von Salami, Eïessbaden, 1965.</li> <li>• Martin Camaj, La parlata albanse di Grecci in provincia di Avellino, Firencë, 197.</li> <li>• Guzzetta, A., La parlata di Piana degli Albanesi, Palermo, 1978.</li> </ul>

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje në teorinë e ndryshimeve gjuhësore. Konceptet themelore si gjuha dhe shoqëria, sociologjia e gjuhës, sociolinguistika.
Java 2:	Krijimi i modeleve: Taksonomia e shoqërisë, taksonimia e veprimeve, atitudat si realitete sociale
Java 3:	Varietetet-konceptet themelore. Variacioni regional, Ndryshoret gjuhësore. Variacionet gjuhësore dhe shoqërore.
Java 4:	Kontakti gjuhësor. Code-switching. Diglosia dhe Bilinguizmi. Gjuhët pixhin,

	Kreolet. Kodet. Bashkësitë folëse.
Java 5:	Gjuhë dhe dialekti. Dialektet regjionale. Dialektet sociale. Stilet, regjistrat etj.
Java 6:	Dialektologjia si lënda e studimit. Konceptet dialektologjike dhe terminologjia.
Java 7:	Dimenzioni normativ-preskriptiv. Dialektet dhe gjuha standarde.
Java 8:	Ndarja dialektore e gjuhës shqipe
Java 9:	Dallimet dialektore fonetike-vokalizmi. Dallimet dialektore fonetike-konsonantizmi. Dallimet dialektore në fushë të morfologjisë.
Java 10:	Analiza krahasuese e shkrimeve publicistike.
Java 11:	Marrëdhëniet e gjuhës standarde me dialektet.
Java 12:	Arbëreshët e Italisë (histori, identitet, gjuhë).
Java 13:	Arbëreshët e Greqisë (histori, identitet, gjuhë).
Java 14:	Arbëreshët e Zarës (histori, identitet, gjuhë).
Java 15:	Të folmet e kolonive të tjera shqiptare

#### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimt.  
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet e tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet, janë të ndaluara.

**Titulli i lëndës: VARIETETET GJUHËSORE TË GJUHËS BASHKËKOHORE BALLKANIKE (DIALEKTOLOGJI DHE SOCIOLINGUISTIKË)**

<b>Informata bazë për lëndën</b>	
Njësia akademike:	Departamenti i Ballkanistikës
Titulli i lëndës:	Varietetet gjuhësore të një gjuhe bashkëkohore ballkanike (Dialektologji dhe Sociolinguistikë)
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti IV   Semestri VIII
Fondi i orëve në javë:	4+2
Kreditë ECTS:	6
Koha/vendi:	
Ligjërues/e i/e lëndës:	
Informata kontakti:	
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë shtjellon dy tema kryesore: ajo përqendrohet në dialektologji, metodologjinë e kësaj disipline dhe qasjen diakronike, si edhe në sociolinguistikë, metodologjinë e saj dhe qasjen bashkëkohore sociolinguistike. Synimi i kësaj lënde është t’i mbulojë të gjitha temat përkatëse që lidhen me kontinuumin dialektor të gjuhëve sllave me një pasqyrë përmbledhëse të fazave të tija diakronike deri tek dialektet e gjuhët e ditëve të sotme. Nga ana tjetër do të ofrohen sqarime në suazat e sociolinguistikës dhe konceptet e standardizimit të gjuhës, politikat dhe planifikimet gjuhësore, gjuhët pluricentrike, gjuhët ‘abstand’ dhe ‘ausbau’, ideologjitë gjuhësore dhe marrëdhëniet mes gjuhës dhe koncepteve sociologjike sikurse gjinia, mosha, përkatësia etnike, feja dhe identiteti. Një vështrim i këtillë nga këndi i dialektologjisë dhe sociolinguistikës do t’ua bëjë të qartë studentëve çështjen komplekse të gjuhëve të Ballkanit dhe ata do të formojnë një pikëpamje më të gjerë të situatës aktuale gjuhësore të gjuhëve të Ballkanit.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet kryesore të kësaj lënde janë që

Rezultatet e pritura të të nxënit:	studentët të njoftohen me terminologjinë e përdorur në dialektologji dhe sociolinguistikë dhe të përvetësojnë në mënyrë adekuate kornizën teorike që është e nevojshme për ta kuptuar çështjen aktuale të gjuhëve sllave të Ballkanit dhe të veçorive të tyre diakronike.
	Me rastin e përfundimit të kësaj lënde, pritet që studentët të jenë në gjendje:
	- Të kuptojnë konceptet, metodat dhe klasifikimet kryesore që përdoren në dialektologji dhe sociolinguistikë;
	- Të shpjegojnë kontinuumin dialektor të gjuhëve sllave jugore në Ballkan;
	- Të kuptojnë ndërhyrjen e gjuhës dhe gjinisë, moshës, fesë, etnisë dhe identitetit;
- Të kuptojnë zbatimin e politikave gjuhësore dhe planifikimin në procesin e krijimit të gjuhëve të reja standarde.	

#### Ngarkesa e punës së studentëve (e cila duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit)

Aktiviteti	Orët mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjërata	4	15	45
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	22,5
Punë praktike			0
Përgatitja e testit të ndërmjetëm	4	4	16
Konsultime me ligjëruesin e lëndës	10 min.	12	2
Punë në terren	2	4	14
Testi, punimi i seminarit	1	1	1
Detyrë shtëpie	1	10	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	13	26
Përgatitja e provimit përfundimtar	4	3	12
Koha e vlerësimit (test, kuiz, provim përfundimtar)	1	3	3
Projekte, prezantime etj.	2	1	2
Gjithsej			131:25=6,02 6 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata teorike; ushtrime gjatë ligjëratave duke përdorur materiale të ndryshme; ligjërata praktike me asistentin e lëndës për ta përforcuar kornizën teorike dhe ushtrime të ndryshme interaktive; një punim seminarik deri në 2000 fjalë (punë individuale ose në grup) dhe konsultimet me mësimdhënësin në vazhden e hartimit të tij; detyra shtëpie individuale; dëgjim i gjuhës së folur se sotme Ballkanike në programe të zgjedhura në TV/internet (filma, muzikë, programe televizive edukative) ose dëgjim i folësve të cilët e kanë gjuhen se sotme Ballkanike gjuhë amtare jashtë fakultetit si formë e punës në terren (duke u kushtuar vëmendje varieteteve të ndryshme, si dialekteve ashtu edhe sociolekteve); një prezantim (punë individuale ose në grup); një test i ndërmjetëm, studim vetanak.
Metodat e vlerësimit:	Pragu për kalimin e lëndës 60% Vijimi i ligjëratave nga studenti 15% Detyrat individuale të përfunduara në klasë 10%; Detyrat individuale të përfunduara në shtëpi 30%; Vlerësimi nga testet 30%; Provimi përfundimtar 15%; Gjithsej 100%.
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Ivić, P. (1985). <i>Dijalektologija srpskohrvatskog jezika, Uvod i štokavsko narečje</i> [Dialektologjia e gjuhës serbokroate, Parathënie dhe dialekti shtokavian], Novi Sad: Matica srpska, ose</li> <li>-Bogdanović, N., Marković, J. (2000). <i>Praktikum iz dijalektologije</i> [Praktikum i dialektologjisë] Niš: Filozofski fakultet [Nish: Fakulteti Filozofik]</li> <li>-Ivić, P. (2009). <i>Srpski dijalekti i njihova klasifikacija</i> [Dialektet serbe dhe klasifikimi i tyre]. Novi Sad: Izdavačka knjižarnica Zorana Stojanovića [Shtëpia Botuese e Zoran Stojanoviç]</li> <li>-Greenberg, R. (2004). <i>Language and Identity in the Balkans: Serbo-Croatian and Its Disintegration</i> [Gjuha dhe identiteti në Ballkan: Serbokroatishtja dhe dezintegrimi i saj]. Oxford University Press</li> </ul>
Literatura ndihmëse:	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Greenberg, R. (2001). <i>Language, nationalism and war in Yugoslavia</i> [Gjuha, nacionalizmi dhe lufta në Jugosllavi]. <i>International Journal of Sociology of Language</i>, 151: 69-87.</li> <li>-Friedman, V. (2011). <i>The Balkan Languages and Balkan Linguistics</i> [Gjuhët ballkanike dhe gjuhësia ballkanike]. <i>Annual Review of Anthropology</i>, Vol. 40. 2011. 275-291</li> <li>-Pranjković, I. (2001). <i>The Croatian standard language and the Serbian standard language</i> [Gjuha standarde kroate dhe gjuha standarde serbe]. <i>International Journal of Sociology of Language</i>,</li> </ul>

	<p>151: 31-50.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-<i>The Routledge Handbook of Sociolinguistics Around the World</i> [Doracak nga Routledge mbi sociolinguistikën anembanë globit]</li> <li>-Todorovna, M. (2009). <i>Imagining the Balkans</i> [Ta imagjinosh Ballkanin]. Oxford University Press</li> <li>-Tollefson, J. W. (2001). <i>The language debates: preparing for the war in Yugoslavia: 1980-1991</i> [Debatet gjuhësore: përgatitje për luftën në Jugosllavi: 1980-1991] <i>International Journal of Sociology of Language</i>, 154: 65-82.</li> </ul>
--	--

### Përmbajtja e lëndës

Java	Tema e ligjëratës
Java 1:	Hyrje në terminologjinë themelore dhe përkufizimi i dialektologjisë dhe sociolinguistikës si disiplina gjuhësore; njoftimi i studentëve me lëndën, obligimet e tyre dhe vlerësimin; përkufizimi i koncepteve kryesore sintaksore (varieteti, dialekti, politikat gjuhësore, planifikimi, standardizimi, ideologjitë)
Java 2:	Kontinuumi dialektor i varieteteve gjuhësore jugore sllave në Ballkan: klasifikimi i dialekteve; qasja diakronike
Java 3:	Kontakti gjuhësor dhe interferenca; qasja diakronike
Java 4:	Standardizimi i gjuhës dhe fazat e tij; planifikimi gjuhësor dhe politika gjuhësore
Java 5:	Ideologjitë gjuhësore; gjuhët ‘abstrand’/’ausbau’; gjuhët policentrike
Java 6:	Gjuha dhe kategoritë e tjera sociale: gjinia, mosha, identiteti, feja, etnia
Java 7:	Kontinuumi dialektor i varieteteve gjuhësore jugore sllave në Ballkan: varietetet shtovakian, kajkavian dhe çakavian (dialektologji); krijimi i gjuhës serbokroate; Marrëveshja letrare e Vjenës; Marrëveshja e Novi Sadit (sociolinguistikë)
Java 8:	Varieteti shtovakian: klasifikimi; ekavian; prezantimi i ijekavian (dialektologji)
Java 9:	Rasti i serbishtes (dialektologji, sociolinguistikë)
Java 10:	Varieteti shtovakian: ijekavian (dialektologji)
Java 11:	Rasti i kroatishtes (dialektologji, sociolinguistikë)
Java 12:	Rasti i boshnjakishtes (dialektologji, sociolinguistikë)
Java 13:	Rasti i malazezishtes (dialektologji, sociolinguistikë)
Java 14:	Ngjashmëritë dhe dallimet kryesore ndërmjet varieteteve gjuhësore BSKM

Java 15:

Vlerësimi dhe diskutimi i detyrave të klasës dhe shtëpisë gjatë semestrit; përsëritje koncepteve më pak të njohura sipas mendimit të ligjëruesit; përgatitja për provim

### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Përdorimi i telefonave mobilë nuk lejohet gjatë ligjëratave, si dhe për arsyen që vijimësia në ligjëratat ndikon në notën përfundimtare të studentit, studentët nuk mund të hyjnë e të dalin nga klasa kur të duan. Studentët inkurajohen të diskutojnë çështje të ndryshme që lidhen me njësinë e kryer, pa ofenduar ose diskriminuar njëri-tjetrin dhe duke respektuar mendimin e tjetrit. Studentët do t'i nënshtrohen një testi të ndërmjetëm dhe një testi përfundimtar. Punimi seminarik është i detyrueshëm.